



Nr. 688 Akti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 762 Vendimi
Tiranë, më 15.5.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 13.5.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Afrim Shehu**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu ka filluar të ushtrojë detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nga data 11.12.2009 deri në korrik 2023, datë në të cilën ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Karriera e tij profesionale ka nisur në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në periudhën tetor 1999 – dhjetor 2000, më pas në periudhën 10.4.2002 – 31.12.2003 avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë. Nga data 1.1.2004¹ – 10.12.2009 ka ushtruar detyrën e OPGJ-së në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa prej korrikut 2023 e në vijim ushtron detyrën e prokurorit. Në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.12.2020 dhe iu nënshtrua procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Pamela Qirko dhe Alma Faskaj, ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Francesco Ciardi.
3. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, rivlerësimi i aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionerja Xhensila Pine. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
4. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike² për përbërjen e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit, për të cilin deklaroi³ se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja në fillim të procesit të hetimit administrativ.
6. Relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të

¹ Rikthyer në detyrë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 25.10.2004, përcjellë nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

² Subjekti u njoftua në datën 21.1.2021 me anë të postës elektronike, me *email*.

³ Subjekti i rivlerësimit po në datën 21.1.2021 njoftoi Komisionin me anë të postës elektronike.

gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

8. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 10.1.2023, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu.

9. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

10. Në datën 18.9.2023, Komisioni me vendimin nr. 2 vendosi administrimin e dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, protokolluar pranë Komisionit me shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2022 dhe nr. *** prot., datë 15.3.2022, të cilat do t'i bashkëlidhen dosjes së hetimit të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, vendosi me vendimin nr. 3, datë 15.4.2024, përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 15.4.2024⁴ mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 29.4.2024.

13. Në datën 16.4.2024, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe kërkoi shtyrjen e afatit për dërgimin e shpjegimeve në lidhje me rezultatet e hetimit deri në datën 7.5.2024. Trupi gjykues, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, pranoi kërkesën e subjektit duke zgjatur afatin e dërgimit të parashtrimeve.

14. Në datën 7.5.2024, brenda afatit të lënë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi me postë elektronike (*email*) shpjegimet dhe provat përkatëse.

15. Në datën 8.5.2024, me vendimin nr. 4, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Afrim Shehu, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të

⁴ Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike, me *email*.

postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 13.5.2024, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

16. Në datën 13.5.2024 u zhvillua seanca dëgjimore, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashitroi shpjegimet e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin e shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja⁶, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni në vitin 2004 si oficer i policisë gjyqësore dhe pa ndërprerje nga viti 2009, me nr. indeksi ***, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

22. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitin 2004 dhe 2009 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; (e) deklaratimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet e informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

25. Apartament me sipërfaqe 72.20 m², ndodhur në rrugën “****”, regjistruar në z. k. ***, nr. pasurie ***, volum ***, fq. ***, kontratë sipërmarrjeje datë 30.5.2003, kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2010. Likuiduar me këste sipas mandatarkëtimeve nr. ***, datë

⁶ Raporti nr. *** prot., datë 23.1.2019, i ILDKPKI-së.

10.9.2003; nr. *** datë, 13.9.2005; nr. ***, datë 10.5.2008. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga si oficer i policisë gjyqësore ndër vite dhe si avokat 10.4.2002 – 31.12.2003 dhe një vlerë 10,041 euro dhuratë nga A.SH (vëllai), me banim në Londër, Angli, të depozituara në llogarinë nr. ***, datë 2.7.2003, në emër të shtetasit Afrim Shehu, pranë ProCredit Bank, Tiranë⁷. Vlera 4,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

25.1 Nga hetimi rezultoi e provuar se pasuria është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Private para fillimit të detyrës (në vijim DIPP), në vitin 2009. Në DIPP-në e vitit 2004, në të vetmin deklaram të subjektit kur ka qenë duke ushtruar detyrën si OPGJ, nuk është deklaruar kontrata e sipërmarrjes dhe pagesa e këstit të parë. Për këtë qëllim, subjekti ka dhënë shpjegime në procesverbalin datë 15.1.2016 pranë ILDKPKI-së⁸, ku ka sqaruar se ka deklaruar vetëm asetet, të cilat kanë qenë në pronësi të tij deri në atë moment.

25.2 Nga hetimi rezultoi e provuar se subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrje datë 30.5.2003 me të cilën ka porositur nga shoqëria “N” sh.p.k., apartamentin nr. ***, kati ***, me sip. 83.7 m², rruga “***”. Çmimi i apartamentit është përcaktuar në vlerën 270 \$/m². Gjithashtu rezultoi se në datën 1.7.2010 është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol me palë blerëse subjektin e rivlerësimit dhe palë shitëse shoqërinë “N” sh.p.k. për apartamentin me sip. 72.2 m² kundrejt çmimit 4,000,000 lekë. Palët në kontratë kanë deklaruar se me vlerën e shitblerjes janë likuiduar jashtë zyrës noteriale sipas kushteve në kontratën e sipërmarrjes në vitin 2003. Në datën 2.7.2015 është lëshuar certifikatë për vërtetim pronësie për apartamentin me sipërfaqe 72.2 m², regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***, në pronësi të z. Afrim Shehu.

25.3 Gjithashtu, nga hetimi rezultoi se aktualisht ky apartament është në pronësi të shtetaseve M.P dhe E.P, fituar me kontratë shitjeje me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.11.2018, në vlerën 76,000 euro⁹, likuiduar sipas pagesave bankare pranë Raiffeisen Bank në datën 23.11.2018 me vlerë 31,000 euro, urdhëruar nga shtetasja M.P dhe pjesa e mbetur shlyer me kredi bankare nga blerësit e tij.

25.4 Komisioni konstatoi se çmimi i blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë rreth 0.35¹⁰ herë më i lirë se çmimi i referencës së tregut të lirë të së njëjtës periudhë kohore, për të cilin subjekti dha shpjegime gjatë procesit¹¹, duke përcjellë edhe 8 kopje kontratash për

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* certifikatë për vërtetim pronësie, datë 2.7.2015, për apartamentin me sip. 72.20 m², në rrugën “***”, regjistruar në z. k. ***, me nr. *** dhe kartelë të pasurisë me datë regjistrimi 31.10.2013; kontratë sipërmarrjeje datë 30.5.2003 për apartament me sip. 83.7 m², në rrugën “***”, Tiranë, lidhur me shoqërinë “N” sh.p.k.; kopje të mandatarkëtimeve nr. ***, datë 10.9.2003, në shumën 9,040 USD; nr. ***, datë 13.9.2005, në shumën 10,000 USD; nr. ***, datë 10.5.2008, në shumën 3,960 USD; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2010 për apartament me sip. 72.2 m², në shumën 4,000,000 lekë; Vërtetim hipotekor datë 30.12.2009 për apartament me sip. 72.20 m² në rrugën “***” në emër të shoqërisë “N” sh.p.k., plus harta treguese e regjistrimit dhe planimetria e apartamentit; *Statement* bankar nga ProCredit Bank datë 23.1.2017, ku figuron transfera datë 10.9.2003 në shumën 10,041 euro; kopje e pasaportës së A.SH si qytetar britanik, nr. ***, datë lëshimi 23.6.2013; *Statement* nga “***” për të ardhurat e A.SH, datë 5.1.2017, shuma 5,572 GBP; 5.10.2016 shuma 4,889 GBP; 10.6.2016 shuma 4,772 GBP.

⁸ Shkresë e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 5.3.2021.

⁹ Shënim në seksionin E të kartelës për kufizim pasurie në favor të Raiffeisen Bank për shumën 45,000 euro.

¹⁰ Udhëzim nr. 1, datë 8.5.2003, vlera e shitjes sipas të dhënave në tregun e lirë për apartamente në lekë/m² për sipërfaqe të shfrytëzueshme ka qenë 53,450 lekë/m². Pra, vlera totale me çmimet e referencës për apartamentin llogaritet rreth 3,859,090 lekë ose, e konvertuar me kursin mesatar të BOA për vitin 2003, në vlerën 35,505 USD.

¹¹ Pyetësori nr. 2.

apartamente dhe garazhe të shitura në vitin 2003 në këtë ndërtesë nga shoqëria “N” sh.p.k., të cilat kanë çmime nga 230 USD/m² – 260 USD/m².

25.5 Në lidhje me konfliktin e interesit nga hetimi¹² nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me firmën e ndërtimit “N” sh.p.k. dhe/ose ortakët/administratorët e kësaj shoqërie, znj. M.I.P dhe znj. E.I.P.

25.6 Gjatë hetimit, Komisioni konstatoi mospërputhje të çmimit të blerjes së apartamentit në deklarinimin para fillimit të detyrës të subjektit në vitin 2009 me çmimin në kontratën e sipërmarrjes dhe atë në kontratën e shitjes, pra vlera në kontratën e shitjes është më e lartë, për të cilat subjekti shpjegoi¹³ se arsyeja ka qenë për shkak të: a) diferencës së sipërfaqes faktike të matur, e cila është shlyer sipas mandatpagesave, me sipërfaqen e parashikuar fillimisht në kontratën e sipërmarrjes; b) për shkak të kryerjes së punimeve shtesë gjatë fazës së fillimit të punimeve të brendshme në këtë apartament kundrejt një pagese shtesë, plus shpenzimet për arredimin e apartamentit, punime të kryera këto nga shoqëria “N” sh.p.k. Me shpjegimet subjekti bashkëlidh¹⁴ shkresë kthim përgjigjeje të shoqërisë “N” sh.p.k., në të cilën deklarohet sa më lart.

25.7 Në lidhje me shlyerjen e çmimit të blerjes së apartamentit, të cilin subjekti e provon me kopjet e mandatarkëtimeve të realizuara gjatë periudhës 10.9.2003 deri në datën 10.5.2008, të cilat janë paraqitur në tabelën nr. 1, nga hetimi rezultoi se pagesat nuk janë kryer sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes dhe të kontratës së shitjes. Subjekti ka sqaruar¹⁵ se mospërputhja e konstatuar nga Komisioni lidhet me vlerën e punimeve të brendshme shtesë, të cilat nuk ishin parashikuar të kryheshin në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, por janë kërkuar më pas prej tij, të cilat kanë sjellë ndryshimin e mënyrës/vlerës së pagesës faktike nga çfarë ishte parashikuar në kontratën e sipërmarrjes.

Tabela nr. 1

Data e pagesës	Vlera
Mandatarkëtim datë 10.9.2003	9,040 USD
Mandatarkëtim datë 13.9.2005	10,000 USD
Mandatarkëtim datë 2.10.2005	1,270,000 lekë ~ 12,291 USD
Mandatarkëtim datë 10.5.2008	3,960 USD
Pagesë <i>cash</i> për kompletim kuzhine /deklaruar pa mandat	239,000 lekë ~ 2,628 USD
Totali	37,918 USD

Lidhur me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti u konstatua:

25.8 Të ardhurat nga paga si oficer i policisë gjyqësore¹⁶

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

¹³ Pyetësori nr. 2, pyetja nr. 2.2 dhe 2.3.

¹⁴ Kërkesë e datës 17.5.2023 drejtuar shoqërisë “N” sh.p.k. për sqarim dhe administrim dokumentacioni në 2 fletë; kthim përgjigjeje lëshuar nga shoqëria “N” sh.p.k. në 2 fletë; deklaratë e datës 22.9.2004 lëshuar nga shoqëria “N” sh.p.k. në 1 fletë; mandat arkëtimi i datës 2.10.2005 lëshuar nga shoqëria “N” sh.p.k. për punimet shtesë të realizuara në apartament; situacion punimesh nr. ***, në të cilin janë përshkruar zërat e punimeve shtesë në vlerën 1,270,000 lekë në 1 fletë; situacion punimesh përfundimtar në të cilin janë përshkruar zërat e punimeve të arredimit për kompletim kuzhine në vlerën 239,000 lekë në 1 fletë.

¹⁵ Pyetësori nr. 2, pyetja 1 dhe pyetja nr. 3.

¹⁶ Subjekti i rivlerësimit i bashkëlidh deklaratës *Vetting* vërtetime nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga Prokuroria e Përgjithshme Tiranë dhe nxjerrje llogarie nr. *** ALL nga Raiffeisen Bank sh.a. në emër të tij, në të cilën i ka

Nga hetimi rezultoi se subjekti ka ushtruar funksionin e oficerit të policisë gjyqësore gjatë periudhës tetor 1999 – dhjetor 2000 dhe, pas rikthimit në detyrë, në periudhën janar 2004¹⁷ – 10.12.2009. U provua gjatë hetimit¹⁸ se pagesa e fundit për apartamentin është kryer në datën 10.5.2008 dhe të ardhurat totale neto, që kanë shërbyer si burim krijimi për apartamentin e përfutur nga subjekti në këtë funksion, kanë qenë deri në këtë datë në shumën 3,491,804 lekë.

25.9 Për të ardhurat si avokat 10.4.2002 – 31.12.2003, vlera 2,518,333 lekë, në studion ligjore, me NIPT ***, kontratë pune datë 10.4.2002¹⁹:

Rezultoi e provuar²⁰ se shtetasi A.SH është regjistruar si person fizik me NIPT ***, me objekt të aktivitetit avokati në datën 8.5.2001 dhe se subjekti i rivlerësimit ka përfutur pranë këtij subjekti tregtar të ardhura neto nga paga, në vitin 2002 vlerën 409,860 lekë dhe për vitin 2003 vlerën 546,480 lekë. Ndërsa Komisioni i ka kërkuar shpjegime²¹ për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për vlerën e rezultuar nga kontrata e punës dhe vërtetimi i shtetasit A.SH si të ardhura nga shpërblimet dhe puna jashtë orarit, në total në shumën 1,400,000 lekë, për të cilat sqaron se: *“Ngjitur me zyrën e avokatisë, ndodhej edhe zyra e noteres M.SH. Përveç të ardhurave të deklaruara nga të dyja zyrat, më janë ofruar të ardhura të tjera shtesë, si shpërblime, punë jashtë orarit dhe në ditët e pushimit. Vlera e përfutur nga të dyja zyrat për të ardhura të tjera shtesë, shpërblime dhe punë jashtë orarit, është vlera 1,400,000 lekë për të gjithë periudhën 10.4.2002 – 31.12.2003. Nga shtetasit A.SH (vëllai) dhe M.SH (nusia e vëllait) më është konfirmuar se më është paguar kjo vlerë duke paguar edhe detyrime tatimore. Si dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ana e tyre më është vënë në dispozicion vërtetimi me nr. ***, datë 29.8.2006, lëshuar nga Zyra e Tatim-Taksave Tiranë, në të cilin provohet se A.SH me NIPT *** ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002, për një xhiro vjetore në vlerën 2,000,000 lekë, në vitin 2003 për një xhiro vjetore në vlerën 1,860,000 lekë dhe vërtetim me nr. ***, datë 27.6.2006, lëshuar nga Zyra e Tatim-Taksave Tiranë, në të cilin provohet se znj. M.SH, me NIPT ***, për vitin 2002 ka paguar detyrime tatimore për një xhiro në vlerën 7,860,400 lekë, për vitin 2003 ka paguar detyrime tatimore për një xhiro në vlerën 7,700,000 lekë²²”.*

25.9.1 Gjithashtu, u provua nga hetimi²³ se subjekti i rivlerësimit nuk ka hetuar çështje penale me shtetas të cilët janë përfaqësuar prej vëllait të tij, shtetasit A.SH.

25.9.2 Komisioni konstatoi gjatë hetimit se të ardhura të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, rezultoi të jenë vetëm

kaluar nga Prokuroria e Përgjithshme me përshkrimin *“Sa paga e vendimit gjyqësor shuma 626,175.23 lekë”*. Aneks 4/8, dosja ILDKPKI.

¹⁷ Rikthyer në detyrë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 25.10.2004, përcjellë nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

¹⁸ Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e rezultuara nga krahasimi i të dhënave të vërtetuara nga institucionet (Aneks 4/8).

¹⁹ Dokumentacioni bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneks 4/8, dosja e ILDKPKI-së).

²⁰ Shkresë e ISSH-së, Arkivi Qendror, nr. ***, datë 21.9.2023 dhe nga QKB online.

²¹ Me pyetësorin nr. 2.

²² Subjekti u bashkëlidh përgjigjeve deklaratë noteriale të shtetasve A.SH dhe M.SH me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2023, ku deklarojnë se subjekti i rivlerësimit për periudhën 10.4.2002 – 31.12.2003 ka punuar pranë zyrave të tyre (avokatisë dhe noterisë). Për shërbimet juridike shtesë, si dhe për rastet e punës jashtë orarit dhe në ditët e pushimit për këtë periudhë është shpërblyer në masën 1,400,000 lekë. Vërtetimi nr. ***, datë 29.8.2006, lëshuar nga Zyra e Tatim-Taksave Tiranë, provon se shtetasi A.SH, me NIPT ***, ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002 dhe 2003. Vërtetimi nr. ***, datë 27.6.2006, lëshuar nga Zyra e Tatim-Taksave Tiranë, provon se znj. M.SH, me NIPT ***, ka paguar detyrime tatimore për vitin 2002 dhe 2003.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2024.

të ardhurat nga paga të konfirmuara nga vërtetimi i ISSH-së me vlerë totale 956,340 lekë, të cilat u përfshinë në analizën financiare.

25.9.3 Ndërsa për vlerën 1,400,000 lekë, e cila përfaqësonte shpërblimin prej 20% të të ardhurave nga përfaqësimi i çdo klienti nga subjekti, sipas kontratës së punës lidhur me shtetasin A.SH, rezultoi e pamundur në llogaritje të përfitohej kjo vlerë me qarkullimin/xhiron e deklaruar nga shtetasi A.SH, në vitin 2002 prej 2,000,000 lekësh dhe në vitin 2003 prej 1,800,000 lekësh.

25.9.4 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se subjekti vetëm gjatë procesit të rivlerësimit të tij ka deklaruar se kjo shumë është përfituar jo vetëm pranë zyrës së shtetasit A.SH, por edhe gjatë punës pranë zyrës së noterisë së shtetases M.SH. Për sa ka rezultuar, në analizën e Komisionit nuk u përfshinë të ardhura nga zyra e noterisë.

25.9.5 Në përfundim, Komisioni nuk e ka përfshirë vlerën 1,400,000 lekë si të ardhur të ligjshme, duke i kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për këtë vlerë.

25.9.6 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës në lidhje me të ardhurat nga avokatia, sqaron se gjatë hetimit administrativ rezultoi i provuar punësimi i tij pranë studios ligjore të shtetasit A.SH. Gjithashtu, provohet fitimi i të ardhurave edhe nga deklarimi i kohës në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 dhe, bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016, ky deklarim përbën provë. Ndërsa shpjegon se pagesa i është bërë *cash* nga zyra e avokatisë dhe noterisë, pasi në kohën e realizimit të tyre pagat nuk përfitoheshin nëpërmjet transaksionit bankar, por një e dhënë që provon fizikisht ekzistencën e këtyre të ardhurave, vjen nga llogaritë bankare të tij pranë ProCredit Bank. Konkretisht, në vitin 2003, gjatë kohës që ushtronte detyrën e avokatit, ka depozituar në llogari bankare të ardhurat e kursyera kryesisht nga puna si avokat apo kursime të tjera. Gjithashtu, shpjegoi për shlyerjen e detyrimeve tatimore se, siç ka deklaruar ai në atë kohë, banonte në një shtëpi me vëllain dhe kumatën e tij e, duke qenë në mirëbesim, dhe meqë aktiviteti privat i tyre ishte një biznes familjar, ai ka lidhur vetëm një kontratë dhe termat e referencës për shërbimet profesionale që ofronte në zyrën noteriale kanë qenë të njëjta me ato të kontratës së punës të lidhur me zyrën e avokatisë. Gjithashtu, për shkak të natyrës së marrëdhënies së tij me ta nuk ka qenë në dijeni të xhiros së deklaruar nga zyra avokatore apo për kryerjen e pagesave për detyrimet tatimore. Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, detyrimin për mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim nga të ardhurat nga punësimi e ka punëdhënësi dhe, për këtë arsye, ka vlerësuar se çdo detyrim tatimor është paguar nga punëdhënësi, me të cilin ishte në marrëdhënie të posaçme.

Vlerësimi i Komisionit

25.9.7 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezulton e provuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 2002 – 2003, duke përfituar edhe të ardhura, të cilat janë provuar pjesërisht nga institucionet si të ardhura nga paga dhe janë deklaruar gjithashtu në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2009. Meqenëse nga hetimi u provua vetëm marrëdhënia e punësimit pranë zyrës së avokatisë, në analizën e Komisionit do të përfshihen vetëm të ardhurat nga ky aktivitet si të ardhura të ligjshme.

25.9.8 Lidhur me vlerën e të ardhurave të ligjshme të fituara në këtë aktivitet, Komisioni vlerësoi se për shumën 1,400,000 lekë të fituar si shpërblim nuk u arrit të provohej shlyerja e detyrimeve tatimore të paguara mbi këto të ardhura. Por, meqenëse në kontratën e punës të lidhur me zyrën e avokatisë parashikohej 20% fitim për klientët e përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit (*success*

fee), atëherë Komisioni do të përfshijë në analizën financiare të tij 20% të xhiros së vitit 2002 dhe 20% të xhiros së vitit 2003 pas llogaritjes me marzh fitimi 80% të xhiros së deklaruar²⁴ nga zyra e avokatisë, respektivisht do të përfshihen vlerat 320,000 lekë për vitin 2002 dhe 297,600 lekë për vitin 2003. Komisioni çmon se të ardhurat totale që duhet të përfshihen në analizën financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë prej subjektit, e cila përmbush edhe kriteret e burimit të ligjshëm sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, është vetëm vlera 1,573,940 lekë.

25.10 Burimi i krijimit: vlera 10,041 euro dhuratë nga A.SH (vëllai), me banim në Londër, të depozituara në llog. me nr. ***, datë 2.7.2003, pranë ProCredit Bank²⁵.

Subjekti ka deklaruar në seksionin e të dhënave konfidenciale në deklaratën *Vetting*: “A.SH, (vëllai) lindur në RR, Mat dhe banues në Londër. Në formë dhurate, në datën 10.9.2003, në vlerën 10,041 euro, nr. ***, në ProCredit Bank dhe në datën 28.5.2008, kaluar në llogarinë *** në GBP, Raiffeisen Bank, vlera 2,500 GBP. Burimi: të ardhura në punë, fusha e ndërtimit, nga viti 1999 e në vazhdim, me të ardhura të deklaruara nëpërmjet bankës. ”

25.10.1 Nga komunikimi i Komisionit me ProCredit Bank²⁶ rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka tërhequr vlerën 10,041 euro në datën 3.2.2004 dhe jo si deklaruar prej tij në datën 2.7.2003. Pra, tërheqja *cash* e vlerës 10,041 euro është bërë rreth 8 muaj pas datës së deklaruar në *Vetting* nga subjekti.

- Kjo shumë ka pasur si burim depozitën e kursimit të çelur prej tij në datën 2.7.2003 dhe jo transfertën me dërgues vëllain e tij, z. A.SH.

- Konstatohet se data 10.9.2003 e mandatarëkëtimit, me vlerë 9,040 USD, përcjellë bashkëlidhur kontratës së porosisë, nuk përputhet me datën e tërheqjes së bërë prej subjektit pranë ProCredit Bank, më 3.2.2004. Pra, mandati i arkëtimit është firmosur gati 6 muaj para tërheqjes nga banka të vlerës 10,041 euro.

- Nga *statement*-i i ProCredit Bank sh.a. rezultoi se transfertat ndërkombëtare nga shtetasi A. SH janë kryer në llogarinë e subjektit në datën 5.4.2004 me vlerë 7,000 euro, në datën 17.9.2004 me vlerë 5,740 euro nga shtetasi A. SH dhe në datën 5.10.2005 me vlerë 15,296.8 euro. Pra, transfertat hyrëse të kryera në llogarinë e subjektit me origjinë shtetasin A.SH nuk janë kryer në vitin 2003 e, si pasojë, nuk mund të jenë përdorur për pagesën e apartamentit në këtë vit.

25.10.2 Për sa rezultuar më lart nga hetimi i Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime me pyetësin nr. 2, për të cilat sqaron: “*Saktësoj se si burim për pagesën e kryer sipas mandatit të arkëtimit datë 10.9.2003, me vlerë 9,040 USD, ka shërbyer një pjesë e vlerës së huas së marrë cash, në vlerën 4,000 USD, në muajin gusht të vitit 2003, nga z. G.ZH dhe pjesa tjetër janë të ardhura nga paga ime, shpërblimet dhe kursimet e mia. Deklarimi si burim i vlerës 10,041 euro dhuratë nga z. A.SH (vëllai im) ka qenë një pasaktësi imja, në mënyrën se si unë kam lexuar dhe interpretuar të dhënat e statement-it bankar”.*

²⁴ Mbështetur në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit mbi të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë.

²⁵ Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting statement* bankar nga ProCredit Bank, datë 23.1.2017, ku rezulton transfertë në datën 10.9.2003, në shumën 10,041 euro si depozitë kursimi; kopje e pasaportës së shtetasit A.SH si qytetar britanik, lëshuar në datën 23.6.2013; *statement* nga “****” për të ardhurat e shtetasit A.SH, datë 5.1.2017, shuma 5,572 GBP; më 5.10.2016, shuma 4,889 GBP; më 10.6.2016, shuma 4,772 GBP.

²⁶ Shkresat nr. *** prot., datë 25.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 5.3.2021.

25.10.3 Gjithashtu, subjekti²⁷ bashkëlidh deklaratë noteriale të datës 23.8.2018, nr.*** rep., nr. *** kol., ku deklaruesi N.Q deklaroi se i ka dhënë hua shumën 23,000 USD me kontratë nr. *** rep., *** kol., datë 12.9.2005, nga të cilat shumën 4,000 USD, pjesë e kësaj huaje, ia ka dorëzuar subjektit në gusht 2003, duke qenë se ai ishte fejuar dhe do të krijonte familje. Burimi i huas kanë qenë kursime familjare edhe nga shtetasi G.ZH. Me këtë dokument informohemi nga deklaruesi se shtetasi G.ZH është bashkëshorti i vajzës së shtetasit N.Q.

25.10.4 Konstatohet nga Komisioni se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, viti 2009: *“Hua në shumën 23,000 USD për blerje shtëpie sipas kontratës nr. ***, datë 12.9.2005, me afat 10 vjet, duke shlyer nga 2,300 USD në vit. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, vlera prej 11,500 USD”*.

25.10.5 Komisioni konstatoi se subjekti ka pasaktësi në deklaram, duke saktësuar gjatë procesit të rivlerësimit burimin e këstit të parë të apartamentit nga dhurimi prej vëllait të tij, në të ardhura të tij nga puna dhe nga hua prej shtetasit G.ZH.

25.10.6 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për mundësinë e krijimit të vlerës 4,000 USD nga shtetasi G.ZH me të ardhura të ligjshme, llogaritur me shpenzimet jetike në Mbretërinë e Bashkuar sipas faqes zyrtare të statistikave (<https://ëëë.ons.gov.uk/>), rezultoi se ai kishte mundësi ta kursente këtë shumë prej vitit 1999 deri në korrik të vitit 2003²⁸.

25.10.7 Komisioni nuk përfshiu në analizën financiare huan e marrë në gusht 2003 prej shtetasit G.ZH me vlerë 4,000 USD, pasi rezultoi se subjekti e ka deklaruar vetëm gjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* apo në deklaramet periodike.

25.10.8 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se bashkëshortja e tij ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 se shuma 23,000 USD e marrë hua (pjesë e së cilës është edhe vlera 4,000 USD e dhënë në gusht 2003) ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “***” dhe jo si burim për apartamentin e ndodhur në rrugën “***”.

Kësti i parë 9,040 USD, datë 9.10.2003

25.11 Komisioni, pas trajtimit si më lart të secilit burim krijimi të deklaruar, hartoi analizën financiare²⁹ të pagesave për secilin këst të apartamentit, nga i cili rezultoi se për këstin e parë me vlerë 9,040 USD, i shlyer në datën 9.10.2003, subjekti nuk ka pasur mundësi të kryejë pagesën me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me pamundësi në vlerën totale të tij prej - 982,558 lekësh. Për këtë rezultat financiar subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës.

Tabela nr. 2

Analiza kumulative tetor 1999 – tetor 2003	Shumat në lek
Të ardhura nga paga si OPGJ	431,986
Të ardhura nga puna si avokat	819,720
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë ProCredit Bank	15,938
Të ardhura total	1,267,644

²⁷ Aneks 40, dosja ILDKPKI – bashkëlidhur kërkesës për administrim dokumentacioni.

²⁸ Për më shumë informacion referojuni rezultateve të hetimit administrativ.

²⁹ Për vitin 2001 nuk rezultuan të ardhura dhe, për këtë arsye, nuk janë llogaritur as shpenzime. Pra, nuk është vendosur në analizën financiare ky vit. I njëjti trajtim edhe për vitin 2002, ku rezultojnë të ardhura nga muaji prill i vitit 2002.

Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	4,368,110
Hua e marrë nga shtetasi G.ZH	0
Pagesa e kështit të parë të apartamentit	982,558
Shpenzime jetike	295,287
Rezultati financiar	-4,378,311

25.12 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës në lidhje me huan e marrë në gusht 2003 nga shtetasi G.ZH, sqaron se ai ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën para fillimit të detyrës huan në shumën 23,000 USD nga shtetasi N.Q, materializuar në kontratën e huas nr. *** rep., *** kol., datë 12.9.2005, pjesë e së cilës është edhe shuma 4,000 USD e dorëzuar në gusht 2003 nga shtetasi G.ZH. Fakti se shuma 23,000 USD përfshin edhe vlerën 4,000 USD, provohet lehtësisht nga analiza e provave, pasi në datën kur u lidh kontrata e huas me shtetasi N.Q, nga vlera totale e huas është zbritur vlera e dhënë në vitin 2003 dhe shuma e mbetur që duhet të transferohej për të përmbushur këtë kontratë huaje sipas kursit të këmbimit të momentit³⁰ rezultonte të ishte vetëm vlera 15,300 euro. Provohet me dokumentacion se vetëm rreth pas një muaji (tetor 2005) nga data e nënshkrimit të kontratës së huas, shtetasi G.ZH ka transferuar në llogarinë në ProCredit Bank shumën 15,296 euro. Shuma e transferuar në llogari përputhet me vlerën e mbetur të huas, të formalizuar me kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 12.9.2005.

25.13 Gjithashtu, subjekti sqaron se duhet të konsiderohet nga Komisioni se kunati i tij, shtetasi N.Q, jeton në një banesë dhe në një ekonomi të përbashkët me dhëndrin e tij, shtetasin G.ZH në Londër.

25.14 Duhet të merret në konsideratë se nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se shtetasi G.ZH ka pasur mundësi të japë hua vlerën 4,000 USD në gusht 2003 dhe vlerën 15,260 euro në tetor të vitit 2005. Pra, ky shtetas ka pasur mundësi të dërgonte vlerën totale prej 23,000 USD, atëherë fakti që ka transferuar vetëm vlerën 15,296 euro në vitin 2005 dhe jo shumën totale të huas nënkupton se ky ishte detyrimi i tyre sipas kontratës së huas. Në të kundërt, do të transferonte gjithë shumën e huas prej 23,000 USD, pas lidhjes së kontratës së huas në datën 12.9.2005.

25.15 Pra, subjekti shpjegon se, pavarësisht se nuk është deklaruar në mënyrë të drejtpërdrejtë huaja e dorëzuar në vitin 2003 nga G.ZH në shumën 4,000 USD, ekzistenca e saj rezulton nga analiza faktike dhe logjike e një sërë dokumentesh me fuqi të plotë provuese, të përpiluara shumë kohë më parë se të miratohej ligji nr. 84/2016, pra nuk është deklaruar vetëm gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

25.16 Gjithashtu, subjekti në prapësime shpjegon se është i vërtetë fakti se në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009 bashkëshortja rezulton se ka deklaruar shumën e marrë hua prej 23,000 USD, pjesë e së cilës është edhe vlera 4,000 USD e dhënë në gusht 2003 si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, por është fakt i vërtetuar nga analiza e dokumentacionit dhe analiza kohore e transaksioneve se për këtë apartament ka shërbyer vetëm transferata në vlerën 15,260 euro, ndërsa shuma 4,000 USD ka shërbyer për pagesën e kështit të parë të apartamentit në rrugën “****”. Subjekti shpjegon se shuma 4,000 USD është marrë në gusht të vitit 2003 pikërisht sepse atëherë duhet të kryente pagesën e kështit të shtëpisë në rrugën “****”, ndërsa kontrata për apartamentin e ndodhur në rr. “****” është hartuar më vonë, gjatë vitit 2008.

³⁰ Kursi i këmbimit USD/euro = 0.805.

25.17 Në lidhje me analizën financiare për pagesën e këstit të parë për apartamentin, shpjegon se duhet të përfshihen edhe të ardhurat nga emigracioni, të cilat i ka mbajtur pranë firmave rentiere, provuar me vërtetimin³¹ e lëshuar nga shoqëritë huamarrëse në administrim për vlerën 730,000 lekë, e depozituar prej tij në shoqërinë “V” sh.p.k. në vitin 1996 dhe tërheqjet e realizuara gjatë periudhës 1996 – 1997 në shumën 873,113 lekë. Gjatë periudhës nga data 20.5.1993 deri në datën 1.9.1995 subjekti deklaroi se ka qenë emigrant në Greqi dhe ka kursyer nga të ardhurat 2,000,000 lekë, por për të cilat kishte qenë e pamundur të sigurote dokumentacion dhe, për këtë shkak, nuk i kishte deklaruar në deklaratën *Vetting*. Njohja e vlerave depozituar pranë firmave rentiere është praktikë e njohur dhe e pranuar edhe nga metodologjia e Komisionit në vendimin nr. 558, datë 6.9.2022 dhe Kolegjit, në vendimin nr. 14/2021.

Vlerësimi i Komisionit

25.18 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezultoi e provuar nga të dhënat e bankës se subjekti ka përfituar vlerën 15,296 euro me transfertë bankare në llogarinë e tij, në datën 5.10.2005, nga shtetasi G.ZH, vetëm pas një muaji nga nënshkrimi i kontratës së huas nr. *** rep ., *** kol., datë 12.9.2005, lidhur me shtetasin N.Q.

25.19 Gjithashtu, nga analiza financiare e Komisionit rezultoi se ky shtetas ka pasur mundësi të japë vlerën totale të huas prej 23,000 USD me burime të ligjshme. Nga hetimi rezultoi se shtetasi N.Q dhe G.ZH janë në një marrëdhënie të posaçme brenda familjes, ku rezultoi se vlera totale e huas është dhënë nga shtetasi G.ZH sipas mundësive dhe disponibilitetit kohor e fizik të tij.

25.20 Gjithashtu, Komisioni çmon se subjekti në gusht 2003, kur ka marrë hua vlerën 4,000 USD dhe ka kryer pagesën e këstit të parë, ushtronte profesionin e avokatit.

25.21 Komisioni arrin në konkluzionin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të mbështetura në prova, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës, prandaj vlera 4,000 USD e marrë hua në gusht 2003 nga subjekti dhe shuma e rezultuar nga vërtetimi për firmat rentiere duhet të përfshihen si burim i ligjshëm në analizën financiare.

25.22 Në përfundim, pas përgjigjes së subjektit dhe vlerësimit të provave, Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin, pagesën e këstit të parë për apartamentin si në vijim³².

Tabela nr. 3

Analiza kumulative tetor 1999 – tetor 2003	Shumat në lekë
Të ardhura nga kompanitë rentiere (V sh.p.k.)	873,113
Të ardhura nga paga si OPGJ	431,986
Të ardhura nga puna si avokat	1,362,920
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë ProCredit Bank	20,550
Të ardhura total	2,688,569
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	3,316,440
Hua e marrë nga shtetasi G.ZH	434,760

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2024, bashkëlidhur prapësimeve.

³² Në analizën financiare është përfshirë vlera 4,000 USD marrë në gusht 2003 nga shtetasi G.ZH; është përfshirë vlera e rezultuar nga vërtetimi për shoqëritë huamarrëse në administrim në vlerën 873,113 lekë, në tetor 1999 dhe, për këtë arsye, analiza financiare fillon në këtë periudhë që rezultojnë të ardhura; është llogaritur rezultati financiar i vitit 2001, duke zbritur nga shpenzimet jetike për një anëtar edhe vitin 2002 për gjithë periudhën (janar-dhjetor); është përfshirë si e ardhur nga avokatia në vitet 2002 – 2003 vlera totale prej 1,573,940 lekësh, respektivisht në tabelë vlera sipas periudhës kohore.

Pagesa e kështit të parë të apartamentit	982,558
Shpenzime jetike për një anëtar	419,685
Rezultati financiar	(1,595,354)

25.23 Në analizën përfundimtare të Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi të kryerjes me të ardhura të ligjshme të pagesës së kështit të parë me vlerë 982,558 lekë të apartamentit të ndodhur në rrugën “***”.

Këstet e shlyera gjatë vitit 2005 në vlerën totale 2,542,300 lekë

25.24 Subjekti deklaron se kësti i dytë 10,000 USD është shlyer në datën 13.9.2005; kësti i tretë 1,270,000 lekë në datën 2.10.2005 (për shpenzime përshtatje të apartamentit) dhe pagesa *cash*, deklaruar për shpenzime të kompletimit të kuzhinës, në vlerën 239,000 lekë³³.

25.25 Subjektit iu kërkuan sqarime mbi mënyrën e shlyerjes së kësteve të pasqyruara me mandatarëtimet datë 13.9.2005 në vlerën 10,000 USD dhe në datën 10.5.2008 vlera 3,960 USD, të cilat janë si vijojnë: “...*Si burim për shlyerjen e kështit të datës 13.9.2005 në vlerën 10,000 USD ka shërbyer dhurata e ardhur në datën 5.4.2004 me vlerë 7,000 euro nga vëllai im A.SH, dhe në datën 17.9.2004 me vlerë 5,740 euro. Diferenca e kësaj vlere, së bashku me të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes dhe kursime të tjera që kisha nga puna si avokat (përfshirë dhe shpërblimet dhe punë jashtë orarit), kanë shërbyer për pagimin e detyrimeve të përshkruara në mandatin e datës 2.10.2005 për punimet shtesë prej 1,270,000 lekësh, si dhe për arredim e kompletim kuzhine në vlerën 239,000 lekë”.*

25.26 Nga hetimi³⁴ rezultuan transfertat ndërkombëtare nga shtetasi A.SH në llogarinë e subjektit në ProCredit Bank, përkatësisht shuma 7,000 euro në datën 5.4.2004, e cila është tërhequr nga subjekti në datën 21.4.2004; shuma 5,760 euro në datën 17.9.2004, e tërhequr në datën 22.9.2004. Shtetasi A.SH (vëllai i subjektit) ka transferuar gjatë vitit 2004 vlerën totale 12,760 euro.

25.27 Në vijim, Komisioni hartoi analizën financiare të shtetasit A.SH, nga e cila rezultoi se ai ka pasur mundësi t'i transferojë vlerën totale 12,270 euro vëllait të tij, subjektit të rivlerësimit, pranë ProCredit Bank në vitin 2004. Në analizë Komisioni nuk do të përfshijë vlerën totale të transfertave si burim krijimi, pasi subjekti nuk i ka deklaruar këto transfertat si burim për apartamentin në rrugën “***”, por në *Vetting* ka deklaruar vetëm vlerën 10,041 euro, e cila nga hetimi rezultoi se nuk është transfertë e kryer nga vëllai, por depozitë kursimi e subjektit.

25.28 Komisioni hartoi analizën financiare me të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes për këstet e shlyera prej tij në vitin 2005, e cila rezultoi me pamundësi financiare në vlerën totale prej 2,542,300 lekësh për të kryer pagesat për apartamentin me burime të ligjshme.

25.29 Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare për pagesat e kryera gjatë vitit 2005, subjekti i rivlerësimit sqaron se është fakt i vërtetuar se vëllai i tij A.SH i ka transferuar në llogarinë e tij pranë ProCredit Bank shumën totale 12,270 euro gjatë vitit 2004. Ndërsa për deklarimin e tij në deklaratën *Vetting* subjekti pranon se ka deklaruar në mënyrë të pasaktë shumën e dhuruar prej tij. Komisioni duhet të mbajë në vlerësim kohën e gjatë që ka kaluar nga momenti i kryerjes së pagesave deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* dhe se në

³³ Subjekti deklaron me pyetësorin nr. 2 se ka nisur të jetojë në këtë apartament pas lidhjes së martesës me bashkëshorten në datën 31.7.2005. Shpenzimet për mobilim janë llogaritur të kryera përpara se subjekti të jetonte në apartament, pra përpara martesës.

³⁴ Shkresat nr. *** prot., datë 25.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 5.3.2021, të ProCredit Bank.

deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar burimi për çdo këst të shlyer, por të çmimit në total. Vlera 10,041 euro dukshëm është një lapsus në mënyrën se si ai i ka lexuar dhe interpretuar të dhënat e *statement*-it bankar. Ky gabim material korrigohet dhe vërtetohet lehtësisht, sepse shumat e dhuruara nga vëllai janë kaluar me transfertë bankare dhe ky dokumentacion i është bashkëlidhur prej tij deklaratës *Vetting*, e cila është e njohur edhe nga praktika e Kolegjit³⁵. Subjekti bashkëlidh konfirmimin e shtetasit A.SH për sa më lart shpjeguar prej tij me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2024.

25.30 Gjithashtu, Komisioni duhet të vlerësojë se shuma 12,740 euro plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni pas hetimit të tij ka arritur në konkluzionin se shtetasi A.SH ka pasur mundësi t'i dhurojë subjektit në vitin 2004 vlerën 12,740 euro dhe në vitin 2008 vlerën 2500 GBP (burim krijimi për këstin e fundit). Këto të ardhura përmbushin kushtet për t'u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, për këtë arsye, ato duhet të përfshihen në analizën financiare. Ndërsa, mbështetur në praktikën e Kolegjit, pasaktësitë si në deklaratat periodike vjetore, edhe në atë *Vetting*, të pashoqëruara me pamjaftueshmëri financiare, nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore³⁶.

25.31 Në analizën e Komisionit duhet të përfshihet si kursime *cash* në vitin 2004 edhe vlera e rezultuar deri në fund të vitit 2004, prej 4,858,629 lekësh. Komisioni ka marrë në konsideratë faktin që në deklarimin e vitit 2004 nuk janë deklaruar likuiditete *cash* dhe, për këtë arsye, nuk ka llogaritur të gjitha kursimet e mundshme që ka pasur deri në këtë periudhë. Në fakt, deklarimi i vitit 2004, në mungesë të njohurive dhe eksperiencës në zbatimin e ligjit për deklarimin e pasurive, nuk ka qenë i plotë dhe, përveç të ardhurave nga paga e vitit 2004, nuk është deklaruar asgjë tjetër. Për këtë arsye, ashtu siç ka rezultuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës kontrolli i pasurisë së subjekteve fillon nga deklarata *Vetting*, por edhe në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen S kundër Shqipërisë, në kushtet kur nuk ka asnjë dyshim për ndonjë sjellje në keqbesim, duhet që në analizën e krijimit të kësaj pasurie të merren në vlerësim burimet e krijimit të pasurisë të këtij apartamenti, ashtu siç i ka deklaruar subjekti në deklaratën *Vetting*, pavarësisht paplotësisë së deklaratës së vitit 2004, pasaktësia e së cilës nuk mund të shërbejë për të nxjerrë diferenca të larta negative.

25.32 Subjekti sqaron se, përveç sa më sipër, provueshmëria e kursimeve *cash* të subjektit arrihet nga analiza e llogarive bankare, gjendjet e të cilave i ka tërhequr gjatë vitit 2004. Në fund të vitit 2003, gjendja e likuiditeteve pranë ProCredit Bank në llogaritë e subjektit rezultoi në vlerën 3,173,164 lekë, ndërsa rezultoi se ai ka tërhequr pjesën më të madhe të saj gjatë vitit 2004, duke rezultuar me gjendjen 34,969 lekë në datën 31.12.2004. Nga *statement*-i bankar provohet edhe vlera e transfertave të kryera nga shtetasi A.SH me vlerë totale 12,760 euro, tërhequr në vitin 2004 prej subjektit.

25.33 Gjithashtu, subjekti sqaron se nga hetimi i Komisionit rezultoi se në vitin 2004 nuk është kryer ndonjë investim apo shpenzim prej tij. Arsyetja e tërheqjes së këtyre vlerave nga llogaritë

³⁵ Vendimi nr. 14/2021 i Kolegjit: "Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ky deklarim i subjektit nuk është i plotë, në përputhje me kërkesat e formularit të deklarimit, megjithatë, në konsideratë të faktit që ky deklarim është shoqëruar nga subjekti me certifikatën për vërtetim pronësie, në cilësinë e dokumentit justifikues në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se mosdeklarimi i këtyre të dhënave nuk ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit për deklarim të saktë dhe të plotë".

³⁶ Vendimi nr. 14/2022 i Kolegjit: "Kolegji... merr në konsideratë edhe faktin që gjithë këto veprime kanë ndodhur përpara se subjekti të emërohej në detyrë. Ky aspekt i fundit përjashton mundësinë teorike të lidhjes së fondeve me përfutime financiare, të cilat nuk mund të justifikohen ligjërisht nga puna e subjektit të rivlerësimit".

bankare ka qenë sepse ia ka huazuar për një kohë të shkurtër kumatës së tij, shtetases D.SH, e cila për shkak të aktivitetit të saj në vitin 2003 ka blerë një apartament të vjetër në rrugën “***”, Tiranë. Në vitin 2004, ajo ka marrë hua nga subjekti i rivlerësimit pasi ka kryer rinovimin/rikonstruksionin dhe mobilimin e të gjithë apartamentit, fakt i dokumentuar sipas dokumentacionit bashkëlidhur³⁷ deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë 4.5.2024, të znj. M.SH. Vlera e huas prej 5,000,000 lekësh është kthyer në korrik të vitit 2005 dhe nga të dhënat e institucioneve tatimore rezulton se shtetasit M.SH dhe A.SH kanë pasur të ardhura të ligjshme për të kthyer vlerën e huas. Komisioni duhet të vlerësojë faktin se në këtë periudhë ata jetonin në të njëjtin apartament në pronësi të vëllait të tij dhe kumatës dhe se subjekti punonte në biznesin e tyre.

Vlerësimi i Komisionit

25.34 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezulton e provuar se shuma totale 12,760 euro është transferuar në llogarinë e subjektit nga shtetasi A.SH në tri transferta të ndryshme gjatë vitit 2004. Gjithashtu, nga analiza financiare rezultoi se ky shtetas ka pasur mundësi të krijojë me të ardhura të ligjshme shumën e transferuar. Ndërsa mosdeklarimi saktësisht i kësaj shume në deklaratën *Vetting*, por deklarimi vetëm i faktit të transfertës nga vëllai A.SH, do të konsiderohet si pasaktësi e subjektit në deklaram, e cila, e parë në harmoni me elementin e provueshmërisë të transfertës së shumës 12,760 euro dhe elementin e provueshmërisë së burimit të ligjshëm të saj, duhet të përfshihet në analizën financiare të subjektit.

25.35 Komisioni çmoi se rezultati financiar i vitit 2004 prej 4,858,629 lekësh duhet të përfshihet si gjendje *cash* në vitin pasardhës, pasi gjatë hetimit rezultoi se: (i) subjekti provoi disponimin real të kësaj gjendjeje pjesërisht nga tërheqja e transfertave të kryera nga shtetasi A.SH në shumën 12,760 euro gjatë vitit 2004 dhe pjesërisht (shuma 2,818,195 lekë) nga tërheqja e gjendjeve bankare dhe depozitave bankare të tij pranë ProCredit Bank në vitin 2004; (ii) subjekti arriti të provojë se kishte pasaktësi në deklaramin e tij në deklaramin si OPGJ në vitin 2004, por ai nuk e dispononte si gjendje *cash* vlerën e tyre, e cila i ishte dhënë hua shtetases M.SH dhe shtetasit A.SH për investime të tyre, të cilat u provuan me dokumentacion; (iii) subjekti, edhe pse jo saktësisht, ka deklaruar në deklaratën *Vetting* vlerën 10,041 euro, e cila u provua nga hetimi i Komisionit se ishte mbajtur si depozitë kursimi dhe ishte tërhequr në vitin 2004, pra e ka deklaruar këtë kursim/depozitë; (iv) periudha e kryerjes së këtyre veprimeve rezulton të jetë përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

25.36 Në përfundim, pas përgjigjes së subjektit dhe vlerësimit të provave, Komisioni hartoi analizën financiare për pagesën e kësteve për apartamentin gjatë vitit 2005 si në vijim³⁸.

³⁷ Deklaratë noteriale e datës 15.9.2002 midis shtetaseve M dhe A.SH dhe shtetasit Q.C, ku deklarohet se kanë lidhur kontratë shitjeje për një apartament në rrugën “***”, me çmim shitjeje 100,000 USD; njoftim për lirim dhe dorëzimin e apartamentit, ku deklarohet se kësti i fundit është shlyer në janar 2003; deklaratë e thjeshtë, ku deklarohet nga shtetasi E.C (djali i shtetasit Q.C, shtetit) se ka marrë shumën 30,000 USD, e cila është shuma përfundimtare për shlyerjen e çmimit të apartamentit; foto të objektit; vërtetimi të deklaramit të të ardhurave nga zyra e noterisë për periudhën 1994 – 2005 (xhiroja e deklaruar e vitit 2005 është 8,000,000 lekë - 80% marzhi i fitimit = 6,400,000 lekë).

³⁸ Në analizën financiare është përfshirë vlera 4,000 USD marrë në gusht 2003 nga shtetasi G.ZH; është përfshirë vlera e rezultuar nga vërtetimi për shoqëritë huamarrëse në administrim në vlerën 873,113 lekë, në tetor 1999 dhe, për këtë arsye, analiza financiare fillon në këtë periudhë që rezultojnë të ardhura; është llogaritur rezultati financiar i vitit 2001, duke zbritur nga shpenzimet jetike për një anëtar dhe viti 2002 për gjithë periudhën (janar-dhjetor); është përfshirë si e ardhur nga avokatia në vitet 2002 – 2003 vlera totale prej 1,573,940 lekësh, respektivisht në tabelë vlera sipas periudhës kohore objekt analize.

Tabela nr. 4

Analiza kumulative tetor 1999 – korrik 2005	Shumat në lekë
Të ardhura nga kompanitë rentiere (V sh.p.k.)	873,113
Të ardhura nga paga si OPGJ	1,519,989
Të ardhura nga puna si avokat	1,573,940
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	27,370
Të ardhura total	3,994,412
Transfertat në ProCredit Bank nga shtetasi A.SH	1,617,202
Hua e marrë nga shtetasi G.ZH	434,760
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	32,289
Pagesa e këstit të parë për apartamentin	982,558
Pagesa e kësteve për apartamentin të kryera në vitin 2005	2,542,300
Shpenzime jetike	601,049
Rezultati financiar	1,888,179

25.37 Në analizën përfundimtare të Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kryejë me të ardhura të ligjshme pagesat për apartamentin e ndodhur në rrugën “D.B” gjatë vitit 2005.

Kësti i fundit 3,960 USD, datë 10.5.2008

25.38 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “A.SH (vëllai), i biri i D, i datëlindjes 3.4.1974, lindur në Rr, Mat dhe banues në Londër, me pasaportë nr. ***, datë 23.6.2013, dhuratë... në datën 28.5.2008 shuma 2,500 GBP. Burimi: të ardhura nga puna në fushën e ndërtimit nga viti 1999 e në vazhdim, me të ardhura të deklaruara nëpërmjet bankës ...në datën 28.5.2008 kaluar në llogarinë *** në GBP, RFZ”.

25.39 Nga hetimi i Komisionit³⁹ rezultoi se në datën 28.5.2008, në llogarinë rrjedhëse ***, ka kaluar shuma 2,500 GBP me përshkrimin “Kalim nga ***”, e cila është tërhequr më 4.12.2008 nga subjekti i rivlerësimit.

25.40 Me pyetësorin nr. 2⁴⁰ subjekti ka shpjeguar: “Në lidhje me këtë pyetje, unë i jam drejtuar Raiffeisen Bank, e cila me shkresën nr. ***, datë 1.6.2023, më është përgjigjur se: lidhur me informacionin e kërkuar për një transfertë të kryer në llogarinë tuaj ***, për shumën 2,500 GBP në datën 28.5.2008, konfirmojnë se mbas verifikimeve të kryera nuk është bërë e mundur të gjenerohen të dhëna nga sistemi në lidhje me urdhëruesin e transfertës, pasi bëhet fjalë për një transfertë që është kryer që në vitin 2008⁴¹”.

25.41 Në vijim, Komisioni hartoi analizën financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit A.SH, që të hetonte mundësinë e tij për të dhënë hua vlerën 2,500 GBP me të ardhurat e periudhës 2001

³⁹ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁴⁰ Pyetja nr. ***, pyetësori nr. 2. Subjekti bashkëlidh me përgjigjen e tij shkresën e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 1.6.2023, në të cilën informojnë se janë në pamundësi të japin informacion për sa kërkuar nga subjekti i rivlerësimit për shkak të periudhës së gjatë kohore.

⁴¹ Edhe nga hetimi i Komisionit rezultoi e njëjta përgjigje nga institucioni (shihni shkresën nr. ***, datë 28.3.2024, të Raiffeisen Bank).

– 2007, analizë nga e cila rezultoi se kishte mundësi për të dhënë këtë vlerë me të ardhura të ligjshme.

25.42 Komisioni nuk e përfshiu si burim të ligjshëm për pagesën e kështit të fundit të apartamentit vlerën e transfertës prej 2,500 GBP, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti e kishte tërhequr këtë shumë në datën 4.12.2008 nga llogaria e tij në Raiffeisen Bank, pra pasi ishte shlyer kësti i apartamentit sipas mandatarkëtimit datë 10.5.2008.

25.43 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare për pagesën e fundit të kryer në maj 2008, sqaron se ky këst është paguar sipas mandatit të paraqitur së bashku me deklaratën *Vetting* në datën 10.5.2008, në të cilën ai nuk ka deklaruar burimin e çdo kësti, por ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë. Subjekti sqaron se në deklaratën *Vetting* ai ka deklaruar si burim krijimi për pasurinë edhe të ardhurat e tij e të bashkëshortes nga pagat dhe kursimet e realizuara prej tyre, me të cilat kanë shlyer këstin e apartamentit.

Vlerësimi i Komisionit

25.44 Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të krijimit të pasurisë të ardhurat nga paga si OPGJ ndër vite, të ardhurat si avokat dhe shumën e transferuar nga vëllai A.SH pranë ProCredit Bank. Në vlerësimin e tij, Komisioni çmon se të ardhurat nga paga dhe kursimet e subjektit dhe bashkëshortes duhet të përfshihen si burim për pagesën e kësteve të apartamentit dhe, në vijim të analizës financiare të kryer prej tij, paraqitur në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të kryejë pagesën e kështit të fundit me të ardhura të ligjshme.

Tabela nr. 5

Analiza kumulative tetor 1999 – 10.5.2008	Shumat në lekë
Të ardhura nga kompanitë rentiere (V sh.p.k.)	873,113
Të ardhura nga paga si OPGJ	3,490,252
Të ardhura nga puna si avokat	1,573,940
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes	1,178,383
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***	200,000
Dhuratë nga vëllai shtetasi A.SH në vitin 2004, në shumën 12,760 euro	1,617,202
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	28,808
Të ardhura total	8,961,699
PASURI	
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	412,725
Apartamenti në rr. “****”	3,885,059
Automjeti me targë ***, blerë në datën 20.3.2007	250,000
Total pasuri	4,662,725
DETYRIME	
Huaja e marrë nga shtetasi N.Q	2,118,212
PASURI NETO	2,544,514
Shpenzime mirëmbajtjeje të automjetit me targë ***	132,983
Shpenzime udhëtimi	58,123
Shpenzime jetike	1,480,123
Rezultati financiar	4,860,897

25.45 Komisioni, në përmbledhje të sa trajtuar për pasurinë apartament të ndodhur në rr. “****”, me rezultatet e hetimit i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit në shumën totale -3,844,008 lekë, por pas përcjelljes së parashitimeve dhe gjatë seancës dëgjimore subjekti arriti të shpjegojë në mënyrë shteruese, bindëse dhe të mbështetur në dokumentacion, duke e reduktuar pamundësinë financiare për këtë pasuri vetëm në vlerën e kështit të parë prej -982,558 lekësh.

26. Apartament me sipërfaqe 96.5 m² në rrugën “**”,** hyrja ***, ap. ***, regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***, volumi ***, faqe *** (kontratë porosie nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015, kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 20.10.2016; paguar me këste, datë 8.9.2015, shuma 40,000 euro; datë 8.3.2016, shuma 39,952 euro; datat 18.10.2016 dhe 20.10.2016, shuma 22,840 euro. Vlera 12,720,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit⁴²: (a) llogari kursimi *** në emër të shtetasës D.SH në Union Bank, krijuar me të ardhurat ndër vite; (b) hua nga E.Q me aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.9.2016 (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); (c) kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014; (d) shitja e apartamentit me sip. 89.95 m², me nr. pasurie ***, rruga “****”, hyrja ***, ap. ***, Tiranë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016, në vlerën 85,000 euro.

26.1 Gjithashtu, subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting* shpenzime për mobilimin e këtij apartamenti, i cili ka burim krijimi pjesërisht burimet e mësipërme: shpenzime për mobilimin e apartamentit me sipërfaqe 96.5 m² në rrugën “****”, hyrja ***, ap. ***, regjistruar në z. k. ***, me nr. pasurie ***, volumi ***, faqe ***. Vlera: 11,000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: a) hua nga E.Q me aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.9.2016 (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); b) kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014; c) nga shitja e apartamentit në vlerën 85,000 euro.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

26.2 Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 *“Apartament banimi, me sipërfaqe 105.5 m² ... me adresë rruga “****”, ish-S, Tiranë. Kontratë porosie nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015, me shoqërinë “K” sh.p.k. Vlera: 92,840 euro. Në çastin e lidhjes së kontratës, paguar 40,000 euro me burim: a) shuma 2,682,9231 lekë (19,399 euro) llogari kursimi *** në emër të znj. D.SH, Union Bank; b) shuma 5,000 USD (4,482 euro), hua nga z. E.Q, marrë në muajin shtator 2015. c) shuma 1,010,000 lekë + 5,000 euro pakësuar cash, në banesë para datës 31.12.2014; d) shuma 994,25 USD, tërheqje nga llogaria ***-USD, Afrim Shehu RFZ Bank; e) shuma 1,600 USD cash të ardhura, Kroaci; f) teprica, kursime gjatë vitit 2015, të konvertuara gjithsej 1,622 euro”*.

⁴² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* (shihni aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së) për mënyrën e fitimit dhe të regjistrimit të pasurisë dokumentacionin justifikues si vijon: certifikatë për vërtetim pronësie, datë 25.10.2016, për apartamentin me sipërfaqe 96.5 m² në rrugën “****”, hyrja ***, ap. ***, në emër të shtetasve Afrim dhe D.SH; kartelë të pasurisë me datë regjistrimi 25.10.2016; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016, e apartamentit me sipërfaqe 96.5 m² në rrugën “****”, hyrja ***, ap. ***, në vlerën 92,840 euro, ekuivalente me 12,720,000 lekë - shuma është shlyer me këste dhe jashtë zyrës noteriale; certifikatë për vërtetim pronësie, datë 8.7.2016, për apartamentin me sipërfaqe 96.5 m² në rrugën “****”, hyrja ***, ap. ***, në emër të shoqërisë “K” sh.p.k., kartela e pasurisë; kontratë porosie nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015 për apartament me sipërfaqe 96.5 m² në rrugën “****”, në vlerën 92,840 euro, sipas së cilës 40,000 euro do të paguheshin me nënshkrimin e kontratës; 50,000 euro në dorëzimin e apartamentit dhe 2,840 euro me marrjen e hipotekës. Kontratë shitjeje apartamenti nr. *** rep., *** kol., datë 20.10.2016, ku Afrim Shehu shet apartamentin me sip. 89.95 m² në vlerën 85,000 euro, pagesë e cila do të kalojë nëpërmjet bankës në llogarinë e noterit; certifikatë për vërtetim pronësi, datë 4.12.2012, për apartamentin me sip. 89.95 m² në emër të shtetasve Afrim dhe D.SH; kartelë e pasurisë datë 4.12.2012, në emër të shtetasve Afrim dhe D.SH.

Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 96.50 m², me adresë në rrugën “***”, hyrja ***, apartamenti ***, regjistruar në z. k. ***, me numër pasurie ***, volumi ***, faqe *** (kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016, paguar më këste, datë 8.9.2015, vlera 40 000 euro; datë 8.3.2016 – vlera 39,952 euro, datë 18.10.2016 dhe 20.10.2016, vlera 22,840 euro). Vlera: 12,720,000 lekë. Burimi i krijimit: a) llogari kursimi 111316607230114 në emër të znj. D.SH, b) hua nga z. E.Q 1,010,000 lekë, akti noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.9.2016 (e shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); c) kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014; d) shitja e apartamentit me sipërfaqe 89.95 m² me numër ***, në rrugën “***”... në vlerën 85,000 euro”.

26.3 Rezultoi e provuar nga hetimi⁴³ se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë në bashkëpronësi pasurinë apartament me sip. 96. 5m² regjistruar në zonën kadastrale ***, me nr. ***, volumi ***, faqe ***, të ndodhur në Rrugën “***”, regjistruar në datën 25.10.2016, e fituar nga kontratë shitjeje nr. *** datë 20.10.2016 me shumë të paguar në vlerën 92,840 euro ose ekuivalenti prej 12,720,000 lekë, likuiduar me këste jashtë zyrës noteriale, sipas kontratës së porosisë nr.*** rep/*** kol., datë 8.9.2015. Ndërsa në kontratën porosie nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015, informohemi se bashkëshortja znj. D.SH ka porositur nga shoqëria K sh.p.k. apartamentin me sip. të përgjithshme 105.5 m², nga e cila 96.5 m² sip. e brendshme është e hipotekueshme dhe sipërfaqe funksionale/përbashkët 9 m² me çmim total prej 92,840 m².

26.4 Me pyetësonin nr. 2 subjekti përcjell dokumentacion për pagesat e kryera për këtë apartament, për të cilin sqaron: “Siç kam deklaruar, pagesa e kështit të parë për apartamentin... është kryer në datën 8.9.2015, në arkën e shoqërisë “K” sh.p.k., kundrejt mandatit përkatës të datës 8.9.2015. Ndërsa kështet e tjera janë paguar nëpërmjet bankës. Bashkëlidhur kontrata e porosisë nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015, mandat arkëtimi i datës 8.9.2015 në vlerën 40,000 euro, si dhe statement i bankës datë 22.5.2023, në të cilin janë përshkruar pagesat në vlerën 30,000 euro në datën 9.3.2016, vlera 20,000 euro në datën 18.10.2016 dhe vlera përfundimtare 2,840 euro në datën 20.10.2016. Në total, vlera e paguar është 92,840 euro”.

26.5 Në mënyrë të përmbledhur, pagesat e kësteve të apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, janë si më poshtë:

Tabela nr. 6

Kështet në kontratën e porosisë	Vlera	Kështet sipas provave	Vlera
Datë 8.9.2015	€ 40,000	Datë 8.9.2015 (në arkën e shoqërisë)	€ 40,000
Datë 31.10.2015	€ 50,000	Datë 9.3.2016 (Raiffeisen Bank)	€ 30,000
		Datë 18.10.2016 (Raiffeisen Bank)	€ 20,000
Datë 25.10.2016	€ 2,840	Datë 20.10.2016 (Raiffeisen Bank)	€ 2,840
Totali	€ 92,840	Totali	€ 92,840

26.6 Gjithashtu, subjekti⁴⁴ për mospërputhjen në deklarime në deklaratën Vetting për pagesat e përshkruara prej tij, të cilat rezultojnë në shumën 102,792 euro, me vlerë pasurie 12,720,000 lekë

⁴³ Shkresat nr. *** prot., datë 6.4.2021 dhe nr. *** prot., datë 20.11.2023, të ASHK-së.

⁴⁴ Pyetësoni nr. 2, pyetja 13.

~ 92,840 euro, sqaron: “...shpjegoj se ka një gabim material në formën se si jam shprehur në deklaram në lidhje me pagesën e këstit të dytë. Vlera e saktë e paguar nga unë nëpërmjet bankës është 30,000 euro, ndërkohë që është deklaruar si e paguar në këtë datë vlera 39,952 euro. Ky gabim në deklaram ka ndodhur për shkak se gjatë hedhjes së të dhënave në deklaratë gabimisht nga ana ime është vendosur vlera e kredituar nga shtetasi E.Q, që ishte 39,952 euro dhe jo vlera e debituar pranë shoqërisë “K” sh.p.k., që është 30,000 euro”.

26.7 Për shkak se subjekti ka deklaruar si burim për apartamentin e ndodhur në rrugën “****” të ardhurat nga shitja e apartamentit me numër pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, faqe ***, me sip. 89.95 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, trajtimi i kësaj pasurie është si vijon:

26.8 Rezultoi se kjo pasuri është deklaruar prej bashkëshortes të subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, si vijon: “Apartament banimi me sip. 103 m², dy dhoma e një kuzhinë në rrugën “****”. Kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., ** kol., datë 4.6.2008, notere V.S. Vlera: 61,800 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: 1- Dhuratë nga babai 40,000 euro. Deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 27.10.2009, notere V.S. 2- Hua sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 12.9.2005, vlera 23,000 USD, marrë nga N.Q (kunati)”. Ndërsa shitja e tij deklarohet në deklaratën e vitit 2016, ashtu si dhe në deklaratën e pasurisë.

26.9 Nga hetimi⁴⁵ i Komisionit rezultoi se pasuria aktualisht është e regjistruar në emër të shtetasit B.P.K, regjistruar në datën 3.9.2018, me kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.8.2018.

26.10 Rezultoi e provuar⁴⁶ se prona është regjistruar në ZVRPP Tiranë në emër të shtetasve Afrim dhe D.SH sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2012, ku çmimi i blerjes është 6,341,775 lekë. Gjithashtu, përcillet edhe kontratë e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016, ku shtetasit Afrim Shehu dhe bashkëshortja e tij në cilësinë e palës shitëse shesin apartamentin me sip. 89.95 m², me adresë në rrugën “****”, në vlerën 85,000 euro, pala blerëse R.B.

26.11 Nga hetimi i llogarive të subjektit pranë Raiffeisen Bank, rezultoi se në datën 17.10.2016 është transferuar shuma 85,000 euro nga M.LL – person fizik me përshkrimin “Sipas kontratës *** rep., *** kol., datë 8.10.2016”. Komisioni kërkoi⁴⁷ shpjegime mbi transferimin e vlerës së shitjes së apartamentit të realizuar 3 ditë përpara datës së nënshkrimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016, për të cilën subjekti sqaroi: “Kjo vlerë është transferuar në datën 17.10.2016 në llogarinë time, për shkak se veprimi noterial kishte përfunduar në këtë datë dhe kontrata me nr. *** rep, nr. *** kol., datë 8.10.2016, ishte dërguar për regjistrim në hipotekë. Në datën 18.10.2016, noteri ka konstatuar se pasuria objekt shitjeje nuk ishte rivlerësuar dhe në këtë datë është bërë aplikim për rivlerësim. Rivlerësimi ka përfunduar në datën 18.10.2016. Pas këtij veprimi, noteri në datën 20.10.2016 na ka thirrur të dyja palët dhe, për të mos kryer veprim për anulimin e kontratës së mëparshme, ka regjistruar të njëjtën kontratë në datën 20.10.2016, duke i vënë aktit noterial numra rep. dhe kol., që përkojnë me datën 20.10.2016. Pra, kemi të bëjmë me të njëjtën kontratë, në të cilën është e njëjta pasuri, të njëjtat palë dhe e njëjta vlerë 85,000 euro.

⁴⁵ Shkresë e ASHK-së nr. *** prot., datë 24.3.2021 dhe në dosjen ILDKPKI, aneks 28.

⁴⁶ Aneks 4/3, dosja ILDKPKI, dokumentacioni i përcjellë nga subjekti: certifikatë për vërtetim pronësie, datë 4.12.2012, për apartamentin me sip. 89.95 m² në emër të shtetasve Afrim dhe D.SH dhe kartelë e pasurisë me datë regjistrimi 5.12.2012, me shumë të paguar 6,341,775 lekë. Gjithashtu edhe përgjigjja e ZRVP-së Tiranë, aneks 28, dosja e ILDKPKI-së.

⁴⁷ Pyetësori nr. 2, pyetja 8.

Këtë fakt e ka sqaruar noterja M.LL në datën 25.5.2023". Subjekti bashkëlidhi me shpjegimet dokumentacion⁴⁸ provues nga praktika e noterit dhe nga banka për pagesat e kryera.

26.12 Nga hetimi⁴⁹ rezultoi se nga apartamentet që përfitohen nga shtetasi S.T si pronar trualli, sipas kontratës së shitjes me rezervë nr. ***, datë 4.6.2008, shtetasi D.SH ka blerë prej tij apartamentin me sip. 91 m², sip. shkalle 8.9 m² dhe ambiente shërbimi 3.1 m², në vlerën 61,800 euro. Në zbatim të kontratës së shitjes me rezervë, shoqëria ndërtuese "N" sh.p.k. deklaroi se ka pranuar kërkesën e shtetasit D.SH për kryerjen e punimeve të brendshme në vlerën 10,000 euro, kostoja e të cilave do të shlyhet prej saj dhe përmbushja e detyrimit në këtë vlerë ndaj pronarit të truallit S.T do të kryhet nga shoqëria "N" sh.p.k.

26.13 Subjekti sqaroi⁵⁰ për ndryshimin e çmimit të blerjes midis kontratës së sipërmarrjes me vlerë 61,800 euro ~ 7,612,679 lekë me çmimin e blerjes së cituar në kontratën e shitjes prej 6,341,775 lekësh se: *"Nga përfaqësuesi i shoqërisë jam sqaruar se ndryshimi i çmimit të blerjes midis kontratës së sipërmarrjes me vlerë 61,800 euro me çmimin e blerjes së cituar në kontratën e shitjes vjen pasi ishte detyrimi i kompanisë "N" sh.p.k. që të dorëzonte të përfunduar apartamentin e porositur prej znj. D.SH për llogari të z. S.T në cilësinë e pronarit të truallit, detyrim që vinte nga kontrata e sipërmarrjes të nënshkruar nga administratori i shoqërisë "N" sh.p.k. dhe nga z. S.T në cilësinë e pronarit të truallit. Më pas, kjo vlerë është zbritur nga vlera totale e kontratës së sipërmarrjes. Vlera e ndryshuar është reflektuar më pas në kontratën e shitjes, duke vendosur vlerën e shitjes 6,341,775 lekë. Pra, nga vlera totale është zbritur shuma 10,000 euro".* Bashkëlidhur shpjegimeve përcjell kopje të situacionit të punimeve për objektin "Punime shtesë dhe mobilim apartamenti", me vlerë totale 2,480,940 lekë dhe mandatpagesë datë 13.10.2009, me vlerë totale 18,000 euro, arkëtuar nga shtetasja D.SH me përshkrimin "Parapagim për punime shtesë dhe mobilim apartamenti nr. ***, në objektin me leje ndërtimi nr. ***, datë 6.6.2006".

26.14 Komisioni hetoi⁵¹ edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me palët⁵² e përfshira në transaksionet në lidhje me këtë pasuri dhe nga hetimi nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

26.15 Në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rr. "****", subjekti deklaroi në deklaratën e pasurisë se shuma 34,000 euro është paguar në datën 4.6.2008, me burim dhurim nga shtetasi P.GJ (vjeherri i tij). Gjatë hetimit përcjell kopje të mandatpagesës datë 13.10.2009, me vlerë totale 18,000 euro, të shlyer për punime shtesë dhe mobilim apartamenti, me vlerë totale 2,480,940 lekë dhe kopje të kontratës së shitjes së pasurisë të paluajtshme apartament banimi me rezervë, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2008, e lidhur para noterit V.S nga bashkëshortja e tij me shtetasin S.T për shitjen me rezervë të apartamentit të banimit me sipërfaqe 91 m², kontratë në të cilën parashikohet se kësti i parë prej 34,000 euro në dorë, shlyer në prezencë të noterit dhe kësti i dytë prej 27,800 euro do të likuidohet brenda datës 31.12.2008 nëpërmjet kredisë bankare që pala blerëse do të marrë për këtë qëllim.

⁴⁸ Kopje të praktikës së noterit për kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2016, të njësuar me origjinalin; shkresë-sqarim dhe dërgim dokumentacioni në datën 25.5.2023 nga noterja M.LL; kontratë nr.*** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016; kopje të fletëve të regjistratit të përgjithshëm të akteve dhe veprimeve noteriale në të cilin janë pasqyruar dy kontratat e mësipërme në formatin A3. Gjithashtu, përcillen edhe kopje të mandatpagesave të bëra nga blerësi i apartamentit R.B në datën 13.10.2016, në llogarinë e noterit.

⁴⁹ Aneks 41, dosja e ILDKPKI-së, shkresë datë 7.10.2009, nga shoqëria "N" sh.p.k.

⁵⁰ Pyetësori nr. 2, pyetja 9.

⁵¹ Shkresë nr. ***prot., datë 18.9.2023, bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

⁵² Shoqëria "N" sh.p.k. dhe/ose ortakët/administratorët e kësaj shoqërie, E.Q, S.T, M.T, shoqëria "K" sh.p.k. dhe/ose ortakët/administratorët e kësaj shoqërie, A.K, S.K, R.Y.B, B.P.K.

26.16 Në vijim, Komisioni përfshiu në analizën financiare vlerën totale prej 79,800 euro, e cila përfshin çmimin e blerjes së apartamentit në shumën 61,800 euro sipas parashikimeve të kontratës së shitjes së pasurisë të paluajtshme me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2008, duke i shtuar çmimit të kontratës vlerën 18,000 euro për punime shtesë, sa rezultuar gjatë hetimit nga mandatpagesa datë 13.10.2009. Kjo pasi subjekti nuk arriti të provojë se pala shitëse, shtetasi S.T, ishte likuiduar nga shoqëria “N” sh.p.k. për diferencën e vlerës prej 10,000 euro të punimeve të kryera nga shoqëria, por të financuara nga shtetasja D.SH. Në vijim, tabela e shlyerjes së kësteve për apartamentin e ndodhur në rr. “****”, e përfshirë në analizën e Komisionit:

Tabela nr. 7

Data e kështit	Vlera
Kësti i parë datë 4.6.2008	34,000 euro
Kësti i dytë datë 31.12.2008 (sipas kontratës së shitjes me rezervë)	27,800 euro
Kësti i tretë datë 13.10.2009	18,000 euro
Totali	79,800 euro

26.17 Subjekti pas kalimit të barrës së provës shpjegon se bashkëshortja e tij ka kërkuar që punimet e brendshme të kryhen nga shoqëria sipas kërkesave dhe orientimeve të saj, kostoja e të cilave u llogarit rreth 10,000 euro dhe u pranua nga palët se përmbushja e detyrimit në këtë vlerë ndaj pronarit të truallit S.T do të bëhej nga shoqëria ndërtuese. Pra, kostoja respektive e këtyre punimeve, vlerësuar në shumën 10,000 euro, ishte detyrim i shoqërisë të përmbushej ndaj pronarit të truallit S.T dhe jo e blerësve të apartamentit. Ky detyrim i është shlyer nga shoqëria ndërtuese pronarit të truallit me mandatin nr. 13, datë 13.1.2010 dhe është konfirmuar nga administratori i shoqërisë me deklaratën e datës 23.4.2024, përcjellë bashkëlidhur me prapësimet.

26.18 Subjekti shpjegon se vlera e shlyer tek shtetasi S.T nuk ishte 61,800 euro ~ 7,612,679 lekë, por 6,341,775 lekë ~ 51,483⁵³ euro, ashtu siç është përcaktuar në kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2012, me shtetasin S.T. Pra, shtetasit S.T i është dhënë 10,000 euro më pak nga subjekti dhe bashkëshortja, përkatësisht me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes i janë dhënë 34,000 euro dhe në vazhdim edhe 17,800 euro, që së bashku rezultojnë në vlerën 6,341,775 lekë ~ 51,483⁵⁴ euro, vlerë e cila është përcaktuar në kontratën e shitjes së apartamentit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2012.

Vlerësimi i Komisionit

26.19 Komisioni vlerësoi se duke u mbështetur në praktikën e tij analiza financiare duhet përditësuar, duke përfshirë si çmim blerjeje për apartamentin vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes, me të cilën është bërë edhe regjistrimi i apartamentit pranë zyrave të kadastrës. Gjithashtu, subjekti arriti të provojë me dokumentacion ligjor, në të cilin përfshihet deklarami i të gjitha palëve, se vlera totale e këtij transaksioni (blerja e apartamentit) është në shumën 61,800 euro dhe jo më shumë.

26.20 Lidhur me burimin e krijimit për apartamentin e ndodhur në rr. “**”, Tiranë,** bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës 2009 se si burim për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., *** kol., datë 4.6.2008, me vlerë 61,800 euro, kanë shërbyer:

⁵³ Kursi i këmbimit viti 2008 euro/ALL =123.1825.

⁵⁴ Kursi i këmbimit viti 2008 euro/ALL =123.1825.

26.20.1 Dhuratë nga babai i bashkëshortes 40,000 euro me deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 27.10.2009. Subjekti përcolli kopje të dokumentacionit provues për të ardhurat e ligjshme të përfituara në shtetin grek nga shtetasi P.GJ, mbi të cilat Komisioni hartoi analizën financiare për periudhën 2003 – shkurt 2008 për vlerën e dhuruar prej 40,000 euro. Rezultoi se vjehri i subjektit të rivlerësimit kishte mundësi të dhuronte vetëm vlerën 31,501 euro me burim të ligjshëm. Në analizën e tij, Komisioni përfshiu këtë shumë si burim për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “****”.

26.20.2 Hua sipas kontratës nr. ***kol., *** rep., datë 12.9.2005, vlera 23,000 USD, marrë nga N.Q (kunati). Në DPFD-në 2009, bashkëshortja deklaroi për huan: *“Hua në shumën 23,000 USD për blerje shtëpie sipas kontratës nr. ***, datë 12.9.2005, me afat 10 vjet, duke shlyer nga 2,300 USD në vit. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, vlera prej 11,500 USD”*. Për këtë deklaramin subjekti ka shpjeguar gjatë procesit të rivlerësimit se kjo vlerë ka burim të ardhurat në shtetin anglez të shtetasit G.ZH, bashkëjetuesi i mbesës, shtetases M.Q. Huaja është formalizuar me kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2005, me shtetasin N.Q dhe 4,000 USD janë marrë *cash* në muajin gusht të vitit 2003 për t’u përdorur për pagesat e apartamentit të ndodhur në rr. “****”, pasuri e trajtuar më lart. Ndërsa shuma 15,296 euro i është transferuar në llogarinë e tij bankare pranë ProCredit Bank, në muajin tetor 2005. Nga hetimi⁵⁵ rezultoi se në datën 5.10.2005 ka mbërritur transfertat ndërkombëtare me vlerë 15,296.4 euro, me urdhërues shtetasin G.ZH.

26.20.3 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se nga hetimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit rezultoi se në llogarinë e tij pranë Alpha Bank i është transferuar shuma 9,000 euro në datën 5.3.2009 nga shtetasi B.F. Subjekti⁵⁶ shpjegon se: *“...për transfertën e datës 5.3.2009 nga B.F në shumën 9,000 euro, kam për të shpjeguar se B.F është bashkëshorti i shtetases J.F. Kjo shtetase është halla e bashkëshortes sime D. Shtetasit B.F dhe J.F jetojnë të dy në Greqi, me leje qëndrimi”*.

26.20.4 Komisioni hetoi⁵⁷ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasin B.F nga i cili nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këtë shtetas.

26.20.5 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në lidhje me burimin e ligjshëm të transfertës 15,296.4 euro në datën 5.10.2005, në ProCredit Bank, shtetasi G.ZH rezultoi se ka pasur mundësi ta japë këtë shumë hua me të ardhura të ligjshme.

26.20.6 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit të ndodhur në rr. “****”, Tiranë, rezultuar nga analiza financiare në shumën 4,065,392 lekë dhe mbi diferencën në shumën totale të burimeve të deklaruara prej bashkëshortes, në vlerën 55,296⁵⁸ euro, me vlerën e çmimit të blerjes së apartamentit, në shumën 61,800 euro. Gjithashtu, i kërkoi shpjegime për arsyen e marrjes së huas prej 23,000 USD nga bashkëshortja dhe subjekti në vitin 2005, ku nga hetimi rezultoi se kontrata e shitjes me rezervë për apartamentin e ndodhur në rr. “****” është lidhur në vitin 2008 dhe po në të njëjtin vit ka nisur edhe shlyerja e kësaj huaje. Subjekti duhet të japë shpjegime edhe për vlerën e transferuar nga shtetasi B.F në llogarinë e tij mbi qëllimin e transfertës dhe mënyrën e përdorimit të saj.

⁵⁵ Shkresat e ProCredit Bank nr. *** prot., datë 25.11.2022; nr. *** prot., datë 5.3.2021; nr. *** , datë 31.5.2023.

⁵⁶ Pyetësori nr. *** , pyetja nr. 30.

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

⁵⁸ Subjekti ka sqaruar se 4,000 USD janë përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit në rrugën “****”.

26.20.7 Subjekti pas kalimit të barrës së provës shpjegon se Komisioni ka përlogaritur mundësinë financiare të shtetasit P.GJ nga viti 2003 – shkurt 2008, por ajo duhet të rishikohet, duke përfshirë edhe të ardhurat e tjera të përfituara prej tij. Bashkëlidhet me shpjegimet vërtetimi nr. ***, datë 12.1.2021, me të cilin konfirmohet se shtetasi P.GJ ka përfutuar pension të parakohshëm nga mbyllja e minierës së hekur-nikelit në P që nga viti 1995.

26.20.8 Subjekti sqaron se kryesisht për mobilimin në vitin 2008 (pra, si pjesë e shumës 18,000 euro, shlyer pranë shoqërisë “N” sh.p.k.) babai i bashkëshortes i ka dhuruar shumën 9,000 euro, që ka shërbyer për punimet shtesë apo mobilimin në vitin 2009, dhe është transferuar në llogarinë bankare pranë Alpha Bank të subjektit, në datën 5.3.2009, nga shtetasi B.F, bashkëshorti i motrës së shtetasit P.GJ. Në lidhje me këtë transfertë është përcjellë deklarimi i shtetasit B.F para noterit në shtetin grek, si vijon: *“...në datën 5.3.2009 kam transferuar në llogarinë e shtetasit Afrim Shehu shumën monetare prej 9,000 euro, shumë kjo e cila ishte e kumatit tim, z. P.GJ, i cili këto të ardhura i kishte nga puna e tij në Greqi”*. Ky fakt është konfirmuar nga shtetasi P.GJ me deklaratën noteriale nr. *** rep, nr. *** kol., datë 4.5.2024, në të cilën deklaron se: *“Rreth viteve 2000 kam emigruar në Greqi... Nga të ardhurat e siguruara në Greqi unë i kam dhuruar vajzës sime D.SH shumën prej 40,000 euro në muajin mars 2008, për ta përdorur për nevojat e saj si blerje banese apo për çdo nevojë tjetër që mund të kishte vajza ime D. Shuma e të hollave i është dhënë pa asnjë lloj kundërshtërimi. Në muajin mars të vitit 2009, unë kam komunikuar me vajzën time D dhe më ka kërkuar edhe një vlerë prej 9,000 euro, të cilat i duheshin për disa punime dhe mobilimin e apartamentit që ajo kishte porositur më parë. Duke qenë se unë nuk kisha llogari bankare, ia kam dhënë bashkëshortit të motrës së z. B.F, të cilit i kam kërkuar që t’ia dërgonte Afrim Shehut, bashkëshortit të vajzës sime D”*.

26.20.9 Subjekti shpjegon se dhurimi i shumës 9,000 euro nuk është deklaruar si burim për krijimin e apartamentit, për shkak se kjo shumë ka shërbyer kryesisht për shpenzimet e kryera për mobilim. Sipas tij, në vitin 2007 dhe 2008 nuk ishin objekt deklarimi shpenzimet e kryera, pra kishte një vakuum ligjor. Shpenzimet e deklarueshme janë parashikuar si objekt deklarimi vetëm pas ndryshimeve ligjore, që u bënë në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, me ligjin nr. 85, datë 18.9.2012.

26.20.10 Për sa më sipër, subjekti sqaron se shuma 49,000 euro duhet të përfshihet në analizën financiare si burim për krijimin e kësaj pasurie dhe mobilimit të saj, bazuar në faktet se: (i) dhurimi është dokumentuar me dokumentacion të kohës; (ii) transfertat e shumës 9,000 euro vërtetohet nga transaksioni bankar; (iii) shtetasi P.GJ ka kalime të shumta në kufirin me shtetin grek, duke nisur nga muaji mars 1999, fakt i cili tregon mundësinë e tij për të sjellë në Shqipëri shumat *cash*; (iv) shtetasi P.GJ ka mundësi të mbulojë me të ardhura të ligjshme shumën e dhuruar për blerjen e apartamentit dhe kryerjen e shpenzimeve.

26.20.11 Ndërsa në lidhje me vlerën e mbetur prej 15,296 euro të huas së marrë me kontratë nr. *** rep., *** kol., datë 12.9.2005, nga shtetasi N.Q dhe G.ZH, subjekti sqaron se arsyeja e marrjes së huas nga bashkëshortja në vitin 2005 ka të bëjë me dëshirën e saj për të blerë një apartament më të madh në momentin që lidhën martesë dhe, kur të shisnin apartamentin 1+1, do të shlyenin huan e marrë. Në periudhën në vazhdim, për shkak të angazhimeve familjare dhe të punës, u bë e mundur blerja e apartamentit vetëm në vitin 2008.

Vlerësimi i Komisionit

26.20.12 Komisioni çmoi se analiza financiare për blerjen e apartamentit në rr. “****” prej bashkëshortes së tij, duhet të rishikohet duke u përfshirë edhe të ardhurat e përfituara prej tij nga pensioni dhe të ardhura të tjera. Nga kjo analizë, e cila është paraqitur në tabelën e mëposhtme, rezulton se vjeherri i subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi të japë shumën 40,000 euro me të ardhura të ligjshme. Kjo vlerë do të përfshihet si burim krijimi për blerjen e apartamentit në analizën e Komisionit.

Tabela nr. 8

Viti	Analiza financiare kumulative 1995 – shkurt 2008
Të ardhurat neto në euro nga emigracioni	60,490
Të ardhurat nga pensioni në Shqipëri, konvertuar në euro	21,745
Shpenzimet jetike në euro	38,506
Rezultati financiar në euro	43,728

26.20.13 Ndërsa në lidhje me vlerën e transfertës në llogarinë e subjektit pranë Alpha Bank, në datën 5.3.2009, nga dërguesi B.F, Komisioni vlerësoi se për këtë vlerë është arritur elementi i provueshmërisë, por Komisioni çmon se nuk do të përfshihet si burim për krijimin e apartamentit, pasi subjekti nuk e ka deklaruar këtë vlerë as në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratat periodike.

26.20.14 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti është në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në rr. “****” me të ardhura të ligjshme (në shumën -6,504 euro⁵⁹ ose rreth -892,099 lekë).

Analiza e burimit të krijimit të apartamentit, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë

➤ Subjekti ka deklaruar në deklaratën e vitit 2015 se si burim për këstin e parë me vlerë 40,000 euro kanë shërbyer:

26.21 Llogari kursimi *** në emër të shtetasës D.SH në Union Bank, krijuar me të ardhurat ndër vite. Në Union Bank⁶⁰ rezultoi tërheqje e shumës prej 2,680,000 lekësh (ose vlera 19,470 euro⁶¹) në datën 27.8.2015 nga llogaria e depozitës së bashkëshortes D.SH. Nga hetimi rezultoi se kjo llogari kursimi është çelur në datën 24.11.2011 dhe gjendja e saj është shtuar nga transfertat automatike me bazë mujore nga llogaria e pagës ose nga transferimi i gjendjeve të tjera të krijuara në llogarinë e pagës, nga interesat e akumuluar të llogarisë bankare dhe nga 4 depozitime *cash* të bashkëshortes si vijon, datë 27.1.2012 (vlera 80,000 lekë), datë 13.6.2014 (vlera 100,000 lekë), datë 25.11.2014 (vlera 100,000 lekë). Komisioni hartoi analizën financiare për të hetuar mundësinë për të krijuar vlerat e depozituara nga bashkëshortja në vitin 2014 në datën 13.6.2014 dhe në datën 25.11.2014, nga e cila rezultoi se ata kishin mundësi të krijonin këto vlera me të ardhura të ligjshme.

26.22 Hua shuma 5,000 USD (4,482 euro) nga E.Q, marrë në muajin shtator 2015, e cila është përdorur për pagesën e këstit të parë dhe hua 40,000 euro, dhënë në muajin mars të vitit 2016, përdorur për pagesat për apartamentin gjatë vitit 2016.

⁵⁹ 61,800 euro - 15,296.4 euro - 40,000 euro = 6,504 euro.

⁶⁰ Shkresat e Union Bank nr. *** prot., datë 9.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 5.10.2023.

⁶¹ Kursi i këmbimit BOA ALL/euro = 137,65.

Subjekti deklaron në seksionin e detyrimeve financiare, në DIPP-në e vitit 2015: “5,000 USD, marrë hua nga shtetasi E.Q në muajin shtator 2015 për blerjen e banesës së porositur nr. *** rep., *** kol., datë 9.9.2015, me shoqërinë “K” sh.p.k”. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 deklaron: “Hua nga z. E.Q në vlerën 40,000 euro dhe 5,000 USD, me aktin noterial nr. ***rep., *** kol., datë 27.9.2016 (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e apartamentit në rr. “****”).

26.22.1 Subjekti bashkëlidh⁶² me deklaratën e pasurisë kontratë huaje nr. *** rep., *** kol., datë 27.9.2016, ku E.Q i ka dhënë në formë huaje shtetasit Afrim Shehu një shumë prej 40,000 euro dhe 5,000 USD, përkatësisht në periudhat: në muajin gusht 2015 shumë prej 5,000 USD, e cila është dhënë cash, dhe 40,000 euro në muajin mars të vitit 2016, shumë e cila ka kaluar nëpërmjet bankës. Bashkëlidhet me kontratën kërkesë për transaksion e BKT-së e ku rezulton se në datën 4.3.2016 klienti urdhërues, shtetasi E.Q kërkon transferimin e shumës 40,000 euro në llogarinë e përfituesit, shtetasit Afrim Shehu, në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank me detaje të pagesës “Huadhënie për blerje shtëpie sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., *** kol., datë 9.9.2015”.

26.22.2 Në kontratë parashikohet se shumat janë përdorur për blerjen e banesës sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015, sipas kësteve të përshkuara në kontratë. Huaja është dhënë pa interes dhe afati i saj lidhet me shitjen e apartamentit ekzistues sipas certifikatës së pronësisë, z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 89.95 m², në adresën rruga “****”, ap. ***, në pronësi të shtetasve Afrim dhe D.SH.

26.22.3 Nga *statement*-i i BKT-së⁶³ rezulton se shuma e përdorur për dhënien e huas është depozituar në datën 13.1.2010 nga shtetasi E.Q në vlerën 70,000 euro dhe është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën e realizimit të transfertës 40,000 euro drejt llogarisë së subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “Huadhënie për blerje shtëpie”. Raiffeisen Bank⁶⁴ konfirmon transfertën në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 8.3.2016 nga shtetasi E.Q të shumës 39,952.7 euro, me përshkrimin “Huadhënie për blerje shtëpie” dhe transfertën e shumës 30,000 euro nga llogaria e subjektit në datën 9.3.2016 drejt llogarisë së shoqërisë “K” sh.p.k.

26.22.4 Subjektit iu kërkuan shpjegime⁶⁵ për burimin e vlerës të dhënë hua nga shtetasi E.Q, për të cilën sqaron: “Nga biseda me shtetasin E.Q, më është konfirmuar se burimi i ligjshëm i vlerës 70,000 euro së depozituar cash në datën 13.1.2010 pranë BKT, janë të ardhurat ndër vite nga puna e shtetasit G.ZH në Mbretërinë e Bashkuar. Në plotësimin e kësaj vlere janë dhe këstet e shlyerjes se huas së marrë nga bashkëshortja ime, vlere 23,000 USD, vlere 22,600 USD e depozituar në datën 10.8.2005 nga D.SH, e cila është tërhequr në datën 22.10.2005, si dhe të ardhura të tjera të dërguara dhe sjellë nga shtetasi G.ZH. Vlere prej 22,600 USD, pasi është tërhequr në datën 22.10.2005 i është dhënë për nevoja familjare shtetasit A.SH. Kjo vlerë më pas i është dhënë shtetasit E.Q, i cili e ka depozituar në BKT, në datën 13.1.2010”⁶⁶.

26.22.5 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në llogarinë e bashkëshortes pranë ProCredit Bank sh.a. është depozituar cash vlere 22,600 USD në datën 10.8.2005, e cila është tërhequr në datën

⁶² Subjekti për burimin e krijimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentacionin si vijon: kopje të pasaportës nr. *** të shtetasit G.ZH si qytetar britanik; kopje të vulave hyrëse dhe dalëse; *statement* llogarie, ku figurojnë transfertat nga G.ZH me përfitues shtetasin E.Q gjithsej në shumë 28,905 GBP, si vijon a) datë 13.4.2011, shuma 4,000 GBP; b) datë 21.6.2011, shuma 4,000 GBP; c) datë 15.11.2012, shuma 4,000 (3,981) GBP; d) datë 22.4.2013, shuma 4,000 (3,981) GBP; e) datë 21.5.2013, shuma 4,000 (3,981) GBP; f) datë 11.9.2013, shuma 4,000 (3,981) GBP; g) datë 30.9.2013, shuma 5,000 (4,981) GBP.

⁶³ Shkresë e BKT-së nr. *** prot., datë 5.12.2022.

⁶⁴ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁶⁵ Pyetësori nr. 2, pyetja ***.

⁶⁶ Subjekti bashkëlidh me shpjegimet deklaratë noteriale të shtetasve A.SH dhe M.SH me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2023, në të cilën deklarojnë sa më sipër, shpjeguar nga subjekti.

22.10.2005. Komisioni kërkoi shpjegime⁶⁷ për mënyrën e përdorimit të kësaj vlere prej bashkëshortes dhe përcjelljen e dokumentacionit për burimin e krijimit të vlerës së depozituar, për të cilat subjekti sqaron: “Shuma e depozituar cash në vlerën 22,600 USD në datën 10.8.2005, e cila është tërhequr në datën 22.10.2005, ka si burim të ligjshëm të ardhurat e shtetasit G.ZH në Mbretërinë e Bashkuar. Në muajin korrik 2005, shtetasi G.ZH dhe M.Q kanë ardhur në Shqipëri. Në datën 31.7.2005, unë dhe bashkëshortja ime jemi martuar, ndërsa ata të dy kanë bërë një ceremoni martesore në Tiranë, në datën 7.8.2005. Kjo shumë është sjellë nga G, M, N dhe B në Shqipëri, të cilat ishin kursime të të ardhurave të realizuara nga G në Mbretërinë e Bashkuar dhe do t’i linin në Shqipëri. Nga G më është kërkuar që këtë shumë prej 22,600 USD ta mbanim në Shqipëri. Kështu që, në datën 10.8.2005 është vendosur në bankë në emër të bashkëshortes sime dhe në datën 22.10.2005 është tërhequr nga banka, pasi më janë kërkuar nga vëllai im A.SH për nevojat e tij familjare. Më pas, kjo shumë i është dhënë në prani të vëllait A.SH shtetasit E.Q, i cili e ka depozituar në datën 13.1.2010 pranë BKT Bank. Ky fakt është pohuar nga vëllai im A.SH në deklaratën noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.5.2023”. Subjekti bashkëlidh me pyetësorin deklaratën noteriale, në të cilën shtetasi A dhe M.SH deklarojnë se janë ata që ia kanë kërkuar këtë shumë shtetasve D.SH dhe Afrim Shehu dhe, më pas, e kanë përdorur për shpenzime të tyre etj.

26.22.6 Komisioni konsideroi në analizën e tij mundësinë e krijimit të vlerës 22,600 USD me të ardhurat e subjektit dhe jo të shtetasit G.ZH.

26.22.7 Duke iu referuar shpjegimeve të subjektit, Komisioni konstatoi se duket e paqartë arsyeja e transferimit të shumës 15,297 euro nga shtetasi G.ZH në llogarinë e subjektit në ProCredit Bank në datën 5.10.2005, e cila është përdorur si burim për pagesat e apartamentit në rrugën “****”, kur bashkëshortja e subjektit në datën 22.8.2005 (vetëm 1.5 muaj përpara) ka pasur likuiditete të disponueshme në vlerën 22,600 USD, por të cilat ia ka dhënë shtetasve A.SH dhe D.SH për kryerje investimesh prej tyre.

26.22.8 Komisioni hartoi analizën financiare të shtetasit G.ZH për t’i dhënë vlerën 70,000 euro shtetasit E.Q, depozituar më pas prej tij në llogarinë bankare, nga e cila rezultoi se ai kishte pasur mundësi ta krijonte këtë vlerë me të ardhura të ligjshme deri në datën 31.12.2009. Po ashtu, u analizua edhe mundësia për të dhënë vlerën 22,600 USD, e cila u depozitua cash nga bashkëshortja në llogarinë e saj pranë ProCredit Bank, në datën 22.8.2005, nga e cila rezultoi se ky shtetas kishte mundësi ta krijonte me të ardhura të ligjshme.

26.22.9 Nga hetimi⁶⁸ rezultoi se subjekti ka shlyer huan në shumën 40,000 euro me të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në rr. “****” me transfertë bankare, në datën 20.10.2016, me përshkrimin “Kthim huaje për blerjen e banesës, bazuar në kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.2015, borxh i marrë datë 3.8.2016.” Subjekti bashkëlidh me deklaratën e pasurisë deklaratën noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 24.1.2017, ku shtetasi E.Q deklaron se me shtetasin Afrim Shehu kanë lidhur kontratën e huas nr. *** rep., *** kol., datë 27.9.2016, e cila quhet e zgjidhur, pasi janë përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj. Shuma 40,000 euro është kthyer nëpërmjet llogarisë bankare në tetor 2016 dhe shuma 5,000 USD është kthyer cash.

⁶⁷ Pyetja nr. 12, pyetësori nr. 2.

⁶⁸ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

26.22.10 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vendosi të mos përfshijë në analizën e tij vlerën e huas prej 40,000 euro, pasi gjatë hetimit nuk u arrit të provohej se vlera e mësipërme i është dhënë/transferuar shtetasit E.Q nga shtetasi G.ZH.

26.22.11 Subjekti pas kalimit të barrës së provës shpjegon se burimi i vlerës të dhënë hua nga shtetasi E.Q është shuma 70,000 euro e depozituar *cash* prej tij në llogarinë e tij në datën 13.1.2010 pranë BKT, krijuar nga të ardhurat ndër vite nga puna e shtetasit G.ZH në Mbretërinë e Bashkuar. Në plotësimin e kësaj shume (70,000 euro) janë përdorur këstet e shlyerjes se huas së marrë nga bashkëshortja e subjektit në vlerën 23,000 USD, vlera 22,600 USD e depozituar në datën 10.8.2005 nga shtetasja D.SH në llogarinë pranë ProCredit Bank, e cila është tërhequr në datën 22.10.2005, si dhe të ardhura të tjera të dërguara dhe sjellë nga shtetasi G.ZH gjatë viteve në Shqipëri. Vlera prej 22,600 USD, pasi është tërhequr në datën 22.10.2005, i është dhënë për nevoja familjare shtetasit A.SH. Kjo vlerë i është kthyer shtetasit E.Q, i cili e ka depozituar në BKT, në datën 13.1.2010, së bashku me shumën e tjera të mbledhura.

26.22.12 Përcillet deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2024, e shtetasit G.ZH, i cili shpjegon se: *“...Ashtu si të gjithë emigrantët në vitet 2000, ne vlerësonin që kursimet t’i ruanim apo investonin në Shqipëri, duke shpresuar se një ditë do të ktheheshin në vendin tonë. Për këtë arsye, më pas, gjatë viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009 unë kam ardhur në Shqipëri gjatë verës dhe kam sjellë një pjesë të kursimeve, të cilat, së bashku me vlerën 22,600 USD dhe këstet e kthimit të huas sipas kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2005, shkonin në total rreth 70,000 euro. Kjo vlerë për shkak të sigurisë i është lënë A. Në vitin 2007 është kthyer për të jetuar në Shqipëri E, i cili gjatë kësaj kohe ka jetuar tek banesa e A dhe M. Duke qenë se vlera prej 70,000 euro ndodhej në zyrën e A, i është dhënë E, i cili me miratimin tim e ka vendosur në një depozitë kursimi në vitin 2010, në emër të tij”.*

26.22.13 Gjithashtu, subjekti shpjegon se në kushtet kur shtetasit E.Q dhe G.ZH kanë jetuar në një ekonomi të përbashkët në Londër, provohet se ai e ka deklaruar saktë huan në deklaratat periodike vjetore dhe *Vetting*.

Vlerësimi i Komisionit

26.22.14 Komisioni çmoi se gjatë hetimit u arrit të provohej se shuma 23,000 USD e marr hua në vitin 2005 nga bashkëshortja, më pas e shlyer deri në vitin 2009 prej tyre dhe shuma 22,600 USD, e cila është depozituar *cash* në datën 10.8.2005 nga bashkëshortja e tij, por tërhequr në datën 22.10.2005, kanë burim të ligjshëm krijimi referuar analizës financiare të tyre. Gjithashtu, u arrit të provohej ekzistenca reale e këtyre vlerave, të cilat në total bëjnë vlerën 45,600 USD ~ 40,000 euro.

26.22.15 Gjithashtu, Komisioni çmon se fakti i depozitimit *cash* nga shtetasi E.Q në vitin 2010 të vlerës 70,000 euro në llogarinë e tij në BKT, gati 6 vite para se të merrej huaja duke u transferuar me bankë në llogarinë e subjektit në vitin 2016 dhe kthimi i kësaj shume nga subjekti përsëri me bankë, nga të ardhurat e shitjes së apartamentit në rr. “***”, përbëjnë element transparence dhe të provueshmërisë në kryerjen e këtij transaksioni.

26.22.16 Në përfundim, Komisioni vlerëson se vlera 5,000 USD në vitin 2015 (për të cilën u provua burimi i ligjshëm nga analiza financiare) dhe shuma 40,000 euro në vitin 2016 duhet të përfshihen si burim krijimi për blerjen e apartamentit në rr. “***”, Tiranë dhe duhet të përfshihen në analizën e Komisionit.

26.23 Burim krijimi i deklaruar nga subjekti për pagesat e kryera për apartamentin e ndodhur në rr. “****” janë edhe kursimet ndër vite, të deklaruara para datës 31.12.2014.

Subjekti deklaroi pranë ILDKPKI-së⁶⁹ (procesverbal datë 15.1.2016) se gjendja e kursimeve *cash* deri në datën 31.12.2014 ka qenë 1,010,000 lekë. Ndërsa gjendja *cash* prej 10,000 euro është shpenzuar për mobilimin e shtëpisë në rrugën “****”, diferenca prej 5,000 euro ka qenë gjendje më 31.12.2014. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2015 si burim për pagesën e këstit të parë të apartamentit në rrugën “****” deklaroi se ka shërbyer “*shuma 1,010,000 lekë + 5,000 euro pakësuar cash, në banesë para datës 31.12.2014*”.

26.23.1 Në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes *cash* deri në vitin 2014, nga analiza e Komisionit rezultoi se vlera 1,010,000 lekë është krijuar nga:

a) 120,000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2010; b) 240,000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2011; c) 650,000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2014. Duke iu referuar analizës gjithëpërfshirëse të Komisionit, rezultoi se vetëm viti 2011 ka vlerë pozitive, pra provohet burimi i ligjshëm. Për këtë arsye, vlera e përfshirë në analizë si burim krijimi është vetëm ajo e deklaruar në vitin 2011.

26.23.2 Ndërsa në lidhje me shumën *cash* prej 5,000 euro, krijuar para fillimit të detyrës, nga analiza para fillimit të detyrës të subjektit të rivlerësimit rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi ta krijojë gjendjen *cash* prej 5,000 euro⁷⁰ me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i Komisionit

26.23.3 Pas përcjelljes së shpjegimeve me parashtrimet e subjektit dhe përditësimit të analizës financiare⁷¹, rezultoi se para marrjes së detyrës subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të kursente vlerën 379,670 lekë ~ 2,768 euro me të ardhura të ligjshme, e cila mbartet si gjendje deri në vitin 2014, pasi subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në deklaratat periodike 2009 – 2013.

Për shumën e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2010 si shtesë prej 120,000 lekësh, analiza e përditësuar e Komisionit rezultoi me vlerë negative prej -170,764 lekësh, pra nuk kishte mundësi ta kursente me burim të ligjshëm.

Për shumën e gjendjes *cash* të deklaruar si shtesë në vitin 2014 prej 650,000 lekësh, analiza e përditësuar e Komisionit rezultoi me vlerë negative prej -426,691 lekësh, pra kishte mundësi të kursente *cash* me burim të ligjshëm vlerën 223,309 lekë (650,000 - 426,691).

Pra, vlera e kursimeve *cash* e përfshirë në analizën e Komisionit të përditësuar si burim për këstin e parë të apartamentit të ndodhur në rr. “****” është vlera totale prej 619,670 lekësh⁷², e cila mbështetur dhe në praktikën e Kolegjit⁷³, përfshin vlerën *cash* të kursimeve kumulative me burime të ligjshme, para marrjes së detyrës deri në datën e pagesës së këstit të parë.

⁶⁹ Shkresë e ILDKPKI-së nr. 1669/2 prot., datë 5.3.2021.

⁷⁰ Pjesë e vlerës së deklaruar *cash* prej 15,000 euro nga bashkëshortja para fillimit të detyrës.

⁷¹ Duke u mbështetur në praktikën e Kolegjit për analizimin e burimit të ligjshëm të gjendjes së kursimeve *cash* dhe përfshirjen në analizë vetëm të asaj vlere si burim krijimi i pasurive.

⁷² Vlera e kursimit *cash* para detyre prej 379,670 lekësh + vlera e shtesës në vitin 2011 prej 240,000 lekësh + shtesa me burim të ligjshëm e vitit 2014 prej 223,309 lekësh.

⁷³ Vendim nr. 27 dt.06.07.2022, pika 43.

26.24 Burim tjetër krijimi i deklaruar për këstin e parë është shuma 994.25 USD, tërheqje nga llogaria 4200413020-USD, Afrim Shehu, RFZ Bank dhe shuma 1,600 USD, *cash*, të ardhura Kroaci.

26.24.1 Subjekti deklaroi në DIPP-të e viteve 2013 dhe 2015 të ardhurat si lektor në Shkollën e Magjistraturës, organizuar nga OPDAT dhe të ardhurat nga trajtime, organizuar nga OPDAT, pranë Ambasadës A, në Kroaci.

26.24.2 Nga hetimi⁷⁴ rezultoi se në datën 6.5.2013 është transferuar shuma 994 USD nga “***”. Kjo shumë prej 990 USD është tërhequr nga subjekti në datën 24.2.2015. Ndërsa me pyetësin nr. 2⁷⁵ subjekti bashkëlidhi dokumentacion provues për të vërtetuar të ardhurat e deklaruara, për të cilat sqaron: *“Nga data 8.4.2013 deri në datën 18.4.2013, unë kam marrë pjesë si trajner ligjor pranë Shkollës së Magjistraturës në Shqipëri për një program që është organizuar nga OPDAT, pranë Ambasadës A, Tiranë... Për këtë shërbim unë jam paguar nëpërmjet bankës në vlerën 1,503.00 USD, sipas faturës së lëshuar në muajin prill 2013 nga Departamenti i Listës së Pagesave me adresë ***, M, NJ ***... Ndërkohë, gjatë viteve 2015 – 2016 kam marrë pjesë në Kursin e Programit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për Zhvillimin e Kurrikulës dhe Trajnimit të Trajnerëve, i ftuar nga Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara në Z, Kroaci... Për këtë program jam paguar në vlerën 341 USD në datën 27.3.2015, në vlerën 282 USD në datën 7.6.2015, në vlerën 260 USD në datën 8.11.2015, në vlerën 314 USD në datën 15.12.2015 dhe në vlerën 556 USD në datën 29.9.2016... ”*. Subjekti bashkëlidh kontratat dhe faturat e lëshuara në muajin prill 2013, shkresë *Letër konfirmimi për pjesëmarrje në trajnimin US DJ/OPTAD* nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Kroaci, e dërguar në datën 1.2.2021. Në këto dokumente konfirmohen të ardhurat e deklaruara nga subjekti.

26.24.3 Komisioni nuk përfshiu në analizën financiare si të ardhura të ligjshme vlerën 994 USD, e cila është tërhequr nga subjekti në datën 24.2.2015, pasi në seksionin B të kontratës së shërbimit të përcjellë nga subjekti, është specifikuar se përgjegjësia për pagesën e taksave dhe tatimeve për shumën e përfituar është e subjektit të rivlerësimit. Gjatë procesit nuk u arrit të provohet se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore për këtë vlerë.

26.24.4 Gjithashtu, si vlerën e përfituar gjatë vitit 2015 nga trajnimi i organizuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA, edhe vlerat 1,197 USD dhe 556 USD në vitin 2016, Komisioni nuk i përfshiu si të ardhura të ligjshme, pasi në kontratë specifikohet se shuma akordohet për mbulim shpenzimesh sigurimi, aksidentesh, shpenzime të tjera, të cilat nuk duhet të përfshihen si burime krijimi pasurish sipas metodologjisë dhe praktikës së Kolegjit⁷⁶.

26.24.5 Subjekti me shpjegimet e dhëna edhe gjatë seancës dëgjimore nuk i krijoi bindjen Komisionit se detyrimet tatimore ishin shlyer për shumën e përfituar, por çmoi se në analizën financiare duhet të reduktoheshin shpenzimet për udhëtimet e kryera për këto qëllime.

26.25 Burim tjetër krijimi i deklaruar për këstin e parë është teprica, kursime gjatë vitit 2015, të konvertuara gjithsej në 1,622 euro. Duke iu referuar analizës financiare gjithëpërfshirëse vërehet se rezultati financiar në vitin 2015 edhe pas përditësimit të analizës financiare pas zhvillimit të seancës dëgjimore është negativ (-868,996 lekë). Pra, subjekti nuk ka pasur mundësi të kursejë vlerën 1,622 euro nga të ardhurat e vitit 2015 me burim të ligjshëm.

⁷⁴ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁷⁵ Pyetja nr. 18, pyetësi nr. 2.

⁷⁶ Vendimi i Kolegjit për subjektin E.S, paragrafi ***, faqja ***.

26.26 Subjekti deklaron si burim për pagesat e kësteve të apartamentit në rrugën “****” edhe vlerën monetare të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 89. 95 m², me nr. pasurie ***, rr. “****”, h. ***, ap. ***, Tiranë, datë 20.10.2016, në vlerën 85,000 euro.

26.26.1 Nga hetimi⁷⁷ rezultoi se në llogarinë e shtetasit Afrim Shehu është kryer kreditimi i shumës 85,000 euro, datë 17.10.2016, nga noterja M.LL person fizik, sipas kontratës *** rep., *** kol., datë 8.10.2016. Ndërsa në datën 18.10.2016 nga kjo llogari është kryer transferta në shumën 20,000 euro për llogari të shoqërisë “K” sh.p.k. me përshkrimin “Pagesë për blerje shtëpie, bazuar në kontratën e porosisë nr. *** rep., *** kol., datë 8.9.2015”. Gjithashtu, në datën 20.10.2016 është kryer edhe një transfertë tjetër nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në shumën 2,840 euro drejt shoqërisë “K” sh.p.k. me përshkrimin “Diferencë për përmbushje në total e detyrimit sipas kontratës së porosisë nr. *** rep, nr. *** kol., datë 8.9.2015”. Pra, konfirmohet se me vlerën e shitjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “****” janë kryer pagesat e kështit të tretë dhe të fundit të apartamentit në rrugën “****”.

26.27 Në përfundim të sa më sipër trajtuar, për pasurinë apartament të ndodhur në rr. “****”, pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti arriti të përcjellë prova nga të cilat Komisioni vlerësoi se pamundësia financiare është -10,139 euro ose -1,420,557lekë⁷⁸.

Tabela nr. 9

Këstet e apartamentit në rr. “****”	Burimi i krijimit	Pamundësia financiare
Vlera 40,000 euro, shlyer datë 8.9.2015 (në arkën e shoqërisë)	1- depozita e b/sh në Union Bank vlera 2,682,923 lekë; 2- shuma 5,000 USD, hua nga E.Q, marrë në shtator 2015; 3- shuma 1,010,000 lekë + 5,000 euro pakësuar <i>cash</i> , në banesë para datës 31.12.2014; 4- shumat nga trajnimet në vitin 2013 dhe 2015; 2,590 USD; 5- kursime gjatë vitit 2015 në total 1,622 euro.	0 0 -2,232 euro dhe 546,691 lekë -2,383 euro - 1,622 euro
Vlera 30,000 euro, shlyer datë 9.3.2016 (Raiffeisen Bank)	Hua e marrë nga shtetasi E.Q (30,000 euro);	0
Shpenzime mobilimi/arredimi për apartamentin vlera 11,000 euro	Hua e marrë nga shtetasi E.Q (10,000 euro); kursime gjatë vitit 2016, vlera 1,000 euro	0
Vlera 20,000 euro, shlyer datë 18.10.2016 (Raiffeisen Bank)	Vlera e shitjes së apartamentit në rr. “****”, pagesa e kryer me transfertë bankare	0
Vlera 2,840 euro, shlyer datë 20.10.2016 (Raiffeisen Bank)		
Totali i paguar € 103,840		10,139 euro ose 1,420,557 lekë

27. Garazh në rrugën “**”, pallati ***, me dy vendparkime (nr. ***, ***), me sipërfaqe 35 m², në katin ***, shkalla *** (kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., *** kol., datë 13.11.2009⁷⁹). Vlera 14,000 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna ndër vite së bashku me bashkëshorten.**

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

27.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, ndërsa në pyetësin nr. 1 ka sqaruar se: “Me kontratën *** rep.,

⁷⁷ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁷⁸ Nga analiza financiare për pagesat e kësteve Komisionit i rezultoi se subjekti kishte pamundësi për shlyerjen e tyre me të ardhura të ligjshme në vlerën totale 39,005 euro ose 5,276,206 lekë.

⁷⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 13.11.2009, për blerjen e një garazhi me sip. 35 m², në vlerën 14,000 euro; Planimetria e garazheve, plus leja e ndërtimit. Shihni aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

nr. *** kol., datë 6.9.2019, është zgjidhur në mënyrë vullnetare kontrata e sipërmarrjes me numër *** rep., nr. *** kol. datë 13.11.2009, për dy vende parkimi në vlerën 14,000 euro, duke i rikthyer palët në gjendjen e mëparshme. Kjo vlerë është kthyer nëpërmjet bankës në llogarinë time në Raiffeisen Bank, vlera 13,950 euro dhe vlera 50 euro cash”.

27.2 ASHK-ja⁸⁰ nuk e konfirmon pasurinë në emër të subjektit dhe/ose bashkëshortes. Ndërsa nga hetimi⁸¹ rezultoi se subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2019 si vijon: “Me kontratën *** rep., nr. *** kol., datë 6.9.2019, është zgjidhur në mënyrë vullnetare kontrata e sipërmarrjes me numër *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2009, për dy vende parkimi në vlerën 14,000 euro, duke i rikthyer palët në gjendjen e mëparshme. Kjo vlerë është kthyer nëpërmjet bankës në llogarinë time në Raiffeisen Bank, vlera 13,950 euro dhe vlera 50 euro cash”. Rezultoi⁸² e provuar se kthimi i vlerës për këtë pasuri është bërë në datën 10.9.2019 në llogarinë bankare të subjektit, ku i ka kaluar shuma 13,948.8 euro, me përshkrimin “Kalim sipas aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.9.2019, për zgjidhjen e kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2009” nga llogaria e noteres E.T.

27.3 Subjekti shpjegon⁸³ mbi arsyen e revokimit të kontratës së sipërmarrjes *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2009: “Në lidhje me këtë pyetje, unë i jam drejtuar me një kërkesë për informacion shoqërisë “N” sh.p.k. Përfaqësuesi i kësaj shoqërie më është përgjigjur... Zona ku ndodhen këto vendparkime, pavarësisht rritjes së vlerës së tregut të pasurive të paluajtshme, nuk kishte kërkesa për garazhe... qytetarët blejnë vetëm banesë, jo parkime. Aktualisht, shumica e parkimeve janë në pronësi të shoqërisë. Duke qenë se garazhi im ndodhej në katin *** dhe shoqërisë i shërbente për ta shfrytëzuar të gjithë së bashku, në marrëveshje u dakordësuam që të më kthente të njëjtën vlerë”. Bashkëlidhur me shpjegimet e pyetësorit, përcillen 23 vërtetime nga dokumenti hipotekor, të cilat vërtetojnë se vendparkimet janë në emër të shoqërisë “N” sh.p.k.

27.4 Nga hetimi i Komisionit⁸⁴ në lidhje me ekzistencën e konfliktit të interesit të subjektit për shkak të detyrës, me firmën e ndërtimit “N” sh.p.k. dhe/ose ortakët/administratorët e kësaj shoqërie, nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me personat e sipërpërmendur.

Lidhur me burimin e ligjshëm

27.5 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të ardhura nga puna ndër vite së bashku me bashkëshorten. Komisioni hartoi analizën financiare për burimin e krijimit për periudhën tetor 1999 – nëntor 2009, duke vlerësuar se pagesa është realizuar në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.11.2009. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte pamundësi për pagesën e çmimit të blerjes së garazheve në shumën totale të tyre (prej -14,000 euro ose rreth -1,920,380 lekë).

27.6 Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare për pagesën e blerjes së garazheve, subjekti i rivlerësimit përcjell shpjegime të mbështetura në prova, trajtimi i të cilave

⁸⁰ Shkresë e ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri nr. *** prot., datë 24.3.2021; shkresë e ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Veri nr. *** prot., datë 22.11.2023; shkresë e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug nr. *** prot., datë 6.4.2021; shkresë e ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë Jug nr. *** prot., datë 20.11.2023; shkresë e ASHK-së Drejtoria Vendore Tirana Jug nr. *** prot., datë 20.11.2023.

⁸¹ Shkresë “Kthim përgjigje” nr. *** prot., datë 18.6.2021, e ILDKPKI-së.

⁸² Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁸³ Pyetësori nr. 2, pyetja nr. ***.

⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023, bashkëlidhur pyetësorit nr. 3.

është bërë në mënyrë analitike me pasuritë si më lart, specifikisht me pasurinë apartament i ndodhur në rr. “***”, Tiranë dhe apartament i ndodhur në rr. “***”, Tiranë.

27.7 Gjithashtu, subjekti përcjell dokumentacion për reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit të kryera gjatë vitit 2009, specifikisht sqaron se këto udhëtime kanë qenë pranë të afërmeve të tij dhe shpenzimet janë mbuluar prej tyre ose për trajnime me mbulim shpenzimesh nga qendrat e punës.

Vlerësimi i Komisionit

27.8 Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit të dhëna edhe gjatë seancës dëgjimore janë shteruese dhe në vijim çmoi se analiza financiare për krijimin e pasurive duhet të rishikohet, si në vijim.

Tabela nr. 10

Analiza kumulative tetor 1999 – nëntor 2009	Vlerat në lekë
Të ardhura nga kompanitë rentiere (V sh.p.k.)	873,113
Të ardhura nga paga si OPGJ	4,453,175
Të ardhura nga puna si avokat	1,573,940
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes	2,427,129
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***	200,000
Dhuratë nga A.SH në vitin 2004 shuma 12,760 euro dhe në 2008 shuma 2,500 GBP	1,936,352
Dhuratë në vlerën 40,000 euro nga shtetasi P.GJ, datë 27.10.2009	4,927,300
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	61,646
Të ardhura total	16,452,656
PASURI	
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	3,258,919
Apartamenti në rr. “***”	3,885,059
Garazh i ndodhur në rr. “***”	1,724,555
Apartamenti në rr. “***”	7,612,679
Automjeti me targë ***, blerë në datën 20.3.2007	250,000
Total pasuri	16,731,212
DETYRIME	
Hua marrë nga shtetasi N.Q (G.ZH), datë 12.9.2005	1,260,542
PASURI NETO	15,470,670
Shpenzime mirëmbajtjeje të automjetit me targë ***	398,950
Shpenzime jetike	2,174,608
Rezultati financiar	(1,677,880)

27.9 Në analizën përfundimtare të Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi të kryerjes së pagesës së blerjes së garazheve me të ardhura të ligjshme në shumën (-1,677,880 lekë ose rreth -12,232 euro).

28. Automjeti i tipit “Volkswagen”, seria “Golf Plus”, me targë * (certifikatë pronësie nr. *** , datë 12.5.2016, kontratë shitjeje nr.*** rep., *** kol., datë 12.5.2016). Vlera 8,000 euro⁸⁵. Burimi i krijimit: Shitja e automjetit e tipit “Volkswagen Golf Plus”, me targë *** (kontratë shitjeje nr.*** rep., *** kol., datë 11.5.2016), si dhe kursime nga paga.**

⁸⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dokumentet në aneksin 4/5.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

28.1 Nga hetimi⁸⁶ rezultoi se automjeti tip “Volkswagen” seria “Golf Plus”, me targë ***, është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit sipas kontratës së shitjes së automjetit nr. *** rep., *** kol., datë 12.5.2016, me të cilën z. Afrim Shehu blen automjetin tip “Volksäagen”, seria “Golf Plus” në vlerën 8,000 euro nga shtetasi A.N. Gjithashtu nga dosja e mjetit rezultoi se ky automjet është futur në territorin shqiptar në datën 4.5.2016, Dogana D, nga shtetasi A.N, me shtet origjine Gjermaninë, në vlerën 8,300 euro.

28.2 Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti deklaroi se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm i tipit “Volksäagen Golf Plus”, me targë *** dhe të ardhurat e vitit nga paga. Nga DPSHTRR-ja⁸⁷ informohemi se automjeti i është shitur nga subjekti i rivlerësimit me kontratë shitjeje nr. *** rep., *** kol., datë 11.5.2016, shtetases D.K në vlerën 6,100 euro. Ndërsa në lidhje me diferencën e çmimit të blerjes prej 2,100 euro (8,000 euro-6,100 euro) Komisioni hartoi analizën financiare të periudhës 1.1.2016 – 11.5.2016, nga e cila rezultoi se subjekti ishte në pamundësi në shumën - 1,900 euro (ose rreth 257,023 lekë).

28.3 Në lidhje me konfliktin e interesit, Komisioni hetoi⁸⁸ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit A.N, D.K dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këta shtetas.

28.4 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje me pamundësinë financiare të rezultuar nga hetimi në vlerën - 1,900 euro ose rreth 257,023 lekë (diferenca e çmimeve të shitjes së dy automjeteve). Gjithashtu, i kërkoi shpjegime për arsyen e blerjes së automjetit në vlerën 8,000 euro, më lirë sesa rezultoi nga hetimi, pra sa ç’është blerë nga vetë shitësi, shtetasi A.N (*vlera e importit 8,300 euro + taksat 261,879 lekë=10,236 euro*).

28.5 Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me pamundësinë financiare, subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Në analizën e Komisionit duhet të reduktohen nga ky vit shpenzimet e mobilimit, të cilat nuk janë bërë në këtë periudhë. Kam nisur të banoj në këtë banesë në janar të vitit 2017 dhe, për këtë arsye, shpenzimet e mobilimit nuk janë kryer në këtë periudhë. Gjithashtu, Komisioni në analizën e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie brenda vitit duhet të ketë në vlerësim se në fillim të këtij viti kam pasur gjendje cash në shumën 400,000 lekë, të cilën nuk e kam pasur më në datën e plotësimit të deklaratës Vetting. Kjo gjendje kursimesh cash, ashtu siç është vendosur edhe nga Kolegji në vendimin nr. 33/2021 mund të përdoret brenda vitit për krijimin e pasurisë”*.

28.6 Subjekti kërkon edhe rishikimin e shpenzimeve të bëra me kartën e kreditit të bashkëshortes, pasi ato janë shpenzime të bëra kryesisht për të afërm dhe kolegë për mospasje balance në kartat e tyre ose të cilët nuk dispononin kartë krediti, të cilat i janë kthyer më pas bashkëshortes ose me bankë, ose cash⁸⁹. Pra, nuk janë shpenzime të kryera prej tyre. Disa shpenzime të tjera të paguara

⁸⁶ Shkresat nr. *** prot., datë 30.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 3.3.2021.

⁸⁷ Shkresë *** prot., datë 30.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 3.3.2021.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2024.

⁸⁹ Subjekti shpjegon: *“Kështu, në vitin 2014, pagesat prej 9,015.5 lekësh, datë 4.2.2014 dhe 39,244.5 lekë, datë 1.9.2014, janë kryer nga A.GJ, vëllai i bashkëshortes (total 48,260 lekë). Pra, janë kryer pagesa me kartë krediti për llogari të vëllait të saj. Më pas, ai ka shlyer vetë detyrimin e kartës së kreditit. Pagesa prej 41,749.8 lekësh e kryer në datën 17.9.2014 për “Hotel A” në Mynih, është llogaritur edhe tek shpenzimet e udhëtimit, të cilat janë ndarë me nipin tim E.Q dhe R.D, me të cilët kemi udhëtuar së bashku me makinën time drejt Mynihut me targë ***. Në vitin 2015, pagesat e kryera kundrejt *** dhe *** (total 436 euro) janë rezervime udhëtimi, të cilat janë kryer për të ndihmuar kolegen e punës së bashkëshortes A.LL (Z). Vlera e shpenzuar nga karta e kreditit është paguar në bankë nga bashkëshorti i saj, S.Z, përkatësisht vlera 60,473.2 lekë në datat 7.4.2015 dhe 14.4.2015. Vlera 150,910.5 (1,065 euro), datë 21.7.2015, është pagesë e kryer kundrejt hotelit “P.B” në Greqi, ku kemi kryer pushimet. Hoteli ka*

me kartë krediti janë shpenzime, të cilat Komisioni i ka llogaritur dy herë, pasi janë kryer nga familja së tij si shpenzime udhëtimi apo shpenzime të tjera të përfshira në zërin e shpenzimeve jetike ose zëra të tjerë të analizës financiare. Gjithashtu, subjekti shpjegon se bashkëshortja e tij nuk ka pasur kurrë kartë krediti në monedhën lekë dhe kjo mbështetet edhe nga dokumentacioni bankar i përcjellë me rezultatet e hetimit. Për këtë arsye, shpenzimet për kartën e kreditit në monedhën lek nuk duhet të përfshihen në analizën financiare të Komisionit.

Vlerësimi i Komisionit

28.7 Në përfundim, Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit në lidhje me shpenzimet e kryera me kartën e kreditit të bashkëshortes janë shteruese dhe analiza financiare duhet rishikuar duke reduktuar këto vlera. Gjithashtu, duhet korrigjuar edhe gabimi material në lidhje me vlerat për kartën e kreditit në monedhën lek, e cila rezultoi nga provat se nuk dispononte një të tillë.

28.8 Ndërsa në lidhje me vlerën e shpenzimeve të mobilimit, Komisioni i gjen të pabaza pretendimet e subjektit se këto shpenzime duhen hequr nga analiza financiare, pasi nuk janë kryer atë vit. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* vlerën e tyre me mënyrën e përdorimit e të njëjtin deklaram ka bërë edhe në deklaratën vjetore periodike të vitit 2016, në të cilën ai ka pasur detyrimin të deklarojë shpenzimet, të ardhurat etj., të krijuara gjatë periudhës 1.1.2016 – 31.12.2016.

28.9 Gjithashtu, mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e tij dhe Kolegjit, për shumën e kursimeve *cash* të disponuar prej subjektit të rivlerësimit në fund të vitit 2016, Komisioni çmon se ato nuk mund të përfshihen si burim për shlyerjen e shpenzimeve për mobilim të kryera prej tij në këtë vit, pasi përdorimi ose pakësimi i tyre duhet të ishte deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2016. Nga dokumentacioni nuk rezulton që subjekti të ketë bërë një deklaram të tillë në vitin 2016.

28.10 Në përfundim, Komisioni vlerëson se analiza financiare për krijimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme duhet të rishikohet duke reduktuar shpenzimet e kartës së kreditit të bashkëshortes, duke reduktuar shpenzimet për udhëtimet të mbuluara nga OPTAD (sa trajtuar në pasuritë më lart) dhe duhet të përfshijë huan prej 40,000 euro të marrë në këtë vit nga shtetasi E.Q (edhe kjo çështje trajtuar me pasuritë më lart). Analiza financiare e përditësuar si në vijim, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mundësi të blejë automjetin me të ardhura të ligjshme.

Tabela nr. 11

Analiza financiare për periudhën 1.1.2016 – 11.5.2016	Vlerat në lek
Të ardhura nga paga e subjektit	431,184
Të ardhurat e bashkëshortes	465,481
Hua e dhënë nga shtetasi E.Q	5,410,800
Të ardhurat nga shitja e automjetit me targë ***	825,147
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare	763
Të ardhura total	7,133,374
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	1,319,491
Pagesa e këstit të dytë për apartamentin në rr. “****”	1,346,302
Automjeti me targë ***	1,082,160

pasur paketën all inclusive dhe kjo vlerë është llogaritur edhe tek shpenzimet e udhëimit. Vlera prej 16,019.5 lekësh, datë 1.6.2015, është pagesë e kryer nga kunata e bashkëshortes L.M për blerjet e saj me kartën e bashkëshortes”.

Total pasuri	3,747,953
Shpenzime udhëtimi sipas funksionit	28,000
Shpenzime mobilimi	495,990
Shpenzime siguracioni për automjetin rezultuar nga AMF-ja	6,150
Shpenzime pagese për kartën e kreditit të bashkëshortes	0
Shpenzime udhëtimi	35,489
Shpenzime jetike	313,456
Rezultati financiar	2,506,336

29. Llogari rrjedhëse nr. *, në monedhën euro, pranë Raiffeisen Bank, Tiranë.** Balanca në datën 19.1.2017, në vlerën 22,161 euro. Zotërimi: 100%.⁹⁰ Burimi i krijimit: Diferenca nga shitja e apartamentit me sip. 89.95 m², me nr. pasurie ***, rruga “****”, hyrja ***, ap. ***, Tiranë, sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 20.10.2016 (pas likuidimit të huas ndaj shtetasit E.Q sipas aktit nr. *** rep., *** kol., datë 24.1.2017, si dhe pagesës përfundimtare në vlerën 22,840 euro shoqërisë ndërtuese), kaluar nga llogaria *** në euro, printuar në datën 19.1.2017).

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

29.1 Nga hetimi i Komisionit⁹¹ rezultoi se pas transferimit të shumë 85,000 euro nga shitja e apartamentit në rrugën “****” nga llogaria e noteres M.LL në datën 17.10.2016, vlera 68,840 euro është transferuar për pagesën e këstit të tretë dhe të katërt të apartamentit në rrugën “****” dhe është shlyer huaja ndaj shtetasit E.Q. Ndërsa shuma e mbetur në llogari ka qenë 22,161 euro, e cila përputhet me deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting*.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

30. Llogari rrjedhëse nr. *, në monedhën lekë, pranë Raiffeisen Bank.** Balanca në datën 19.1.2017, në vlerën 229,166 lekë. Zotërimi: 100%.⁹² Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat e pagës gjatë vitit 2016.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

30.1 Nga hetimi i Komisionit⁹³ rezultoi se llogaria e pagës e krijuar nga transferimi i të ardhurave nga pagat e subjektit të rivlerësimit prej muajit mars 2005 në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka pasur gjendje 209,166 lekë.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Deklarimi i bashkëshortes

31. Automjet tip “Opel Corsa”, me targë *, certifikatë pronësie nr. ***, datë 6.6.2013⁹⁴.** Vlera: 900 euro dhe 29,600 lekë detyrim doganor. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga paga.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

⁹⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacionin bankar (aneksin 4/4 dhe 4/6).

⁹¹ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacionin bankar (aneksin 4/7).

⁹³ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

⁹⁴ Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneksi 4/11) subjekti përcjell certifikatën e pronësisë së automjetit me targë *** në emër të shtetas D.SH.

31.1 Bashkëshortja e subjektit e deklaroi për herë të parë pasurinë në DIPP-në e vitit 2013 në të njëjtën mënyrë si dhe në deklaratën *Vetting*.

31.2 Nga hetimi⁹⁵ rezultoi se automjeti tip “Opel Corsa”, me targë ***, është i regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. D.SH, sipas kontratës së shitjes së automjetit të përdorur, lidhur në datën 25.5.2013 midis shtetas D.SH dhe palës shitëse shtetasit B.K, me vlerë 900 euro. Gjithashtu, nga dosja e mjetit rezultoi se ky automjet është futur në territorin shqiptar në datën 3.6.2013, me shtet origjine Gjermaninë, në vlerën 900 euro, nga eksportuesi B.K. Shpenzimet doganore rezultojnë në vlerën 29,691 lekë.

31.3 Komisioni hetoi⁹⁶ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasin B.K dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këtë shtetas.

31.4 Lidhur me burimin e ligjshëm, Komisioni hartoi analizën financiare si vijon në lidhje me mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për të blerë me të ardhurat e vitit 2013 deri në datën e blerjes automjetin tip “Volksäagen Golf”, me targë ***, nga e cila rezultoi se ata kishin mundësi financiare.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

32. Llogari kursimi me nr. *, në emër të bashkëshortes D.SH, pranë Union Bank.** Balanca në shumën 496,569 lekë, datë 24.1.2017⁹⁷. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga paga.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

32.1 Nga hetimi⁹⁸ rezultoi se llogaria e kursimit nr. *** është regjistruar në emër të personit të lidhur D.SH, me gjendje në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* (datë 29.1.2017) në shumën 496,569 lekë. Gjendja e saj është krijuar nga transferimi i shumës 30,000 lekë çdo muaj nga llogaria e pagës së bashkëshortes, duke filluar prej nëntor 2011.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

33. Llogari rrjedhëse me nr. *, pranë Union Bank në emër të D.SH.** Balanca në shumën 66,333 lekë datë 24.1.2017⁹⁹. Burimi i krijimit: të ardhura të kursyera nga paga.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

33.1 Union Bank¹⁰⁰ konfirmon llogari rrjedhëse për pagamarrësit në emër të shtetas D.SH, me gjendje në shumën 41,333 lekë në datën 27.1.2017. Në këtë llogari transferohen të ardhurat e bashkëshortes nga maji i vitit 2010 e në vijim. Gjendja e saj është krijuar prej të ardhurave nga paga dhe prej gjendjes së kësaj llogarie transferohet në bazë mujore vlera 30,000 lekë në llogarinë e kursimit të trajtuar më lart, në pikën 32.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

⁹⁵ Shkresat e AMF-së nr. *** prot., datë 30.11.2022; nr. *** prot., datë 3.3.2021; nr. *** prot., datë 10.3.2021.

⁹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 28.3.2024.

⁹⁷ Subjekti bashkëlidh me deklaratën e pasurisë (aneksi 4/12): Vërtetim bankar nga Union Bank, datë 24.1.2017, për llogari rrjedhëse në emër të shtetas D.SH, në shumën 496,569 lekë.

⁹⁸ Shkresë e Union Bank nr. *** prot., datë 9.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 5.10.2023.

⁹⁹ Bashkëlidhet me deklaratën (Aneksi 4/12): Vërtetim bankar nga Union Bank për llogari rrjedhëse të pagës në shumën 66,333 lekë.

¹⁰⁰ Shkresat e Union Bank nr. *** prot., datë 9.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 5.10.2023.

34. Aksione në vlerën 0.0001% pranë kompanisë “P” sh.a. si punonjëse e kësaj kompanie, blerë në shkurt të vitit 2016 (investuar si vlerë nga paga). Regjistruar në QKR. Burimi i krijimit: nga pagat.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

34.1 Nga hetimi¹⁰¹ rezultoi se shtetasja D.SH është ortakë, zotëruese e 7,235 aksioneve me 0.014% të aksioneve në shoqërinë “P.C” sh.a., regjistruar në QKB me NIPT ***, me kontribut në para në vlerën 8,537 lekë. Subjekti bashkëlidh¹⁰² kopje të kontratës të transferimit të pjesëve të kapitalit midis shoqërisë “****” në cilësinë e ortakut dhe shtetasës D.SH në cilësinë e punëmarrësit, e lidhur në datën 3.6.2016, ku bashkëshortja e subjektit ka marrë pjesë në planin e ofruar nga punëdhënësi për punëmarrësit e tij “****”, duke i transferuar në pronësi të saj 7,235 aksione të shoqërisë “P”, me çmim të barabartë me 1 euro.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

35. Subjekti deklaron në deklaratën e pasurisë në lidhje me detyrimet financiare:

35.1 Kontratë huaje në llogari rrjedhëse (fleksion krediti), e lidhur në datën 1.2.2011 me Raiffeisen Bank (*overdraft*), në vlerën 240,000 lekë (limit *overdraft*-i). Balanca më 19.1.2017: zero lekë.

35.2 Në deklaratën e vitit 2011, subjekti deklaron kontratën e *overdraft*-it të lidhur me Raiffeisen Bank. Gjithashtu Raiffeisen Bank¹⁰³ konfirmon llogari *overdraft*-i në emër të subjektit me gjendje 240,000 lekë në datën 30.1.2017.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuadër të procesit të rivlerësimit.

35.3 Master Card me nr. *, në euro, e hapur në Raiffeisen Bank. Balanca në datën 19.1.2017: zero euro.**

35.4 Raiffeisen Bank¹⁰⁴ konfirmon kartë krediti në emër të subjektit me limit 68,215 lekë, e hapur në gusht të vitit 2016 me gjendje në datën 19.1.2017 në shumën 0.01 euro. Komisioni përfshiu në analizën financiare shumën e rezultuar nga hetimi i *statement*-it bankar i llogarisë pranë Union Bank të bashkëshortes së tij për shpenzimet e kryera me kartën e kreditit në vitet 2014 – 2016.

35.5 Subjekti i rivlerësimit shpjegon pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore se këto shpenzime nuk duhen përfshirë në analizën e Komisionit. Trajtimi i tyre është paraqitur më lart, me pasurinë automjet të tipit “Volkswagen”, me targë ***. Komisioni vlerësoi se në analizën financiare përfundimtare nuk do të përfshihen shpenzime të kryera me kartën e kreditit të bashkëshortes.

GJETJE TË TJERA

36. Kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti dhe bashkëshortja në deklaratat periodike

36.1 Bashkëshortja e subjektit deklaron në DPDF 2009: *gjendje cash në banesë 15,000 euro*. Komisioni nuk përfshiu në analizën financiare gjendje kursimesh *cash* përpara fillimit të detyrës dhe shumën e saj nuk do të mbarten në vitet në vijim, sipas metodologjisë së përcaktuar edhe nga

¹⁰¹ Shkresat e QKB-së nr. *** prot., datë 11.3.2021 dhe nr. ***, datë 19.12.2022.

¹⁰² Pyetësori nr. 2.

¹⁰³ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023; përgjigjja në aneksin 4/7.

¹⁰⁴ Shkresat e Raiffeisen Bank sh.a. nr. *** prot., datë 12.3.2021; nr. *** prot., datë 22.11.2022; nr. *** prot., datë 20.9.2023.

Kolegji, pasi nga analiza financiare para fillimit të detyrës rezultoi se subjekti nuk kishte burime të ligjshme për të krijuar kursimet *cash*, duke rezultuar në vlerë negative përpara marrjes së detyrës në shumën prej -7,967,469 lekësh.

36.2 Ndërsa për deklaratimet e subjektit në DIPP-të e viteve 2009 – 2014¹⁰⁵ për kursimet *cash* është trajtuar më lart në analizën e burimit të blerjes së apartamentit në rrugën “****”, Tiranë.

36.3 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi: “Gjendje *cash* në banesë 400,000 lekë”. Komisioni përfshiu në analizën financiare gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti prej 400,000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën e pasurisë nuk ka deklarim në lidhje me kursime *cash*, pra në analizën financiare është mbartur gjendja *cash* e vitit 2015.

36.4 Në pyetësonin standard¹⁰⁶, subjekti deklaroi: “Rruga “****”, pall. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, apartament me sipërfaqe 89.95 m², në bashkëpronësi me bashkëshorten time D.SH. Siç kam deklaruar edhe në deklaratimet periodike për mobilimin e këtij apartamenti janë shpenzuar në total 10,000 euro (përfshirë një pjesë të punimeve të brendshme, arredimin, pajisjet elektroshtëpiake dhe kondicioner për ngrohje)... Këto shpenzime janë kryer gjatë muajve korrik – shtator të vitit 2010 në vlerën 6,000 euro. Dhoma e gjumit e fëmijëve dhe ngrohja janë kompletuar gjatë vitit 2011 me një vlerë rreth 4,000 euro”. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet për mobilim sipas deklaratimit të mësipërm, por nuk ka përfshirë si burim për krijimin e tyre kursimet *cash* të krijuara përpara marrjes së detyrës.

36.5 Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime me pyetësonin nr. 2¹⁰⁷ në lidhje me gjendjen e kursimeve *cash* prej 400,000 lekësh të deklaruara në vitin 2015, e cila nuk deklarohet më pas në DIPP-në e vitit 2016 apo në deklaratën *Vetting* si gjendje kursimesh *cash*. Subjekti sqaroi se: “Gjendja *cash* në banesë, 400,000 lekë, ka shërbyer si burim për mobilimin e apartamentit në rrugën “****” ...Në rubrikën e shpenzimeve DIPP 2016 kam deklaruar si burim “c- kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014 nga unë dhe bashkëshortja”. Në fakt, përshkrimi duhej bërë pakësim i gjendjes *cash* në banesë para datës 31.12.2015... Ky ka qenë dhe shkaku që nuk është deklaruar, pasi ajo ishte shpenzuar dhe nuk ekzistonte më si gjendje *cash* në banesë”.

Komisioni ka konsideruar gjendjen e kursimeve *cash* në fund të vitit 2016 në shumën 400,000 lekë, pasi subjekti kishte detyrim ta deklaronte pakësimin e saj në DIPP-në e vitit 2016, prej së cilës ka rezultuar mospërputhje e gjendjes së kursimeve *cash* më 31.12.2016 me mosdeklarim (0 lekë) në deklaratën *Vetting*.

36.6 Në lidhje me burimin e gjendjeve të kursimeve *cash*, referuar analizës financiare gjithëpërfshirëse, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2009, pasi rezultati financiar për këtë periudhë është - 7,967,469 lekë, në vitin 2010 -120,000 lekë, në vitin 2014 -650,000 lekë dhe në vitin 2015 -400,000 lekë. Pra, në total, pamundësia për krijimin e gjendjeve *cash* të kursimeve rezulton në vlerën -3,067,550 lekë.

36.7 Pas kalimit të barrës së provës, në lidhje me pamundësinë e krijimit të gjendjes së kursimeve *cash*, subjekti shpjegon se gjendja negative e rezultuar përpara marrjes së detyrës duhet t’i zbritet gjendjes së likuiditetit të deklaruar përpara fillimit të detyrës dhe analiza e gjendjes *cash* në vazhdim të përllogaritit sipas deklaratimit në deklaratat periodike vjetore. Pra, në rast të deklarimit

¹⁰⁵ Për më shumë referojuni rezultateve të hetimit.

¹⁰⁶ Pyetja nr. 14, pyetësoni standard.

¹⁰⁷ Pyetja nr. 28, pyetësoni nr. 2.

të gjendjes *cash* përpara fillimit të detyrës, gjendja e likuiditetit në vitet në vazhdim të deklarimit përlogaritët aq sa është mundësia e kursimit përpara detyrës. Gjendja negative e krijuar përpara fillimit të detyrës nuk mblidhet me diferencën që mund të rezultojë gjatë viteve të ushtrimit të detyrës. Ky qëndrim është i konsoliduar nga Kolegji¹⁰⁸ dhe, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën bazë për marrjen e masës disiplinore. Kjo mënyrë të vlerësuar është praktikë e konsoliduar tashmë e trupave të rivlerësimit. Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, bashkëshortja ka deklaruar “*Gjendje cash në banesë, 15,000 euro*”. Meqenëse përpara detyrës konstatohet një diferencë negative, kjo diferencë duhet t’i zbritet përlogaritjes së gjendjes *cash* në vazhdim.

36.8 Subjekti shpjegon se ka deklaruar në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI se ka shpenzuar për mobilim shumë 10,000 euro në vitet 2010 dhe 2011, gjithashtu ka deklaruar mobilim edhe si pjesë të faturës 18,000 euro, paguar shoqërisë “N” sh.p.k. në vitin 2009. Në kushtet kur nuk ka pasur dokumentacionin e kryerjes së këtyre shpenzimeve në momentin që ka dhënë shpjegimet në ILDKPKI, sqaron se deklarimi i burimit të shpenzimeve të mobilimit nuk ka qenë i saktë. Pavarësisht këtij fakti, rezulton se në DIPP-në e viteve 2010 dhe 2011 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* dhe, për këtë arsye, deklarimi i gjendjes *cash* duhet të përlogaritët sipas deklarimit në DIPP, ashtu siç përcaktohet në jurisprudencën e trupave të rivlerësimit, njësuar në vendimin JR nr. 7/2019 të Kolegjit dhe nr. 11 të vitit 2019.

Vlerësimi i Komisionit

36.9 Komisioni vlerësoi se dokumentacioni i përcjellë nga subjekti dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar me pasuritë e trajtuara më lart në këtë vendim, të krijuara para marrjes së detyrës, pasi përfshihen në analizën e Komisionit, ndryshojnë rezultatin e saj për periudhën tetor 1999 – dhjetor 2009 në shumë -1,677,880 lekë. Pra, subjekti ka mundësi të kursejë me burime të ligjshme si kursime *cash* përpara marrjes së detyrës vetëm vlerën 379,670 lekë.

36.10 Komisioni vlerëson se mbështetur në praktikën e Kolegjit analiza financiare duhet të rishikohet dhe duhet të përfshihen si kursime *cash* në vitin vijues vetëm shtesat e kursimeve *cash*, për të cilat është provuar burimi i ligjshëm në periudhën para marrjes së detyrës. Pra, vetëm vlera 379,670 lekë duhet të përfshihet si kursim *cash* në vitin 2009 nga gjendja e deklaruar *cash* prej 15,000 euro para detyrës, pasi nga analiza e Komisionit u provua vetëm kjo vlerë me burim të ligjshëm. Kjo vlerë do të mbartet në analizën e Komisionit deri në vitin 2014, ku subjekti deklaroi në DIPP-në e vitit 2015 pakësimin e kursimeve *cash*. Ndërsa për shtesat e deklaruara në vitet 2010 – 2015, pavarësisht se nga analiza e Komisionit rezultoi me pamundësi financiare për krijimin e tyre në vitet 2010, 2014 dhe 2015 me burim të ligjshëm, Komisioni çmon se metodologjia e ngritur tashmë për deklarimet e kursimeve *cash*, duke i konsideruar deklaratat periodike si provën e vetme të tyre, duhet të zbatohet edhe në analizën financiare të subjektit. Pra, shtesat e kursimeve *cash* të deklaruara në vitet 2010, 2011, 2014 dhe gjendja e kursimeve *cash* e deklaruar në vitin 2015 duhet të përfshihen në analizën financiare siç është deklaruar në deklaratat periodike vjetore, pavarësisht situatës me burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

36.11 Në lidhje me deklarimin para ILDKPKI-së se i ka përdorur për mobilimin e apartamentit të ndodhur në rr. “***”, “***”, Komisioni vlerëson se aplikimi i metodologjisë për hartimin e

¹⁰⁸ Vendim nr. 27/2022 i Kolegjit.

analizës financiare nuk duhet të jetë i ndryshëm. Pra, ato do të shtohen si shpenzime, por nuk do të konsiderohet pakësim i kursimeve *cash*, pasi nuk janë deklaruar në DIPP-të përkatëse.

36.12 Kolegji¹⁰⁹ në vendimmarrjen e tij ka referuar se në këndvështrim të kuadrit ligjor subjekti ka detyrë të deklarojë, duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurorë dhe të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshirë rregullat kontabël, për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues.

36.13 Komisioni në realizimin e analizës financiare mori në konsideratë deklaratat e bëra nga subjekti si likuiditete *cash* në DIPP-të e çdo viti, nisur nga fakti se këto të fundit përbëjnë provë konform ligjit nr. 84/2016 dhe janë deklarime të bëra në kohë reale, në çdo vit deklarimi, pa e lidhur shumë e gjendjes së kursimit me pamundësinë/mundësinë financiare për krijimin e saj. Komisioni pasqyroj në analizë gjendjet *cash* sipas deklarimeve në deklaratat periodike vjetore të subjektit, duke mbartur në vitet pasuese vlerat edhe në rastet kur rezultoi me pamundësi financiare për krijimin e tyre.

37. Analiza financiare tetor 1999 – nëntor 2009 dhe pas marrjes së detyrës dhjetor 2009 – 2016

37.1 Subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për rezultatin e analizës financiare për periudhën tetor 1999 – nëntor 2009 dhe dhjetor 2009 – 2016 me vlerë negative në totalin -15,928,338 lekë, nga të cilat për periudhën dhjetor 2009 – 2016 rezulton me vlerë negative prej -3,102,240 lekësh. Ndërsa, nga analiza përpara fillimit të deklaratimit të vitit 2009 rezulton me pamundësi financiare në vlerën -12,826,098 lekë. Komisioni i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 mbi pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit.

Vlerësimi i Komisionit

37.2 Pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara prej tij, Komisioni arriti në konkluzionin se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të mjaftueshëm. Këto vlerësime të Komisionit, të trajtuara gjerësisht më lart, u reflektuan në analizën financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën totale -3,144,331 lekë, specifikisht përpara marrjes së detyrës në vlerën -1,677,880 lekë dhe pas detyrës në vlerën totale -1,466,451 lekë, rezultuar në vitin 2010 vlera -170,764 lekë, në vitin 2014 vlera -426,691 lekë dhe në vitin 2015 vlera -868,996 lekë.

¹⁰⁹ JR 20/2019, faqja 18, paragrafi 56.

ANALIZA FINANCIARE DHJETOR 2009 – 2016

Përshkrimi	Para marrjes së detyrës	dhjetor 2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	16,731,212	-1,729,720	-501,206	936,194	1,072,558	643,152	1,356,138	2,435,485	11,378,991
Apartament me sipërfaqe 72.20 m ² në Rrugën "D" B**", kontratë sipërmarrje datë 30.5.2003, kontratë shitje datë 1.7.2010. Burimi: të ardhurat nga paga si OPGJ ndër vite dhe si avokat 10.4.2002 - 31.12.2003 dhe një vlerë 10.041 euro dhuratë nga A* Sh* (vëllai), me banim në L*, të depozituara në llogarinë e subjektit pranë P* Bank në datë 2.7.2003, T*.	3,885,059								
Carozh, në Rrugën "Q" S**", me sipërfaqe 35m ² . Kontratë sipërmarrje datë 13.11.2009. Vlera 14.000 euro. Burimi: të ardhura nga puna ndër vite së bashku me bashkëshortin.	1,724,555								
Apartament banimi me sip.103 m ² , në rrugën "Q" S**". Kontrata e sipërmarrjes dt. 04.06.2008. Vlera 61.800 euro. Burimi i krijimit: 1- Dhuratë nga babai 40.000 euro. Deklaratë materiale nr. *** rep/ko/dt. 27.10.2009. 2- Hua sipas kontratës dt.12.09.2005, vlera 23,000 USD marrë nga N* Q* P* Zh*.	7,612,679								
Apartament me sipërfaqe 96.5 m ² në Rrugën "T" D**". Kontratë pomsje datë 8.9.2015, kontratë shitje datë 20.10.2016, paguar me kështë datë 8.9.2015 shuma 40.000 euro; datë 8.3.2016 shuma 39.952 euro dhe 18.10.2016 shuma 22.840 euro. Vlera 12.720.000 lekë. Burimi: a) llogari kursimi në emër të D* Sh* në U* Bank krijuar me të ardhurat ndër vite; b) hua nga E* Q* me aktin notarial datë 27.9.2016, (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); c) kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014; d) shitja e apartamentit me sip. 89.95m ² me adresë Rruga "Q" S**", T*, sipas kontratës datë 20.10.2016 në vlerën 85.000 euro.								5,506,000	7,147,667
Autoveturë, markë Volkswagen, kontratë shitje datë 12.5.2016. Vlera 8.000 euro. Burimi: shitja e autoveturës e markës Volkswagen Golf Plus me targa * si dhe kursime nga paga.									1,082,160
Autoveturë e markës Volkswagen Golf Plus me targa * blerë në dt. 25.10.2012.					859,910				
Autonetit i markës Volkswagen Golf, me targë *.									
Autonetit i markës Volkswagen Golf, me targë *, blerë në datë 20.03.2007	250,000								
Autonet Opel Corsa, me targë *, datë 6.6.2013. Vlera 900 euro dhe 29.600 lekë detyrim doganor. Burimi: të ardhura të kursyera nga paga.						155,789			
Aksione në vlerën 0.0001% pranë Kompanisë "P**" sha si punonjëse e kësaj kompanie të bashkëshortes, blerë në Shkurt 2016 (investuar si vlerë nga paga). Burimi, nga pagat.									
Shitesa pakësimë likuiditete në bankë dhe CASH	3,258,919	-1,729,720	-501,206	936,194	212,648	487,363	1,356,138	-3,070,515	3,149,165
Total Hkuditete	3,258,919	-1,729,720	1,027,993	1,964,187	2,176,835	2,664,198	4,020,336	949,821	4,098,986
DETYRIME	1,260,542	0	-1,596,315	0	0	0	0	633,200	-641,450
Hua marrë nga shtetasi N* Q* P* Zh* me kontratë datë 12.09.2005 në vlerën 23,000	1,260,542		(1,596,315)						
Hua marrë nga shtetasi E* Q* me akt notarial dt. datë 27.9.2016, në vlerën 40.000 euro dhe 5,000 USD në dt. 08.09.2015.								633,200	-641,450
PASURINETO	15,470,670	-1,729,720	1,095,109	936,194	1,072,558	643,152	1,356,138	1,802,285	12,020,441
TË ARDHURA të dokumentuara	16,452,656	142,103	2,389,116	3,127,317	2,519,588	2,417,053	2,384,408	2,480,668	15,013,853
Të ardhura nga emigracioni, nga 20.05.1993-01.09.1995. Vlera 2,000,000 lekë.									
Të ardhura nga kompanitë rentiere (V* shpk)	873,113								
Të ardhura nga paga si OPGJ, për periudhën 16.10.1999-10.04.2002 dhe vlera e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.	4,453,175	72,731							
Të ardhura nga puna si avokat datë 10.4.2002 - 31.12.2003, në Studion Ligjore me NIPT *. Shuma 2,518,333 lekë.	1,573,940								
Të ardhura nga detyra si Oficer i Policisë Gjuetësore 2004-10.12.2009 si dhe Prokuror datë 10.12.2009 - 31.12.2016. Shuma 13,972,719 lekë.		14,937	1,162,385	1,291,633	1,140,852	1,142,145	1,317,145	1,267,398	1,293,551
Të ardhura nga paga e bashkëshortes, si specialiste pranë M* & D* (tetor 2005-shkurt 2008), pranë T* A** sha dhe P* C** sha. Shuma 11,075,784 lekë.	2,427,129	54,435	1,226,653	1,384,250	1,344,976	1,229,233	1,032,358	1,194,100	1,396,442
Të ardhura nga shitja e autometit të markës Volkswagen Golf, me targë * (kontratë shitje datë 27.1.2007, blerë me të ardhurat nga pagat). Shuma 200,000 lekë.	200,000								
Të ardhura nga shitja e autometit të markës Volkswagen Golf, me targë * (kontratë shitje datë 6.9.2011, blerë me të ardhurat nga pagat). Shuma 450,000 lekë.				450,000					
Të ardhura nga shitja e autometit të markës Volkswagen Golf Plus me targë * (kontratë shitje datë 11.5.2016, blerë me të ardhurat nga shitja e autometit të mësipërm). Shuma 6,100 euro.									825,147
Dhuratë nga vëllai në A* (A* Sh*) në vitin 2004 në shumën 12,760 euro kaluar në llogarinë nr. * në P* B* dhe në datë 28.5.2008 kaluar në llogarinë * në GIB, RFB.	1,936,352								
Të ardhura nga trajnim (kaluar në llogarinë * në USD - RFB), si trajnues i trajnerëve pranë Shkolles së M*, organizuar nga O*, kaluar nëpërmjet bankës në datë 13.5.2013. Shuma 994 USD.									
Të ardhura nga trajnim i organizuar nga O*, në K*, në datë 26.9.2016-30.9.2016. Shuma 556 USD.									
Të ardhura nga trajnim i organizuar nga O*, në K*, në datat 29.3.2015, 5.6.2015, 6.11.2015 dhe 11.12.2015. Shuma 1,600 USD.									
Të ardhura nga shitja e e apartamentit me sipërfaqe 89.95 m ² , në Rrugën "Q" S**", T* sipas kontratës datë 20.10.2016. Shuma 85.000 euro.									11,497,950
Dhuratë në vlerën 40.000 euro nga shtetasi P* Q* P* (babai i bashkëshortes), dhuratë për D* Sh* (bashkëshortja) sipas aktit notarial datë 27.10.2009. Burimi i shumës së dhuruar është nga puna e tij në Q* që në vitin 1999, vërtetuar kjo me vizat ndër vite, leje pune me nr.* datë 1.8.2003 si dhe dokumentat e dorëzuara në organet tatimore në Q* që provojnë të ardhurat mujore.	4,927,300								
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë U* bank				1,386	33,711	45,612	34,862	19,161	754
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë R* bank	32,762								
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë D* bank	28,884		78	48	49	63	43	8	9
SHPENZIME	2,659,866	45,540	1,464,771	1,223,123	755,104	825,511	1,454,960	1,547,378	2,885,224
Shpenzime shkolliu për rimbajtje, në shkollën "V" e D** T* për vitin akademik 2016-2017. Vlera 2.550 euro marrur në shtator 2016, 550 euro dhe në janar 2017, vlera 2,000 euro.								240,888	74,399
Shpenzime për mobilim e apartamentit të ndodhur në rr. Q* S* sipas pyetësor standart			832,860	553,200					
Shpenzime marrëmbajtje të autometit me targa * sipas shpjegimeve në pyetësor nr. 2	398,950								
Shpenzime për mobilim e apartamentit në Rrugën "T" D**", Vlera 11,000 euro.									1,487,970
Shpenzime siguracioni për autometin rezultuar nga A*							30,950	15,360	14,760
Shpenzime pagues për kartën e kreditit të bashkëshortes pranë U* Bank									
Shpenzime udhëtimi sipas funksionit			77,000	77,000	77,000	77,000	77,000	77,000	77,000
Shpenzime udhëtimi	86,308		8,431	46,443	119,912	184,415	467,018	317,027	290,727
Shpenzime jetike	2,174,608	45,540	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104
Analiza dokumentuar	-1,677,880	1,826,283	-170,764	968,001	691,926	948,391	-426,691	-868,996	108,187

38. Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

38.1 Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

38.2 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla për zbatimin e parimit të prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

38.3 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

38.4 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitet.

38.5 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Afrim Shehu, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

39. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), pas kërkesës për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka dërguar pranë Komisionit¹¹⁰ raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu, deklasifikuar plotësisht¹¹¹ dhe Grupi i Punës ka konkluduar se:

- i) Formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016.
- ii) Për subjektin e rivlerësimit, z. Afrim Shehu, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

¹¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.1.2023.

¹¹¹ Me vendimin nr. ***, datë 10.1.2023, të KDZH-së.

39.1 Në konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu.

39.2 Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i provave të grumbulluara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Afrim Shehu, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

39.3 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Afrim Shehu ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

40. Në zbatim të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, dorëzuar në Komision nga KLP-ja¹¹², si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ.

40.1 Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

40.2 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit¹¹³, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor¹¹⁴; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

40.3 Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika për sa i përket kriterit profesional.

¹¹² Raporti profesional i KLP-së nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹¹³ Dokumenti 1. Vendim për mosfillimin e procedimit penal mbi aktet e kallëzimit nr. *** të kallëzuesit, *** Bank, ndaj shtetasit B. N., me detyrë përmbarues, akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”; Dokumenti 2. Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, me të pandehur N. P., akuzuar për veprën penale “Korrupsionit pasiv në sektorin privat”, “Falsifikimi i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë, parashikuar nga nenet 164/b e 186/3 të Kodit Penal; Dokumenti 3. Diskutimi përfundimtar në përfundim të gjykimin të çështjes penale nr. *** me të pandehur E. B., G. B., D. N., akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 244, 245/1, pg. 2, 259-25 të Kodit Penal.

¹¹⁴ Dosja 1. Vendimi mosfillimi datë 20.11.2014 që i përket kallëzimit penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, referimit të bërë nga Ministria e T ndaj Provincës F për veprën penale “Ndërtimi pa leje”; Dosja 2. Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rifilluar në datën 4.9.2012, regjistruar për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, është vijuar me pushimin e hetimeve për veprën penale “Trafikimi i mjeteve motorike” ndaj shoqërisë “B.” sh.p.k. dhe marrjen të pandehur shtetasit B. D. dhe H. K., akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Dosja 3. Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve J. Ç., vijuar me vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 21.9.2016; Dosja 4. Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar për veprën penale “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit L. T. dhe personi juridik, shoqëria “T.” sh.p.k., vijuar me kërkesë për gjykimin e çështjes penale; Dosja 5. Procedimi penal nr. *** i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, regjistruar për veprën “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit M. S dhe personit juridik “S.” sh.p.k.

41. Të dhëna nga burime arkivore (ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime)

❖ Nga verifikimi në arkivin e KLP-së rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu nuk janë dhënë masa disiplinore;

❖ Sipas të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, subjekti Afrim Shehu është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm me “shumë mirë” për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

42. Të dhëna nga prokuroritë mbi kallëzime/procedime penale ndaj subjektit Afrim Shehu

42.1 Prokuroria e Përgjithshme¹¹⁵ i ka përcjellë Komisionit informacionin e dërguar nga prokuroritë e rretheve gjyqësore të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat konfirmojnë se pranë tyre nuk rezulton të ketë procedime penale të mosfilluara/pushuara/pezulluara apo të dërguara për gjykim për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu¹¹⁶.

42.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹¹⁷ konfirmon se në periudhën 2011 – 2023 ndaj subjektit rezulton të jenë regjistruar 12 kallëzime për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, për të cilat pas verifikimit është vendosur mosfillimi i tyre¹¹⁸.

42.3 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës¹¹⁹ konfirmon se pranë saj janë dërguar për kompetencë nga prokuroritë e tjera 3 kallëzime penale, për të cilat është vendosur mosfillimi i tyre¹²⁰.

¹¹⁵ Përgjigjja e Prokurorisë së Përgjithshme nr. *** prot., datë 8.6.2021, drejtuar Komisionit.

¹¹⁶ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë me nr. *** prot., datë 18.5.2021; Shkodër nr. *** prot., datë 16.3.2021; Lushnjë nr. *** prot., datë 19.3.2021; Dibër nr. *** prot., datë 19.3.2021; Kavajë nr. *** prot., datë 16.3.2021; Fier nr. *** prot., datë 12.3.2021; Kukës nr. *** prot., datë 11.3.2021; Sarandë nr. *** prot., datë 11.3.2021; Durrës nr. *** prot., datë 11.3.2021; Tropojë nr. *** prot., datë 8.3.2021; Mat nr. *** prot., datë 8.3.2021; Lezhë nr. *** prot., datë 9.3.2021; Berat nr. *** prot., datë 9.3.2021; Kurbin nr. *** prot., datë 9.3.2021; Pogradec nr. *** prot., datë 9.3.2021; Pukë nr. *** prot., datë 9.3.2021; Vlorë nr. *** prot., datë 9.3.2021; Gjirokastrë nr. *** prot., datë 8.3.2021; Korçë nr. *** prot., datë 10.3.2021; Përmet nr. *** prot., datë 5.3.2021; Elbasan nr. *** prot., datë 11.3.2021.

¹¹⁷ Përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me nr. *** prot., datë 9.3.2021, dhe nr. *** prot., datë 21.10.2023 dhe me nr. *** prot., datë 17.10.2023, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

¹¹⁸ 1. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit P. N. ndaj prokurorëve D. G. e Afrim Shehu. Prokurori A. B. pas veprimeve hetimore të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal. 2. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit P. Gj. Prokurori Sh. K. pas veprimeve hetimore të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal; 3. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit Sh. M. Prokurori A. M. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 8.10.2018; 4. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit J. S. Prokurori E. I. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 16.12.2019; 5. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit J. S. Prokurorja D. S. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 27.12.2019; 6. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit V. V. Prokurorja M. M., pasi ka hetuar kallëzimin, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal datë 3.3.2023; 7. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit J. S. Prokurorja I. A pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 6.1.2020, pasi fakti objekt kallëzimi ka qenë objekt verifikimi i mëparshëm nga Prokuroria e Rrethit Tiranë, trajtuar me kallëzimin nr. *** dhe ***; 8. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit L. M. Prokurori S. S. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 25.5.2021; 9. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit V. V. Prokurorja M. M. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 30.3.2023, pasi fakti nuk përmban elemente të veprës penale; 10. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit I. H. Prokurorja A. Q. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 20.2.2022; 11. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit A. V. Prokurori O. Rr. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 4.10.2022; 12. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit A. Ç. Prokurori O. Rr. pas verifikimeve të kryera vendosi mosfillimin e procedimit penal në datën 19.6.2023.

¹¹⁹ Përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me nr. *** prot., datë 17.10.2023, drejtuar Komisionit dhe me nr. *** prot., datë 28.9.2023, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

¹²⁰ 1. Dërguar për kompetencë nga PPKO kallëzimi i shtetasit G. S. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj subjektit Afrim Shehu. Prokurori G. Ç., pasi verifikoi të dhënat, vendosi mosfillimin e këtij procedimi në datën 23.9.2022. 2. Kallëzimi nr. 90/2023 (në ish-Prokurorinë Kavajë) i shtetasit F. Gj. ndaj subjektit Afrim Shehu. Prokurorja M. M., pasi kreu verifikimet, vendosi mosfillimin e kallëzimit penal, pasi nuk ndodhemi përpara ndonjë vepre penale. 3. Kallëzimi nr. *** (përcjellë nga Prokuroria e Posaçme për kompetencë) i shtetasit G. S. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Prokurori G. Ç., pas verifikimeve të kryera

42.4 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹²¹ konfirmon se pranë saj janë regjistruar 4 kallëzime penale dhe specifikisht:

42.4.1 Kallëzimi i shtetasit V. Ç., dërguar për kompetencë nga PPKKO ndaj subjektit Afrim Shehu. Prokurori E. B., pasi analizoi të gjitha faktet dhe provat e këtij kallëzimi, vendosi mosfillimin e këtij procedimi penal në datën 16.6.2023.

42.4.2 Kallëzimi i shtetasit A. B., i cili u regjistrua si procedim penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Shpërdorimi i detyrës” mbi bazën e materialeve të ardhura për kompetencë nga Prokuroria e Përgjithshme ndaj prokurorit Afrim Shehu. Prokurori i çështjes A. Sh. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 11.6.2019 me kërkesë për pushim çështjeje. Gjykata e Elbasanit¹²² ka kthyer aktet për vazhdimin e hetimeve. Gjykata e Apelit¹²³ ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndërsa në datën 23.12.2019 dosja i është dërguar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme.

Për t’u informuar më tej se si vijoi çështja në Prokurorinë e Posaçme (në vijim PPKKO), Komisioni administroi përgjigjen e kësaj të fundit¹²⁴, e cila konfirmon se pranë saj është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprat penale të parashikuara nga nenet 260, 319/ç dhe 320/a të Kodit Penal mbi bazën e akteve të procedimit nr. ***, të ardhur për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kallëzues shtetasin A. B. Pas kryerjes së hetimeve është vendosur bashkimi i këtij procedimi penal me procedimin nr. *** në një të vetëm, me nr. ***, regjistruar për veprat penale të sipërpërmendura pa asnjë emër të regjistruar si person nën hetim. Pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal, është vendosur të dërgohet në Gjykatë me kërkesë për pushim në datën 8.7.2022.

Me vendimin nr. ***, datë 14.10.2022, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***. Me vendimin nr. ***, datë 4.1.2023, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 14.10.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

42.4.3 Kallëzimi i shtetasve A. M. dhe H. M., regjistruar me nr. ***, në ngarkim të prokurorit Afrim Shehu. Prokurori i çështjes A. I. pas verifikimeve të kryera në datën 8.2.2023 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Për të vijuar më tej me verifikimin e kësaj çështjeje, Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹²⁵ informacionin ku rezulton se ndaj vendimit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal ka paraqitur ankim në gjykatë kallëzuesi A. M., ku ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të prokurorisë datë 8.2.2023 dhe detyrimin e Prokurorisë të regjistrojë procedimin penal.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me vendimin e datës 28.3.2023¹²⁶ ka vendosur “Rrëzimin e ankimit të ankuesit A. M.; lënien në fuqi të vendimit të

vendosi mosfillimin e procedimit penal, pasi faktet e kallëzuara nuk përbëjnë elemente të veprës penale, pasi arsyetohet se vendimmarrja e prokurorëve kontrollon nga gjykatat.

¹²¹ Përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me nr. *** prot., datë 17.10.2023, drejtuar Komisionit dhe me nr. *** prot., datë 9.10.2023, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

¹²² Me vendimin nr. ***, datë 17.7.2019.

¹²³ Me vendimin nr. *** datë 22.10.2019.

¹²⁴ Përgjigjja e PPKKO nr. *** prot., datë 7.3.2024.

¹²⁵ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nr. *** prot., datë 1.3.2024.

¹²⁶ Vendimi nr. ***, datë 28.3.2023.

Prokurorisë, datë 8.2.2023, për mosfillimin e procedimit penal nr. ***”, me argumentin se hetimet e Prokurorisë dhe vendimi i mosfillimit të procedimit penal janë të bazuara në ligj dhe prova.

Ankuesi A. M. nuk ka qenë dakord me këtë vendim dhe e ka ankimuar atë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila ende nuk ka caktuar një datë për gjykimin e kësaj çështjeje.

42.4.4 Kallëzimi i shtetasit V. Ç., regjistruar me nr. *** ndaj prokurorit Afrim Shehu etj. për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve” etj. Në datën 16.6.2023, prokurorja e çështjes E. B. ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, pasi del qartë që fakti nuk ekziston.

Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹²⁷ informacionin se ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal ka paraqitur ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kallëzuesi V. Ç., por kjo çështje nuk është gjykuar ende.

42.5 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë¹²⁸ konfirmon se pranë saj është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” ndaj prokurorit Afrim Shehu në bazë të kallëzimit të shtetasës R. Rr. Prokurori E. K., pasi ka kryer verifikimet, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila me vendimin nr. ***, datë 30.1.2019, vendosi rrëzimin e kërkesës së shtetasës R. Rr. kundër vendimit të Prokurorisë.

42.6 Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar¹²⁹ konfirmon se ndaj subjektit Afrim Shehu rezultojnë të regjistruara 10 kallëzime/procedime penale (për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” - veprime korruptive), të cilat janë hetuar dhe është vendosur mosfillimi i tyre, ndërsa disa të tjera janë dërguar për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore¹³⁰.

43. Të dhëna mbi ankesat e depozituara ndaj subjektit të rivlerësimit

43.1 KLP-ja¹³¹ konfirmon se për subjektin e rivlerësimit Afrim Shehu nuk rezultojnë të ketë procedim disiplinor.

¹²⁷ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nr. *** prot., datë 1.3.2024.

¹²⁸ Përgjigjja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë nr.*** prot., datë 26.11.2020, drejtuar KLP-së.

¹²⁹ Përgjigjja e Prokurorisë së Posaçme nr. *** prot., datë 1.3.2021, drejtuar Komisionit¹²⁹ dhe me nr. ***, datë 5.10.2023, drejtuar Komisionit.

¹³⁰ 1. Procedimi penal nr. *** i kallëzuesit A. P. Prokurori O. Ç. pas hetimeve vendosi mosfillimin e procedimit penal, për shkak se fakti nuk ekziston; 2. Kallëzimi penal nr. *** i shtetasit P. R. Prokurori E. N., pasi hetoi çështjen vendosi mosfillimin e kallëzimit, pasi nuk ka elemente të fakteve kriminale të veprave penale të pasqyruar në kallëzim. 3. Kallëzimi penal nr. ***, për të cilin pas verifikimit të tij është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 27.7.2023; 4. Kallëzimi penal nr. ***, për të cilin pas verifikimit është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 9.2.2016; 5. Kallëzimi penal nr. ***, për të cilin është vendosur mosfillim procedimi në datën 15.10.2019; 6. Kallëzim penal nr. ***. Pas kryerjes së veprimeve është vendosur kalimi i akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 23.4.2020; 7. Kallëzim datë 5.5.2021 i shtetasës L. M. Pas verifikimeve, ky material kallëzues është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. ***, datë 6.5.2021; 8. Kallëzim i shtetasit G. S., ku pas verifikimit është vendosur që të dërgohet për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë me shkresën nr. ***, datë 8.9.2022; 9. Kallëzim i shtetasit V. V., ku pas verifikimeve është vendosur që të dërgohet për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. ***, datë 2.3.2023; 10. Kallëzim i shtetasit V. Ç., ku pas verifikimit të tij u vendos të dërgohet për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2023.

¹³¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë nr. *** prot., datë 2.3.2021, drejtuar Komisionit.

43.2 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹³² (në vijim ILD) konfirmon se ndaj subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu janë paraqitur 9 ankesa, të cilat janë në proces verifikimi¹³³.

43.3 Prokuroria e Përgjithshme¹³⁴ konfirmon se ndaj subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu rezultojnë 14 ankesa, ku pas shqyrtimit të tyre nuk janë gjetur problematika dhe janë arkivuar¹³⁵.

Denoncime/ankesa nga publiku

44. Ndaj subjektit të rivlerësimit pranë Komisionit janë depozituar 54 denoncime/ankesa nga publiku. Komisioni ka analizuar dhe shqyrtuar me objektivitet 38 denoncime¹³⁶, duke administruar dokumentacionin në dosje, si dhe shpjegimet e subjektit, për të cilat nuk konstatoi problematika që ndikonin në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

45. Komisioni ka analizuar dhe verifikuar 16 denoncime, për të cilat janë administruar akte dhe në përfundim të hetimit i është kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë prova, si vijon.

45.1 Pesë denoncime të përsëritura të shtetas L. M.¹³⁷, e cila ka pretenduar se në hetimin e procedimit penal nr. *** subjekti ka kryer veprime korruptive bashkë me prokurorët e tjerë. Ajo pretendon se ka kërkuar disa herë t'i dorëzojë aktet e dosjes dhe hetimit, por nuk ia kanë vënë në dispozicion dhe subjekti ka zvarritur çështjen për 19 muaj, nga qershori 2019 e deri në janar 2022.

Në përfundim të hetimeve, Komisioni nuk i gjeti të bazuara pretendimet e denoncueses lidhur me veprimet korruptive dhe mospërbushje të kërkesës për marrjen e fashikullit të hetimit, ndërkohë që i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me moskryerjen e asnjë veprimi hetimor për një periudhë kohore 8-mujore.

Subjekti i rivlerësimit, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar ndër të tjera se: *“Vonesa në kryerjen e veprimeve hetimore për procedimin penal nr. *** ka ardhur për shkak të pandemisë Covid – 19 dhe ngarkesës së madhe gjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022”*¹³⁸.

¹³² Përgjigje e ILD-së nr. *** prot., datë 9.3.2021, drejtuar Komisionit.

¹³³ Ankesat e shtetasve F. Gj., V. V., L. K., P. R., E. M., A. Xh., V. B., P. R., M. H.

¹³⁴ Përgjigjja e Prokurorisë së Përgjithshme nr. ***, datë 8.1.2021, ndodhur tek dosja profesionale.

¹³⁵ Shihni ankesat në dosjen profesionale.

¹³⁶ 2 denoncime nr. *** prot., datë 13.12.2017 dhe nr. *** prot., datë 18.12.2017, të shtetasit M. A.; Denoncim nr. *** prot., datë 19.3.2018, i shtetasit G. Z.; Denoncim nr. *** prot., datë 18.5.2018, i shtetasit M. P.; Denoncim nr. *** prot., datë 27.7.2018, i shtetasit A. L.; Denoncim nr. *** prot., datë 12.11.2018, i shtetasit R. R.; 2 denoncime nr. *** prot., datë 24.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 26.9.2019, të shtetasit P. R.; 2 kallëzime penale nr. *** prot., datë 15.7.2020 dhe nr. *** prot., datë 10.3.2021, të shtetasit M. H.; Denoncim nr. *** prot., datë 23.6.2022, i shtetasit M. S.; Denoncim nr. *** prot., datë 4.8.2021, i shtetasit R. M.; Denoncim nr. *** prot., datë 18.11.2021, i shtetasit D. G.; Denoncim nr. *** prot., datë 18.5.2023, i shtetasit A. Ç.; 8 denoncime/ankesa nr. *** prot., datë 6.3.2018; nr. *** prot., datë 27.3.2019; nr. *** prot., datë 14.2.2023; nr. *** prot., datë 20.2.2023; nr. *** prot., datë 20.3.2023; nr. *** prot., datë 23.3.2023; nr. *** prot., datë 18.4.2023; dhe nr. *** datë 19.6.2023 të shtetasit V. V.; Ankimi nr. *** prot., datë 10.1.2024, i shtetasit S. H.; Denoncim nr. *** prot., datë 7.11.2023, i shtetasit S. H.; 2 denoncime, nr. *** prot., datë 18.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.10.2021, të shtetasit A. V.; Denoncim nr. *** prot., datë 12.10.2018, i shtetasit F. D.; Ankim nr. *** prot., datë 6.2.2019, i shtetasit S. S.; 4 (katër) denoncime nr. *** prot., datë 25.3.2019; nr. *** prot., datë 23.12.2019; nr. *** prot., datë 24.12.2019; dhe nr. *** prot., datë 6.1.2020, të shtetasit V. Ç.; Denoncim nr. *** prot., datë 21.6.2019, i shtetasit M. K.; Denoncim nr. *** prot., datë 17.4.2020, i shtetasit L. K.; Ankim nr. *** prot., datë 3.6.2020, i shtetasit I. M.; Denoncim nr. *** prot., datë 29.3.2021, i shtetasit F. Gj.; Denoncim nr. *** prot., datë 17.11.2022, i shtetasit A. M.; Denoncim nr. *** prot., datë 23.3.2023 i shtetasit E. A.

¹³⁷ Denoncime nr. *** prot., datë 16.3.2021; nr. *** prot., datë 28.7.2021; nr. *** prot., datë 17.12.2021; nr. *** prot., datë 5.8.2022.

¹³⁸ Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti depozitoi si provë udhëzimin nr.***, datë 24.3.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm; vendimin nr. ***, datë 26.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si dhe ngarkesën në punë të vitit 2020, 2021 dhe 2022 për prokurorin Afrim Shehu.

Vlerësimi i Komisionit

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

45.2 Denoncim i shtetas A. P.¹³⁹ dhe i shtetasit A. G.¹⁴⁰, të cilët pretendojnë se disa prokurorë dhe gjyqtarë, përfshirë dhe subjektin e rivlerësimit, janë të përfshirë në veprime korruptive me ish-drejtnesin e Prokurorisë së Rrethit Durrës, duke pushuar çështjen e ish-gjyqtarit A. M. dhe përfituar shuma parash.

Në lidhje me pretendimet për korrupsion, Komisioni vëren se denoncuesit nuk kanë depozituar prova apo fakte për të vërtetuar veprën e korrupsionit të dhënies/marrjes së parave nga prokurori Afrim Shehu, ndërkohë që në lidhje me mosankimin e vendimit të Gjykatës, datë 17.2.2016, që vendosi pranimin e kërkesës së ankuesit A. M., duke ndryshuar vendimin e Prokurorisë së Rrethit Durrës, datë 22.1.2016, duke përcaktuar si shkak të pushimit të këtij procedimi atë të parashikuar nga neni 323, pika 1, shkronja (a) e Kodit të Procedurës Penale “*Del qartë se fakti nuk ekziston*”, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka shpjeguar se: “*Pasi është administruar vendimi nr. ***, datë 17.2.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka diskutuar me drejtnesin e Prokurorisë, i cili në kuptim të ligjit procedural të kohës (nenet 24.4 dhe 5 të Kodit të Procedurës Penale) ishte prokuror më i lartë dhe prokuroria ishte organi i centralizuar. Nga diskutimi u vendos që nuk duhet të bëhej ankim ndaj vendimit të gjykatës. Duke qenë se ky procedim dhe gjetja e pikës “3” kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe provat janë të njëjta, të cilat do trajtohen në pikën 3”.*

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerëson se subjekti nuk argumentoi me dokumentacion provues deklaratimet e tij, për pasojë mosveprimi i tij për të ushtruar të drejtën e ankimit përbën shkelje në raport me nenin 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, por kjo mangësi në rastin konkret nuk mund të përbëjë shkak për dhënie e masës disiplinore të shkarkimit.

45.3 Denoncim i shtetasit A. M.¹⁴¹ lidhur me kërkesën drejtuar gjykatës për revokim të vendimit të pushimit 22.1.2016, të procedimit penal *.** Sipas denoncuesit, kjo kërkesë vjen në kundërshtim me disponimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që tashmë përbën gjë të gjykuar që prej vitit 2016¹⁴²;

Në lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesi, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe depozitojë prova në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹³⁹ Denoncim nr. *** prot., datë 5.7.2023.

¹⁴⁰ Denoncim nr.*** prot., datë 11.9.2023.

¹⁴¹ Ankimi nr. *** prot., datë 14.4.2023.

¹⁴² Ankuesi shkruan: “*Pra, del qartë që për shkak të parashikimeve të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e vendimmarrjes, si dhe mospasjes së efekteve prapavepruese të Kodit të Procedurës Penale (ndryshimet e vitit 2017) nuk ka asnjë prerogativë ky prokuror për të kërkuar revokimin e një vendimi të Gjykatës të formës së prerë, duke përdorur si arsyetim bazën ligjore, nenin 329/c të Kodit të Procedurës Penale aktual”.*

Pas dërgimit të rezultateve nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka shpjeguar se: “Pas vendimit... datë 17.2.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ku u vendos pushimi i hetimeve të procedimit penal nr. *** për veprën penale “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi etj.”, parashikuar nga nenet 257/a, paragrafi 2 Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. M., është administruar shkresa e datës 18.11.2019, e ardhur në ILDKPKI, e cila ka dërguar për kompetencë ankesën e shtetasit M. M. ndaj shtetasit A. M., i cili duke shfrytëzuar detyrën e gjyqtarit dhe të kryetarit të gjykatës kishte krijuar pasuri dhe i kishte fshehur në shoqëri fiktive në emër të babait dhe vëllait të tij A. M.

Menjëherë subjekti ka ngarkuar Policinë Gjyqësore për të kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me ankesën. Policia gjyqësore ka verifikuar të dhënat e reja dhe në datën 18.1.2022 më ka informuar se janë zbuluar të dhëna dhe prova të reja, të cilat tregonin se vendimi duhej revokuar për të rifilluar hetimet. Për këtë shkak është paraqitur kërkesë për revokimin e vendimit të pushimit.

Kërkesa e prokurorit është pranuar nga Gjykata me vendimin nr. ***, datë 18.2.2022, duke revokuar vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 27.10.2015 në ngarkim të shtetasit A.M dhe kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për rifillimin e hetimeve.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përputhje me nenin 329/c të Kodit të Procedurës Penale, duke vijuar me kërkesën për revokim të vendimit të pushimit të procedimit të ankuesit A.M, kërkesë kjo e iniciuar nga një shtetas, i cili kishte kallëzuar fakte të reja pranë ILDKPKI-së.

Kërkesa e subjektit është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në përputhje me nenin 329/c të Kodit të Procedurës Penale, duke rrëzuar kështu pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe, për pasojë, nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

45.4 Denoncim i shtetasit E.M¹⁴³, i cili pretendon se prokurori Afrim Shehu ka zvarritur hetimet e procedimit nr. *** lidhur me kallëzimin penal për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë në lidhje me pretendimin e ngritur nga shtetasi E.M, se nga viti 2014 e deri kur u transferua subjekti i rivlerësimit, e zvarriti çështjen në mënyrë të qëllimshme dhe mori vendimin e pushimit të saj në vitin 2015.

Subjekti në prapësimet e tij ka shpjeguar ndër të tjera se: “Pas hetimeve të kryera është konkluduar se për dokumentin “akt adoptimi me nr. ***, datë 4.9.1939 i noterit publik Z. I.” nuk provohej se është i falsifikuar dhe është proceduar me pushimin e hetimeve. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit E.M, i cili nuk rezulton ta ketë kundërshtuar në rrugë gjyqësore.

Shtetasi E.M në datën 6.2.2020 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Durrës me kërkesë për revokimin e vendimit të datës 24.7.2015 për pushimin e hetimeve, me arsyetimin se kishte zbuluar të dhëna të reja. Gjykata me vendimin nr. ***, datë 17.3.2021, ka vendosur revokimin e vendimit

¹⁴³ Denoncim nr. *** prot., datë 14.11.2023.

datë 4.7.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe rifillimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

Në datën 16.4.2021 është administruar vendimi i Gjykatës për fillimin e hetimeve. Është urdhëruar policia gjyqësore për të kryer hetimet e nevojshme sipas urdhrit të delegimit të datës 16.4.2021. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është konfirmuar se procedimi penal nr. ***, datë 24.11.2014, që bën fjalë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186, paragrafi 1 i Kodit Penal, rezulton të jetë ende në hetim¹⁴⁴”.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerëson se subjekti nuk argumentoi bindshëm arsyet e mosveprimit të tij lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore, por duke e vlerësuar këtë çështje në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, në kushtet kur kjo çështje është ende nën hetim, nuk mund të vlerësohet në kuadër të vlerësimit profesional.

45.5 Denoncim i shtetasit P.K¹⁴⁵, i cili ngre ankesë për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës B. G. dhe subjektin e rivlerësimit. Kjo ankesë i është drejtuar ILD-së dhe për dijeni Komisionit, duke pretenduar se:

- Prokurori ka mbështetur palën kallëzuese A. Xh. kundër tij në një kallëzim penal të paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërkohë që për një kallëzim tjetër të ngjashëm të bërë po nga shtetasja A. Xh. prokurori Afrim Shehu ka shpallur moskompetencën, duke e dërguar çështjen për hetim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë.
- Ka bërë pjesë të dosjes hetimore atë të procedimit penal nr. ***, ku është e kallëzuar noterja M. Sh., kunata e prokurorit Afrim Shehu.

Komisioni ka administruar përgjigjen e ILD-së¹⁴⁶, që konfirmon se shtetasi P.K ka depozituar ankesë për subjektin Afrim Shehu, që ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar.

Komisioni në rezultatet e hetimit ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë në lidhje me vendimin për shpalljen e moskompetencës dhe nëse ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë në kuptim të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nëse ka bërë pjesë të dosjes hetimore procedimin penal nr. ***, ku është kallëzuar noterja M. Sh., kunata e tij.

Subjekti në prapësimet e tij ka shpjeguar:

Për çështjen e moskompetencës: “Nga hetimi rezultoi se dokumentet e falsifikuara ishin përdorur nga shtetasi P.K në Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë gjatë gjykimit të çështjes. Më pas është proceduar me shpalljen e moskompetencës tokësore, pasi vendi ku ishte kryer vepra penale ishte vendi ku ishin përdorur faturat dhe çështja duhej dërguar tek Prokuroria e Rrethit Korçë.

¹⁴⁴ Subjekti ka depozituar si prova: (a) vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 17.3.2021, për pranimin e kërkesës së shtetasit E.M për revokimin e vendimit të datës 24.7.2015 të Prokurorisë së Rrethit Durrës, që ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***; (b) urdhër për delegimin e veprimeve hetimore, datë 1.12.2014, të prokurorit Afrim Shehu; (c) urdhër për delegimin e veprimeve hetimore, datë 31.3.2015, të prokurorit Afrim Shehu; (d) njoftimi i datës 29.7.2015 i vendimit për pushimin e procedimit penal nr. *** shtetasit E.M; (e) urdhër për delegimin e veprimeve hetimore, datë 16.4.2021, të prokurorit Afrim Shehu.

¹⁴⁵ Denoncim nr. *** prot., datë 7.7.2023.

¹⁴⁶ Përgjigjja e ILD-së nr. *** prot., datë 26.9.2023, drejtuar Komisionit.

*Shtetasja A. Xh. ka paraqitur një kallëzim tjetër, ku është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i vulave”, dhe kishte si objekt faturat, të cilat ishin përdorur në Gjykatën e Shkallës së Parë Durrës gjatë proceseve gjyqësore. Kërkesa e dërguar për gjykimin e shtetasit P.K është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila në vendimin e saj nr. ***, datë 20.4.2023, ka pranuar kërkesën e prokurorisë. Në vendim gjykata shprehet se “...Gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore”.*

Në të dyja rastet është respektuar kompetenca tokësore e parashikuar nga neni 76.1 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilën është parashikuar se “Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja”.

*Për çështjen e papajtueshmërisë: “...Në datën 23.2.2022 rezulton se subjekti ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga hetimi i procedimit nr. ***, pas kërkesës së të pandehurit P.K. Në këtë çast, subjekti është vënë në dijeni se kishte një procedim penal nr. *** në Prokurorinë e Shkallës së Parë Korçë, ku në kërkesë arsyetohej se P.K kishte kallëzuar shtetasen M. Sh. si notere. Kërkesa për dorëheqje është pranuar nga drejtuesi i Prokurorisë Durrës¹⁴⁷”.*

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni çmon se për çështjen e kompetencës, subjekti ka vepruar në përputhje me nenin 76.1 të Kodit të Procedurës Penale, kur ka hetuar kallëzimin e dytë të bërë nga shtetasja A. Xh. në ngarkim të shtetasit P.K, duke e hetuar në Prokurorinë e Rrethit Durrës si vendi ku janë përdorur faturat për të cilat ishte regjistruar ky kallëzim. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të gjykuar këtë çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës është gjetur e drejtë dhe është pranuar nga Gjykata me vendimin e datës 20.4.2023.

Lidhur me çështjen nëse subjekti ka qenë në kushte papajtueshmërie, Komisioni vëren se ndonëse subjekti nuk ka lidhje me procedimin penal nr. *** që hetohej në Prokurorinë e Rrethit Korçë, ku ishte e përfshirë edhe kunata e tij, noterja M. Sh., me procedimin penal nr. *** që po hetonte në Durrës, në momentin që është njohur me kërkesën e të pandehurit P.K, ka kërkuar zëvendësimin e tij nga kjo çështje. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në kushte papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të tij.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, çmoi se nuk u konstatuan problematika që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit dhe vlerësoi se nuk rezultuan problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit.

45.6 Dy denoncime të shtetasit D.P¹⁴⁸, i cili ngre pretendime ndaj gjyqtarit A. Ç. dhe subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar se ky i fundit nuk ka bërë hetim të plotë, ka qenë i njëanshëm duke

¹⁴⁷ (a) Vendimi i datës 31.10.2023 i drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Durrës, znj. A. J., për zëvendësimin e prokurorit Afrim Shehu me prokurorin S. N. për procedimin penal nr. ***; (b) Vendimi i datës 30.3.2022 i drejtueses së Prokurorisë Durrës për pranimin e kërkesës së të pandehurit P.K për përjashtimin e prokurorit Afrim Shehu nga procedimi penal nr. *** ku P.K është i pandehur, pasi P.K ka kallëzuar kunatën e tij, noteren M. Sh., në një procedim tjetër nr. *** në Prokurorinë e Korçës; (c) Kërkesa e shtetasit P.K të datës 15.3.2022 për zëvendësimin e prokurorit Afrim Shehu në procedimin penal nr. ***; (d) Procesverbali i datës 29.6.2018 i Prokurorisë së Rrethit Korçë për marrjen e të dhënave të shtetasen M. Sh.; (e) Kallëzimi i shtetasit P.K në Prokurorinë e Korçës, datë 12.12.2016.

¹⁴⁸ Denoncimet nr. *** prot., datë 18.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 7.5.2018.

favorizuar të kallëzuarin dhe më pas ka marrë vendim pushimi të procedimit penal, vendim ky që i është kthyer nga gjykata për hetime të mëtejshme.

Nga hetimi rezultoi se D.P ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” në ngarkim të shtetasit L. K. etj. Çështja u transferua për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi në këtë çështje po kryheshin hetime edhe për një gjyqtar të Gjykatës së Rrethit Shkodër, z. A. Ç., për hetimin e së cilës u ngarkua subjekti i rivlerësimit.

Pas veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve” nga zyrtarët e EKB-së Sh., shtetasin L. K. etj., në përfundim të hetimeve u konkludua se veprimet e kryera nga shtetasi L. K. përbëjnë shkelje të disiplinës në punë dhe është vendosur pushimi i hetimeve të procedimit penal nr. ***.

Kallëzuesi D.P e ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës këtë vendim dhe gjykata me vendimin e datës 7.12.2017¹⁴⁹ vendosi “Anulimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të datës 10.3.2017 “Për pushimin e çështjes penale nr. *** për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit L. K. etj.”, pasi Prokuroria nuk ka kryer hetime të plota dhe se për sqarimin e plotë të rrethanave duhet të kryhen veprime hetimore të tjera¹⁵⁰.

Ndaj këtij vendimi është bërë ankim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe personi nën hetim L. K. në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin e datës 1.3.2018¹⁵¹ vendosi “Lënie në fuqi të vendimit të datës 7.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Pasi çështja u kthye për rihetim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, subjekti i rivlerësimit në datën 28.3.2018 vendosi “Shpalljen e moskompetencës tokësore”, pasi detyrat e caktuara nga Gjykata e Rrethit Durrës dhe Apelit për hetime të mëtejshme nuk janë kompetencë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, por asaj Shkodër. Subjekti ka argumentuar se në ankimin e tij D.P ka pretenduar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës nuk ka kryer hetime të plota rreth kallëzimit të tij ndaj shtetasit L. K., ish-drejtor i EKB Sh. dhe ka kërkuar anulimin e vendimit vetëm për këtë person, ndërsa për personat e tjerë që janë kallëzuar, Y. R., A. Ç. etj., që u janë pushuar hetimet, nuk ka pasur ankim ndaj vendimit të pushimit. Vendimi i gjykatës i referohet vetëm të kallëzuarit

¹⁴⁹ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Durrës, vendimi nr. *** datë 7.12.2017.

¹⁵⁰ 1. Lidhur me dokumentin, kërkesën e bërë nga EKB Sh në emër të personit K.GJ dhe del se nuk ekziston, ankuesi D.P në kallëzimin penal të bërë ka pretenduar se nënshkrimi poshtë emrit të kërkuarit është kryer nga ish-drejtori L.K. Gjithashtu, ai ka cikluar për zbatim dhe ka vërtetuar njësinë me origjinalin, dokument i pretenduar se është falsifikuar nga ish-drejtori L.K. Për sqarimin e këtij fakti duhet të kryhet ekspertimi tekniko-grafik përkatës, konform rregullave procedurale hetimore, me qëllim sqarimin nëse dokumenti i mësipërm është i falsifikuar dhe, nëse vërtetohet falsifikimi, të përcaktohet nëse është kryer nga shtetasi L.K; 2. Për këtë dokument të pyetet hollësisht L.K dhe në hetim të sqarohet se në çfarë rrethanash dokumenti i mësipërm është paraqitur si provë në Gjykatën e Rrethit Shkodër gjatë shqyrtimit të çështjes civile që i përket vendimit civil nr. ***, datë 14.5.2012, të kësaj gjykate, ku EKB Sh ka qenë në cilësinë e paditësit; 3. Ankuesi D.P ka pretenduar se edhe Drejtorja e Përgjithshme e EKB-së Tiranë ka bërë kallëzim penal ndaj ish-drejtorit të EKB SH, L.K, për veprimet shpërdoruese të kryera gjatë kryerjes së detyrës. Në këtë drejtim, hetimet duhet të zgjerohen duke u pyetur dhe ish-drejtorja e Përgjithshme e EKB T, shtetasja D. A.; 4. Hetimet duhet të zgjerohen edhe në drejtim të veprimeve procedurale të kryera nga përmbartuesi gjyqësor H. Xh., pasi ekzekutimi i vendimit civil nr. ***, datë 14.5.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i formës së prerë, është kryer prej tij. Ky ekzekutim është realizuar ndaj një personi që nuk ka qenë palë në procesin civil të mësipërm dhe me hetim duhet të konkludohet nëse janë kryer veprimet shpërdoruese gjatë ekzekutimit të vendimit civil të mësipërm; 5. Shtetasi L.K në deklaratimet e dhëna ka pretenduar se nuk ka pasur jurist në organikë dhe mungesa e personelit që kanë ndikuar në moskryerjen në kohë të ankimeve ndaj vendimeve gjyqësore civile të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pretendimet e mësipërme duhet të verifikohen me veprime hetimore dhe me prova shkresore për të konkluduar nëse në veprimet e shtetasit L.K ka elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, që parashikohet nga neni 248 i Kodit Penal.

¹⁵¹ Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. *** datë 1.3.2018.

L. K. dhe gjykata ka orientuar kryerjen e veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë kompetencë e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Çështja u rifillua në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe, pas kryerjes së hetimeve të tjera, prokurori Sh. M., që po hetonte këtë çështje, vendosi ta dërgojë atë për gjykim për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” në ngarkim të shtetasit L. K. etj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin e datës 12.7.2018¹⁵² vendosi “Pushimin e çështjes të procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit L. K.”, me arsyetimin ndër të tjera se nga gjykata çmohet se fakti që i atribuohet të pandehurit L. K. nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe nuk provohet që i pandehuri të ketë konsumuar ndonjë vepër penale në rastin konkret.

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim Prokuroria e Rrethit Shkodër në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.8.2018, vendosi “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** datë 12.7.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, me arsyetimin se nuk ka vend për vijimin e hetimeve për këtë çështje penale, prandaj duhet të lihet në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** ndaj të dyshuarit L. K.

Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë : (i) përse nuk ka kryer veprime të plota hetimore në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, edhe pse kishte indicie të dhëna nga kallëzuesi në kallëzimin e tij; (ii) përse nuk ka shpallur moskompetencën tokësore që në momentin që iu caktua për hetim çështja, në përputhje me nenin 28 të Kodit të Procedurës Penale dhe jo pasi gjykatat e dy shkallëve anuluan vendimin e mosfillimit të dhënë prej tij dhe urdhëruan kryerjen e hetimeve të mëtejshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka shpjeguar ndër të tjera se:

“...kompetencën tokësore e kishte Prokuroria e Rrethit Durrës, për shkak të subjektit të posaçëm, gjyqtarit A. Ç., që ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër.

Subjektet e tjera janë hetuar në kuadër të një procedimi të lidhur, për shkak se veprimet e tyre lidheshin me proceset gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari A. Ç.

Hetimi ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm dhe, për këtë shkak, është konkluduar me pushimin e hetimeve të këtij procedimi penal. Detyrat e lëna në vendimin datë 7.12.2017 nuk sillnin asgjë të re për hetimin dhe, për këtë shkak, subjekti ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit.

Kompetenca tokësore për hetimin dhe zgjidhjen e çështjes për gjyqtarin A. Ç. është verifikuar dhe pranuar nga Gjykata, ndërkohë që ka lënë detyra shtesë për të dyshuarin L. K. Meqenëse për subjektin e posaçëm është pranuar pushimi i hetimit, veprimet e tjera shtesë të cilat lidheshin me shtetasin L. K. ishin kompetencë e Prokurorisë Shkodër dhe, për këtë shkak, në zbatim të nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur moskompetencën tokësore për shtetasin L. K.

*Edhe pas hetimeve shtesë të kryera nga Prokuroria Shkodër u provua fakti se veprimet e shtetasit L. K. nuk përbënin vepër penale, sipas konkluzionit të vendimit nr. ***, datë 12.7.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 20.8.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Pra, hetimet shtesë të lëna nga Gjykata e Rrethit Durrës*

¹⁵² Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 12.7.2018.

nuk sillnin asgjë të re për hetimin, pasi veprimet e të dyshuarit L. K. nuk përbënin veprë penale, por ishin shkelje me natyrë administrative.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni çmon se në rastin konkret gjetjet e gjykatës lidhur me mangësitë e subjektit në kryerjen e veprimeve hetimore përbëjnë shkelje në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Kjo çështje do të vlerësohet në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, së bashku me gjetjet e tjera të konstatuara.

45.7 Denoncim i shtetasës O.V¹⁵³, e cila pretendon se gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës P. Ç. dhe subjekti i rivlerësimit kanë bërë shkelje flagrante dhe ky i fundit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, ndërkohë që gjyqtari P. Ç. ka rrëzuar ankimin e kallëzueses O.V.

Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës fashikullin e procedimit penal nr. *** me kallëzuese shtetasen O.V dhe aktet ka rezultuar se:

Në datën 3.1.2018, shtetasja O.V ka depozituar kallëzim penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në ngarkim të një grupi studentësh të Universitetit “***”, Durrës. Në datën 4.1.2018, pas hetimeve të kryera, subjekti i rivlerësimit vendosi “Mosfillimin e procedimit penal”, pasi ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.

Vendimi i mosfillimit është kundërshtuar nga kallëzuesja O.V në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendimin e datës 23.2.2018¹⁵⁴ vendosi “Rrëzimin e kërkesës së shtetasës O.V si të pabazuar në prova e në ligj”.

Vendimi i mësipërm është ankimuar nga shtetasja O.V në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin datë 16.5.2018¹⁵⁵ vendosi “Ndryshimin e vendimit datë 23.2.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës” dhe urdhërohet Prokuroria e Rrethit Durrës të regjistrojë procedimin penal dhe të vazhdojë hetimet dhe të kryhen detyrat¹⁵⁶.

Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, në datën 22.5.2018 është urdhëruar fillimi i hetimeve dhe regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 22.5.2018, që bën fjalë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe në vijim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Durrës janë kryer veprimet hetimore përkatëse.

Në datën 21.1.2019, prokurori Afrim Shehu në vijim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit në përfundim vendosi “Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, datë 22.5.2018”.

Vendimi i mosfillimit është kundërshtuar nga kallëzuesja O.V në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka kërkuar vazhdimin e hetimeve, pasi prokurori nuk ka kryer hetime të plota.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin datë 25.2.2019¹⁵⁷ ka vendosur “Mospranimin e kërkesës së prokurorisë; Kthimin e akteve të çështjes penale nr. *** të Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve dhe kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuar në këtë vendim brenda një afati 3

¹⁵³ Denoncim nr. *** prot., datë 22.5.2018, i shtetasës O.V, bërë nga avokati i saj B. M.

¹⁵⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 23.2.2018.

¹⁵⁵ Vendimi nr. ***, datë 16.5.2018.

¹⁵⁶ Shihni vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës nr. ***, datë 16.5.2018.

¹⁵⁷ Vendim nr. ***, datë 25.2.2019.

muaj që fillon nga dita e marrjes së formës së prerë të vendimit penal”. Gjykata në këtë vendim ka përcaktuar disa detyra që duhen kryer nga prokurori i çështjes.

Gjykata analizoi materialet e çështjes dhe konkludon se hetimet e kryera nuk janë të plota dhe se nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore të përcaktuara në vendimin penal nr. ***, datë 16.5.2018, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe për sqarimin e rrethanave duhet të kryhen veprimet e tjera hetimore. Gjykata vlerëson se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës veprimet hetimore të mësipërme duhet të realizohen brenda 3 muajve nga marrja formë të prerë e vendimit.

Vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga prokurori Afrim Shehu në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 23.5.2019, vendosi “Lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 25.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vijuar përsëri hetimet dhe ka dërguar përsëri në gjykatë kërkesën për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 1.6.2020, vendosi “Mospranimin e kërkesës së prokurorisë; Kthimin e akteve të çështjes penale nr. 912/2018 të Prokurorisë për vazhdimin e hetimeve dhe kryerjen e veprimeve hetimore të përcaktuar në këtë vendim brenda një afati 4 muaj, që fillon nga dita e marrjes së formës së prerë të vendimit penal”.

Në përfundim, gjykata shqyrtoi materialet e fashikullit hetimor dhe konkludon se është e nevojshme të kryhen edhe disa veprime të tjera hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë për të gjitha rrethanat e çështjes.

Vendimi i mësipërm është kundërshtuar nga prokurori Afrim Shehu në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.9.2020, vendosi “Lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 1.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me plotësimin që afati 4-mujor për vazhdimin e hetimeve fillon nga dita e mbërritjes së akteve prokurorit”.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vijuar përsëri hetimet dhe në datën 21.1.2021 ka dërguar përsëri në gjykatë kërkesën për miratimin e kërkesës për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***. Prokuroria ka kryer veprimet hetimore përkatëse.

Në përfundim të veprimeve hetimore në datën 21.1.2021, prokurori Afrim Shehu ka dërguar në Gjykatë kërkesën për pushimin e çështjes nr. ***.

Me vendimin datë 19.7.2021¹⁵⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi “Miratimin e kërkesës së prokurorisë; Pushimin e çështjes penale nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, që parashikohet nga neni 186 i Kodit Penal”.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasja O.V në Gjykatën e Apelit Durrës¹⁵⁹, e cila me vendimin ***, datë 18.10.2021, vendosi “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 19.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

Pasi analizoi dokumentacionin e dosjes, Komisioni ka konstatuar se kërkesa e subjektit Afrim Shehu për pushimin e çështjes nr. *** është refuzuar disa herë nga gjykatat e dy shkallëve për moskryerje hetimesh të plota dhe për mopërmbyshje detyrash kjo jo në përputhje me nenin 329/b të Kodit të Procedurës Penale. Për këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime

¹⁵⁸ Vendimi nr. ***.

¹⁵⁹ Vendimi i përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me shkresën nr. *** prot., datë 8.4.2023.

dhe të depozitohet prova në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 për konstatimet e lartpërmendura.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij ka shpjeguar se: *“Së pari, ankesa nr. ***, datë 19.7.2018, në emër të 38 studentëve, nuk ka ekstremitetet e një dokumenti për t’u marrë në mbrojtje nga neni 186 i Kodit Penal. Ky ka qenë shkaku që në datën 4.1.2018 subjekti ka vendosur mosfillimin e hetimeve, pasi konflikti zgjidhej në Gjykatën Administrative nëpërmjet kundërshtimit të aktit administrativ.*

*Së dyti, vendimi nr. *** i Këshillit të Etikës është bazuar vetëm në thëniet e 5 studentëve, të cilët kishin dëshmuar pranë këtij këshilli gjatë procesit administrativ për dhënie mase disiplinore ndaj shtetases O.V. Ky vendim është akt administrativ dhe, si i tillë, mund të kundërshtohet në rrugë gjyqësore.*

Së treti, policia gjyqësore ka kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore dhe, në pamundësi objektive për të identifikuar të gjithë studentët të cilët kishin mbaruar studimet dhe ishin larguar jashtë shtetit, ka relatuar dhe nga subjekti është kërkuar pushimi i hetimeve.

*Së katërti, kërkesat e prokurorit për pushimin e hetimeve janë shqyrtuar nga i njëjti gjyqtar, i cili, në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 19.7.2021, ka pranuar arsyetimin e subjektit se fakti nuk përbën vepër penale, duke vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës”.*

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka mbështetur bazuar në argumente ligjore dhe në bindjen e tij të brendshme vendimet e tij, të cilat janë parashtruar edhe në ankimet që ai ka depozituar ndaj vendimeve të gjykatës. Gjithashtu, nga ana procedurale, subjekti ka përmbushur detyrat e lëna nga gjykatat, duke kryer hetime të mëtijshme ashtu siç specifikohet në vendimet gjyqësore në përputhje me shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale¹⁶⁰ dhe në mënyrë vijuese ka marrë përsëri vendim pushimi të çështjes. Sa më sipër, shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe, për pasojë, nuk përmbajnë elemente që lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

45.8 Denoncim i shtetases SH.M¹⁶¹, O.SH dhe ZH.I¹⁶², ku pretendohet se:

- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar për procedimin në ngarkim të një prej denoncueseve, ka zvarritur hetimet, si dhe ka kryer veprime korruptive.*

- *Subjekti ka kryer veprime korruptive, si dhe denoncuesja nën presionin e avokates ka paguar deri në 4,000 euro që të ndryshonte masën e arrestit dhe të mos e ankimonte prokurori masën në Apel.*

¹⁶⁰ Neni 329 “Ankimi kundër vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes. Pika 3, shkronja b – kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen”.

¹⁶¹ Denoncim nr. *** prot., datë 11.9.2018.

¹⁶² Denoncim nr. *** prot., datë 11.9.2018.

Nga hetimi rezulton se tre denoncuesit janë bashkë të pandehur në të njëjtën çështje, të hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës¹⁶³ në fashikullin e procedimit penal nr. ***, dërguar për gjykim në ngarkim të shtetasve SH.M, S.I, O.SH etj. (15 fashikuj), ku ka rezultuar se:

- Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës janë depozituar disa kallëzime penale nga shtetas të ndryshëm në ngarkim të shtetasit S.I (bashkëshorti i denoncueses ZH.I), me detyrë ish-kryetar i Komunës I, shtetas SH.M (e motra e S.I me detyrë ish-*** në zyrën e urbanistikës të Komunës I), shtetas O.SH (me detyrë ish-*** në Komunën I), si dhe persona të tjerë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”. Këto kallëzime janë regjistruar si procedime penale që u janë caktuar për hetim disa prokurorëve të ndryshëm.

Meqenëse këto kallëzime ishin ngritur në ngarkim të të njëjtëve persona, drejtuesi i prokurorisë i bashkoi ato në një procedim të vetëm nr. ***, duke caktuar subjektin e rivlerësimit për ndjekjen e tyre.

Gjatë hetimeve ka rezultuar se shtetasi S.I dyshohet se ka kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Falsifikimi i dokumenteve për 4 herë, e kryer në bashkëpunim” dhe veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, shtetasja SH.M është akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve në bashkëpunim” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike në bashkëpunim” dhe shtetasja O.SH, e dyshuar se ka kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” (pasi ka vulosur dokumente të rreme, nga të cilat kanë përfituar padrejtësisht prona shtetasit që janë marrë të pandehur).

Pas veprimeve hetimore janë regjistruar emrat e personave të lartpërmendur, të cilëve u atribuohen veprat penale, duke i marrë ata si të pandehur.

Konstatohet se kjo çështje ka qenë komplekse dhe në mënyrë të vazhdueshme ka pasur bashkime të procedimeve penale nga kallëzues të ndryshëm në ngarkim të të njëjtëve persona, janë kryer veprime të shumta hetimore, ku prokurori Afrim Shehu ka marrë disa vendime për zgjatjen e veprimeve hetimore me periudha kohore 3-mujore konform nenit 324/1 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimet për zgjatjen e veprimeve hetimore janë miratuar nga drejtuesi i prokurorisë dhe u janë njoftuar palëve në hetim, si S.I, SH.M dhe O.SH etj., konform procedurës.

Meqenëse këto zgjatje po e kalonin afatin 2-vjeçar të hetimeve, bazuar në nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas kërkesës së prokurorit Afrim Shehu nëpërmjet drejtuesit të prokurorisë i është kërkuar miratimi Prokurorit të Përgjithshëm për zgjatjen e hetimeve paraprake për një periudhë 3-mujore, nga data 15.5.2018 – 15.8.2018, i cili ka miratuar kërkesën për zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake sipas periudhës së kërkuar.

Subjekti i rivlerësimit në datën 30.7.2018 ka dërguar “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ****” në ngarkim të të pandehurve S.I, akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve, i kryer në bashkëpunim”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, e kryer në bashkëpunim”, SH.M akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve i kryer në bashkëpunim”, si dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, e kryer në bashkëpunim” dhe O.SH, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” etj.

¹⁶³ Shkresë e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me nr. *** prot., datë 9.10.2023.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e datës 14.9.2018¹⁶⁴ vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Durrës për dërgimin në gjyq të të pandehurve.

Prokurori Afrim Shehu në datën 7.2.2020, në dokumentin “Diskutim përfundimtar”, dërguar përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka kërkuar:

i) Deklarimin fajtor të shtetasit S.I për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, e kryer në bashkëpunim”, “Falsifikimi i dokumenteve, e kryer në bashkëpunim 4 herë”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe dënimin përfundimisht të tij me 6 vjet burgim, si dhe heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike prej 5 vjetësh;

ii) Deklarimin fajtor të së pandehurës SH.M për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, e kryer në bashkëpunim”, “Falsifikimi i dokumenteve e kryer në bashkëpunim” dhe dënimin përfundimisht me 5 vjet burgim dhe si dënim plotësues heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 5 vjetësh;

iii) Deklarimin fajtor të së pandehurës O.SH për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe dënimin e saj me 9 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim për të pandehurën O.SH për një periudhë 18-mujore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e datës 11.3.2020¹⁶⁵ vendosi deklarinim fajtor të të pandehurve, duke caktuar dënimet përkatëse: (i) Të pandehurin S.I duke e dënuar përfundimisht me 8 vjet burgim, si dhe heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej 3 vitesh; (ii) Të pandehurën SH.M, duke e dënuar përfundimisht me 2 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi, duke e vendosur të pandehurën në periudhë prove me një afat prej 3 vitesh; (iii) Të pandehurën O.SH, duke e vendosur të pandehurën në periudhë prove me një afat prej 18 muajsh.

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës i pandehuri S.I, SH.M dhe O.SH, si dhe me ankimin e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Durrës prokurori Afrim Shehu për ndryshimin e vendimit në lidhje me masën e dënimit dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për të pandehurën SH.M, duke e dënuar sipas diskutimit përfundimtar të akuzës dhe për të pandehurin F. H. të deklarohet fajtor për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve më shumë se një herë”.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin e datës 5.10.2021¹⁶⁶ vendosi prishjen e vendimit nr. ***, datë 11.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe kthimin e akteve në po atë gjykatë, por me trup tjetër gjykues.

Pasi analizoi dokumentacionin në dosjen penale, Komisioni vëren se:

Pretendimet e denoncuesve (ZH.I, O.SH dhe SH.M) dhe që janë njëkohësisht të pandehur/dënuar në të njëjtën çështje, se nga subjekti i rivlerësimit ka pasur zvarritje në proces, janë të pabazuara.

Komisioni nga aktet e dosjes ka konstatuar se çështja në fjalë ka qenë komplekse, në të janë bashkuar edhe disa procedime të tjera penale në bazë të kallëzimeve të bëra nga shtetas të ndryshëm për të njëjtët të pandehur për të njëjtët vepra. Gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka marrë në mënyrë të vazhdueshme vendime për zgjatje hetimesh me afate 3-mujore në përputhje me nenin 324/1 të Kodit të Procedurës Penale, të miratuara nga drejtuesi i prokurorisë. Gjithashtu, edhe në rastin e kalimit të afatit 2-vjeçar të hetimeve, prokurori po në përputhje me nenin 324/2 të

¹⁶⁴ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtari i seancës paraprake R. B.) me vendimin nr. ***, datë 14.9.2018.

¹⁶⁵ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (gjyqtari P. Ç.) me vendimin nr. ***, datë 11.3.2020.

¹⁶⁶ Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 5.10.2021.

Kodit të Procedurës Penale ka kërkuar zgjatje afati nëpërmjet drejtuesit të prokurorisë tek Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka miratuar zgjatjen e afatit të hetimeve.

Në lidhje me pretendimin e denoncuases SH.M se subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim në këtë çështje edhe ish-juristen e Komunës I, T.K, akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, më pas ka kërkuar pushimin e akuzës për këtë shtetase.

Kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës së shtetases T.K është miratuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin e datës 11.3.2020. Edhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, datë 5.10.2021, e cila vendosi “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të datës 11.3.2020”, për pjesën e pushimit të akuzës për të pandehurën T.K nuk është cenuar gjykimi i saj për pushimin e akuzës nga prokuroria dhe gjykata.

Për pretendimin e denoncuases O.SH se prokurori bashkë me avokaten kanë bërë pazare dhe denoncuesja nën presionin e avokates ka paguar deri në 4,000 euro që të ndryshonte masën e arrestit dhe të mos e ankimonte prokurori masën në Apel, nga hetimi i Komisionit konstatohet se:

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 8.2.2018, është pranuar kërkesa e Prokurorisë Durrës për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetases O.SH. Ky vendim mori formë të prerë pa u ankimuar.

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 10.2.2018¹⁶⁷, nga Prokuroria Durrës (prokurori Afrim Shehu) është kërkuar verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasen O.SH dhe vijueshmëria e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Mbrojtësi i të pandehurës O.SH kërkoi “Zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” me “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

“Gjykata vendosi zëvendësimin e masës shtrënguese “Arrest në burg” me atë të “Detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi mori formë të prerë në datën 15.2.2018 pa u ankimuar.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për mosankimin e vendimit të gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Detyrim për paraqitje” në përputhje me nenin 249, pika 1/1 e Kodit të Procedurës Penale, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “...gjykata në seancën e marrjes në pyetje të shtetases O.SH, ka arsyetuar për rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit, të cilat nuk ishin të asaj natyre që të aplikohet masa e sigurimit “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale. Në çastin që jam njohur me arsyetimin e vendimit të gjykatës, kam vlerësuar se rrezikshmëria e saj dhe e veprës për të cilën dyshohet, në raport me të arrestuarit e tjerë ishte më ulët dhe për këtë shkak nuk kam ushtruar ankim për ndryshimin e masës së sigurimit. Mos ushtrimi i ankimit, ishte dhe strategji për hetimin e ish-kryetarit dhe punonjësve të tjerë të kësaj komune, pasi kjo shtetase mund të jepte të dhëna shtesë për vërtetimin e fakteve objekt hetimi. Qëndrimi që kam mbajtur për të mos ushtruar ankim ndaj masës së sigurimit e kam reflektuar dhe tek masa e

¹⁶⁷ Vendimi i gjykatës nr. ***, datë 10.2.2018.

dënimit, duke kërkuar aplikimin e dënimit alternativ të pezullimit të dënimit dhe vënies në provë të kësaj shtetaseje, për shkak se ekzistonin kushtet për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktin e mosankimit të vendimit të Gjykatës për ndryshimin e masës nga “Arrest në burg” në “Detyrim për paraqitje”, që lidhet me kushtet e nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, duke vlerësuar faktin e rrezikshmërisë së ulët që e pandehura paraqiste, moshën e re, gjendjen ekonomike, që kanë krijuar bindjen tek subjekti i rivlerësimit për të lënë masën e caktuar nga gjykata.

46. GJETJE TË TJERA

47. Komisioni ka administruar një denoncim të paraqitur pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 25.8.2023 ndaj subjektit të rivlerësimit Afrim Shehu. Në këtë denoncim pretendohet se subjekti i rivlerësimit kishte kryer veprime të paligjshme, duke pretenduar se kishte prova që ai kishte ndërhyrë tek një gjyqtare e Apelit për lirimin e shtetasit E. S., i akuzuar për veprën penale “Mbajtja, prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”.

Rrethanat e çështjes

48. Komisioni, me qëllim sqarimin e rrethanave dhe fakteve të sipërcituara, nëpërmjet postës elektronike *email* në datën 6.10.2023 i ka dërguar subjektit Afrim Shehu pyetësonin nr. 4, në mënyrë që të sqarojë nëse subjekti ka njohje me shtetasin B. S. dhe I. M. dhe cili është raporti që ai ka me këta persona. Gjithashtu, subjektit iu kërkuar të shpjegojë nëse është takuar me këta persona dhe, nëse po, cili ka qenë qëllimi i takimit.

49. Subjekti ka shpjeguar se me shtetasin I. M. ka lidhje gjaku dhe ka takime të vazhdueshme familjare. Shtetasin B. S. e ka takuar për herë të parë në mesin e muajit maj 2020 gjatë kohës së pandemisë së Covid-19, i cili ka qenë i shoqëruar me shtetasin I. M. në pikën e karburantit “K”, i cili ndodhet në hyrje të autostradës Durrës-Tiranë. Qëllimi i takimit me shtetasin I. M. ka qenë pasi një ditë para këtij takimi subjekti ka takuar vëllain e tij A. Sh., avokat në Tiranë, i cili kishte folur me I. M. për të përfaqësuar çështjen e një të afërmi të tij në Gjykatën e Apelit Durrës. Meqë vëllai i subjektit avokat, e kishte të pamundur për të lëvizur nga Tirana në Durrës dhe anasjelltas, për shkak të kufizimit të lëvizjes si pasojë e pandemisë së Covid-19 dhe, meqë subjekti lëvizte për shkak të punës, i kërkoj atij të lidhej me shtetasin I. M. dhe të merrte prej tij dy dokumente.

50. Në vijim të shpjegimeve të dhëna subjekti ka administruar një përgjigje të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës ku konfirmohet se për shtetasin E.S janë regjistruar dy procedime penale ku për procedimin penal të vitit 2020 është dërguar kërkesa për pushim në nëntor 2021¹⁶⁸, ndërsa për procedimin penal të vitit 2021 është dërguar kërkesë për pushim¹⁶⁹.

51. Subjekti depozitoi dokumente provuese¹⁷⁰ të cilat konfirmonin shpjegimet e dhëna nga ai dhe përputheshin me dokumentacioni e administruar gjatë hetimit administrativ

¹⁶⁸ procedimi penal nr. ***, i vitit 2021

¹⁶⁹ procedimi penal nr. ***, i vitit 2020, në ngarkim të shtetasit E.S

¹⁷⁰ (a) kërkesën e datës 3.11.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (b) shkresën nr. ***, datë 6.11.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (c)

Vlerësimi i Komisionit

52. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, parashikuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

53. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e tij, si dhe ka depozituar dokumentacion provues në mbështetje të tyre, për kërkesat e bëra dhe problematikat e ngritura nga Komisioni në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku.

54. Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, çmon se përgjithësisht subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shqyrtimi i çështjeve të tjera penale, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale. Kështu, megjithëse duket se qëndrojnë gjetjet për mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore në dy raste të trajtuara në vijim të denoncimeve të marra, trupi gjykues çmon se kjo nuk është një qasje e vazhdueshme e subjektit, pra se këto dy raste nuk tregojnë në tërësi modelin e tij të punës dhe, si rrjedhim, nuk mund të ndikojnë në procesin e vlerësimit të kriterit profesional për prokurorin Afrim Shehu.

55. Në analizë të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

56. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej tij, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

vendimin nr. ***, datë 11.4.2022, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; (d) vendimin nr. ***, datë 15.5.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës; (e) procesverbalin e deklarimit të shtetasit I. M., datë 1.11.2021; (f) procesverbalin e deklarimit të shtetasit B. S, datë 19.10.2021; (g) procesverbalin e deklarimit të shtetasit A. Sh., datë 25.10.2021.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Afrim Shehu, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 15.5.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka